AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

RAPORT VJETOR
2025

I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

PËR KUVENDIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

PËRMBAJTJA

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE 4
LISTA E SHKURTESAVE 5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6
TË ARRITURAT KRYESORE 6
SFIDAT DHE PENGESAT 7
KAPITULLI 1: HYRJE 9
1.1 ROLI DHE MANDATI I AKP-së 9
1.2 FUSHËVEPRIMI I AKP-së 9
1.3 REGULLAT DHE PROCEDURAT E AKP-së 10
1.4 MISIONI DHE VIZIONI I AKP-së 10
1.5 STRUKTURA E RAPORTIT 11
KAPITULLI 2. BORDI I DREJTORËVE DHE MENAXHMENTI 12
2.1 STRUKTURA E QEVERISJES DHE ROLI I BORDIT TË DREJTORËVE 12
2.2 AKTIVITETET DHE MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE 12
2.3 MENAXHMENTI EKZEKUTIV DHE ROLI I TIJ 14
2.4 PROCESI I VENDIMARRJES NË AKP 14
KAPITULLI 3: SHITJA E ASETEVE 16
3.1 SHITJA E ASETEVE ME TENDER PUBLIK 16
3.2 SHITJA DIREKTE E ASETEVE 17
3.3 SHITJA E BANESAVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE 17
3.4 SHPRONËSIMI I ASETEVE TË NSH-VE 18
3.5 HEQJA DORË NGA ASETET 19
KAPITULLI 4: LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE 20
4.1 PËRCAKTIMI I STATUSIT TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE 20
4.2 VENDOSJA E NSH-ve/ASETEVE NË LIKUIDIM 20
4.3 SHQYRTIMI I KËRKESAVE TË PUNËTORËVE PËR 20% NGA SHITJA DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE 21
4.4 SHQYRTIMI I KËRKESAVE KREDITORE DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE 21
4.5 MBYLLJA E PROCESEVE TË LIKUIDIMIT 22
KAPITULLI 5: MENAXHIMI I ASETEVE TË MBETURA TË NSH-VE 24
5.1 PLANI I TRAJTIMIT TË ASETEVE TË MBETURA 24

5.2 ASETET JASHTË KOSOVËS 25
KAPITULLI 6: ADMINISTRIMI I NSH-VE DHE QIRADHËNIA E ASETEVE 26
6.1 ADMINISTRIMI I NSH-VE 26
6.2 QIRADHËNIA E ASETEVE TË NSH-VE 29
KAPITULLI 7: FONDET NË MIRËBESIM DHE BUXETI I AKP-SË 31
7.1 TË HYRAT NGA PRIVATIZIMI DHE SHPËRNDARJA E FONDEVE NË MIRËBESIM 31
7.2 BUXHETI OPERATIV I AKP-SË 32
KAPITULLI 8: FUNKSIONET E PËRGJITHSHME 34
8.1 DEPARTAMENTI LIGJOR 34
8.2 DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS 35
8.3 BURIMET NJERËZORE 36
8.4 PROKURIMI..... 36
8.5 ZYRA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN 37
8.6 AKTIVITETET E MARKETINGUT 37
8.7 AUDITIMI I BRENDSHËM 37
SHTOJCAT 39
STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT 40

FJALA HYRËSE E KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

I nderuar Kryetar i Kuvendit,
Të nderuar deputetë,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve dhe qytetarë,

Kam nderin t'ju paraqes Raportin Vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit për vitin 2025, i cili ofron një pasqyrë të aktiviteteve, rezultateve dhe sfidave me të cilat është përballur Agjencia gjatë kësaj periudhe raportuese.

Viti 2025 është karakterizuar nga sfida të rëndësishme institucionale dhe operative, të cilat kanë ndikuar në funksionimin dhe proceset vendimmarrëse të Agjencisë. Mandati i Bordit të mëparshëm të Drejtorëve ka përfunduar më 5 gusht 2025, ndërsa deri në fund të vitit Agjencia ka operuar pa Bord funksional. Kjo situatë ka ndikuar në kufizimin e vendimmarrjes për proceset e shitjes dhe transformimit të aseteve, të cilat janë realizuar kryesisht në pjesën e parë të vitit.

Në këtë periudhë, Agjencia ka vazhduar zbatimin e procesit të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore, administrimin e aseteve dhe realizimin e shitjeve përmes procedurave transparente dhe konkurruese. Janë zhvilluar valë të shitjeve përmes tenderimit publik, shitje direkte për asete me karakter specifik, si dhe shpronësim i aseteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës për nevoja të institucioneve publike. Nga këto procese janë realizuar të hyra financiare dhe janë shpërndarë mjete për kreditorët dhe për punëtorët përfitues të 20%-shit nga privatizimi, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Një rol i veçantë gjatë vitit 2025 i është kushtuar identifikimit dhe administrimit të aseteve të reja, me ç'rast në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës janë evidentuar dhe vënë nën administrim të AKP-së një numër i konsiderueshëm asetesh që më parë nuk kanë qenë të regjistruara në evidencat zyrtare të Agjencisë. Gjithashtu, është vazhduar menaxhimi dhe qiradhënia e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore, duke siguruar të hyra dhe ruajtjen e vlerës së tyre ekonomike, deri në transformimin e tyre.

Përkundër rezultateve të arritura, Agjencia është përballur edhe me një sërë sfidash ligjore dhe administrative, përfshirë numrin e madh të lëndëve gjyqësore, çështjet pronësore, bartjen e pronave me vendime gjyqësore, si dhe vonesat në themelimin e mekanizmave institucionalë të paraparë për trajtimin e aseteve të mbetura. Në këtë kontekst, ligji për Fondin Sovran ndodhet në shqyrtim pranë Gjykatës Kushtetuese dhe në pritje të vendimit përfundimtar. Këto sfida vazhdojnë të ndikojnë në dinamikën e përmbylljes së proceseve të likuidimit, transformimit të pronës dhe realizimit të misionit të Agjencisë.

Raporti vjetor paraqet në mënyrë të përmbledhur aktivitetet operative, rezultatet financiare dhe angazhimet institucionale të Agjencisë gjatë vitit 2025, duke reflektuar përkushtimin për transparencë, llogaridhënie dhe ushtrim të përgjegjshëm të mandatit ligjor.

Dëshiroj të falënderoj Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe institucionet relevante për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në realizimin e mandatit të Agjencisë.

Duke e paraqitur këtë raport për shqyrtim, mbetemi të përkushtuar në vazhdimin e proceseve që kontribuojnë në përmbushjen e mandatit ligjor të Agjencisë dhe në interesin publik të Republikës së Kosovës.

Faleminderit për vëmendjen tuaj!

Hekuran Nikçi
Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

LISTA E SHKURTESAVE

AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKM	Agjencisë Kosovare e Mirëbesimit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AL	Autoriteti i Likuidimit
BiD	Bordi i Drejtorëve
BSPK	Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës
DhPGjS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
DE	Drejtori Ekzekutiv
FD	Fondi Sovran
KRK	Kuvendi i Republikës të Kosovës
QRK	Qeveria e Republikës së Kosovës
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
OSH	Ofruesi i shërbimeve
OSHP	Ofruesi i shërbimeve profesionale (Autoriteti i Likuidimit)
SHAL	Shitja e Aseteve përmes Likuidimit
ZDE FP	Zëvendës Drejtor Ekzekutiv Funksione të Përgjithshme
ZDE O	Zëvendës Drejtori Ekzekutiv - Operativa
ZQ	Zyra Qendrore
ZR	Zyrat Regjionale

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) ka vazhduar zbatimin e procesit të likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh), realizimin e shitjeve të aseteve dhe përmirësimin e efikasitetit administrativ. Megjithatë, për shkak të mungesës së Bordit të Drejtorëve në pjesën e dytë të vitit, shumica e aktiviteteve operative, përfshirë shitjen e aseteve, janë ndalur. Ky raport ofron një pasqyrë të rezultateve kryesore, sfidave institucionale dhe përpjekjeve për transparencë dhe zhvillim të qëndrueshëm.

TË ARRITURAT KRYESORE

Të arriturat kryesore të AKP-së gjatë vitit 2025 lidhur me procesin e administrimit, shitjes dhe likuidimit të aseteve si dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve operative dhe administrative janë si më poshtë:

Shitja e Aseteve

- **Shitja me Tender**: AKP ka realizuar katër (4) valë të shitjes së aseteve përmes procedurave të hapura të tenderimit. Nga asete e tenderuara, 85 asete janë aprovuar dhe janë lidhur 81 kontrata të shitjes se aseteve, ndërsa 31 asete janë refuzuar (5 aprovime dhe 20 refuzime nga SHAL70 2024 e aprovuar nga BD në janar 2025). Të hyrat nga shitja me tender janë: 16,123,308 €.
- **Shitja Direkte e Aseteve**: Në disa raste të veçanta, AKP ka realizuar shitjen e aseteve me karakter specifik përmes procedurave të shitjes direkte. Si rezultat, janë aprovuar 58 raporte përfundimtare për shitje të aseteve dhe janë lidhur 56 kontrata të shitjes se aseteve dhe 116 raporte rekomanduese për fillimin e procedurave për shitje direkte. Të hyrat nga shitja direkte janë: 2,608,267 €.
- **Shitja e Banesave**: AKP ka shitur 15 banesa të personat me të drejtë banesore. Ndërsa 12 banesa janë refuzuar për shitje për shkak të mos plotësimit të kushteve dhe 16 banesa tjera janë refuzuar për jo kompetencë lëndore. Të hyrat nga shitja e banesave janë: 5,391 €.
- **Shpronësimi i Aseteve:** Qeveria e Kosovës ka shpronësuar asete të caktuara për nevoja të institucioneve publike. Të hyrat nga shpronësimi janë: 1,023,750 €.
- **Heqja Dorë nga Asetet**: AKP ka hequr dorë, pa kompensim, prej 144 aseteve, të cilat aktualisht shfrytëzohen për interes publik (p.sh. varreza, lapidare, rrugë publike, shtretër të lumenjve, etj.).

Shpërndarja e Fondeve

- **Shpërndarja e Fondeve të Kreditorët:** Është aprovuar shpërndarja e mjeteve për 1,889 kërkesa kreditore në shumë prej: 2,751,476 €. Ndërsa janë shpërndarë: 3,576,357 €.
- **Shpërndarja e 20%-shit për punëtorët nga shitja:** Janë publikuar 12 lista fillestare të punëtorëve dhe 23 lista janë në pritje për aprovim nga gjykata. Janë shpërndarë: 5,822,538 € për 7,566 punëtorë.

Likuidimi i NSh-ve

- **Përcaktimi i statusit të NSh-ve:** Statusi është përcaktuar për një (1) NSh, ndërsa për 10 ndërmarrje tjera përcaktimi i statusit është në proces.
- **Vendosja e NSh-ve në likuidim:** Janë vendosur tre (3) NSh të reja në likudim. Në total janë 534 NSh në proces të likuidimit.
- **Mbyllja e procesit të likuidimit të NSh-ve:** Janë përmbyllur pesë (5) NSh sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Administrimi i NSh-ve dhe Qiradhënia e Aseteve

- **Administrimi i NSh-ve**: Në proces të likuidimit janë 534 NSh, të cilat administrohen nga Autoriteti i Likuidimit dhe Divizioni i Likuidimit. NSh që nuk janë në likuidim (5 NSh) janë nën administrim direkt. Katër (4) NSh kanë vazhduar të operojnë, të tjerat janë jo operative.
- **Qiradhënia e aseteve:** Janë 1,445 kontrata të nënshkruara për dhënien e aseteve me qira. Prej tyre, 309 kontrata janë aprovuar gjatë vitit 2025. Të hyrat nga qiraja janë: 6,455,610 €. Prej tyre, 353,801 € janë të hyrave nga qiradhënia e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore Brezovica dhe Jatex të cilat ndërmarrje llogaritë i kanë në bankat komerciale. Ndërsa 6,101,809 € janë në llogaritë bankare në BQK.
- **Identifikimi i aseteve të reja:** Janë identifikuar dhe janë vënë nën administrim të AKP-së 460 asete të reja, asete këto që më herët nuk kanë qenë në regjistër të AKP-së.

Asetet e mbetura dhe trajtimi i tyre

- **Asete të mbetura**: Kanë mbetur 15,507 asete të NSh-ve. Prej tyre, 15,163 janë parcela apo me ndonjë objekt të ndërtuar. Shumica janë toka bujqësore. Ndërsa 344 asete tjera (objekte) janë prona të NSh-ve, mirëpo tokat ku ato ndodhen janë pronë e komunave apo të palëve tjera.
- **Transferimi i planifikuar i aseteve të mbetura**: 5,703 asete planifikohen të transferohen tek Fondi Sovran (pas themelimit); 3,121 asete (toka pyjore) planifikohen të transferohen tek Agjencioni i Pyjeve; 574 asete tek institucionet publike dhe prej 545 aseteve do të hiqet dorë për interes publik.
- **Shitja e planifikuar e aseteve të mbetura**: 4,268 parcela dhe 332 objekte do të shiten me tender publik, ndërsa 952 asete të natyrës specifike do të shiten përmes procedurave të shitjes direkte.

Organizimi dhe administrimi i AKP-së

- **Përfaqësimi Ligjor dhe Procedurat Gjyqësore:** Gjatë periudhës raportuese janë pranuar 134 lëndë të reja dhe janë zhvilluar 333 seanca gjyqësore. Dhoma e Posaçme ka nxjerrë 90 aktgjykime dhe 146 aktvendime përfundimtare. Aktualisht, në Dhomën e Posaçme dhe Kolegjet e Shkallës së Parë dhe të Apelit ka mbi 11,800 lëndë aktive, duke përfshirë shqyrtime në shkallë të dytë dhe përfundimtare.

- **Rekrutimi:** Pozita e Drejtorit Ekzekutiv vazhdon të jetë e lirë. Zëvendësdrejtori Ekzekutiv – Operativë ushtron detyrën e Drejtorit Ekzekutiv, ndërsa Drejtori i DKRO-së ushtron detyrën e Zëvendësdrejtorit Ekzekutiv – Operativë. Konkursi është shpallur dy herë, por ende nuk është finalizuar. Gjatë periudhës raportuese janë iniciuar 11 procese rekrutimi: 1 i suksesshëm (2 pozita të plotësuara), 8 të pa suksesshme dhe 2 ende në proces.

SFIDAT DHE PENGESAT

Gjatë vitit 2025, procesi i administrimit, shitjes dhe likuidimit të aseteve si dhe funksionimi operacional i AKP-së janë ndikuar nga një sërë sfidash institucionale dhe ligjore, si më poshtë:

- **Mungesa e Bordit funksional të Drejtorëve:** Nga data 6 gusht 2025, AKP ka operuar pa Bord funksional, për shkak të përfundimit të mandateve të shumicës së anëtarëve. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejtë në vendimmarrjen ekzekutive, veçanërisht në realizimin e shitjeve, qiradhënieve dhe zbatimin e planeve operative.

- **Lëndët e pazgjidhura në gjykata:** Mijëra lëndë janë në shqyrtim në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme dhe në Gjykatat Themelore. Proceset e shitjes dhe likuidimit varen nga vendimet e gjyqësore, ndërsa kapacitet e limituara të gjykatave shkaktojnë vonesa shumëvjeçare.
- **Vonesat në dokumentacionin kadastral:** Vonesat nga Komunat në ofrimin e informatave dhe dokumenteve kadastrale ndikojnë drejtpërdrejtë në realizimin e planit të shitjeve.
- **Pagesa e pronave të shpronësuara:** Deri më tani janë shpronësuar 1,556 asete. Për vlerën e shpronësimeve prej 77,609,028 € ende nuk janë lidhur marrëveshje zotimi me institucionet relevante, çka po ndikon në vonesën e përmbylljes së proceseve të likuidimit dhe në realizimin e strategjisë përmbyllëse të AKP-së.
- **Mungesë e ofertave për asete të caktuara:** Disa asete nuk tërheqin interes të blerësve, duke ndikuar në ri-tenderim dhe zgjatur procesin e shitjes.
- **Mungesa e dokumentacionit për përcaktimin e statusit të NSh-ve**: Në disa raste, mungesa e dokumenteve pengon përcaktimin e statusit juridik dhe rrjedhimisht procesin e likuidimit.
- **Komasacioni:** Është ndër sfidat me të mëdha të Agjencisë. Është mbajtur takimi me Ministrinë e Bujqësisë dhe Agjencinë Kadastrale, mirëpo deri me tani nuk ka zhvillime konkrete.
- **Ekonomitë Pyjore dhe të Gjuetisë:** Sipas Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137, asetet pyjore (toka, pyje, kullosa) i takojnë Agjencisë së Pyjeve. Mirëpo, dorëzimi i tyre nuk është bërë ende për shkak të mosgatishmërisë së Agjencisë për t'i pranuar.
- **Themelimi i Fondit Sovran:** Një numër i konsiderueshëm i aseteve planifikohet të bartet në Fondin Sovran (FS). Megjithëse, ligji për FS është aprovuar në vitin 2023, Fondi nuk është themeluar ende për arsye se Ligji është në shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.
- **Trajtimi i aseteve me probleme**: Shumë asete kanë çështje të hapura juridike, kadastrale, apo nevojë për parcelim, të cilat duhet të zgjidhen shitjes ose trasnferimit.
- **Bartja e pronave me vendime Gjyqësore:** Disa prona të NSh-ve janë transferuar në pronësi të personave privat apo të komunave në bazë të vendimeve të gjykatave të Kosovës.

KAPITULLI 1: HYRJE

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), si institucion përgjegjës për menaxhimin dhe zbatimin e proceseve të privatizimit dhe likuidimit të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh), ka vazhduar të luajë një rol të rëndësishëm në rritjen e efikasitetit të administrimit të pronës shoqërore. Ky raport përmbledh aktivitetet, arritjet dhe sfidat e vitit 2025, duke pasqyruar përkushtimin e Agjencisë për një proces transparent, të drejtë dhe efektiv të privatizimit dhe likuidimit. Qëllimi i këtij raporti është:

- Të ofrojë një pasqyrë të detajuar mbi progresin e arritur në proceset e shitjes dhe likuidimit.
- Të evidentojë sfidat e hasura gjatë zbatimit të proceseve të privatizimit dhe likuidimit.
- Të përcaktoj drejtimet dhe prioritete strategjike për vitin vijues.
- Të prezantojë masat dhe iniciativat e ndërmarra për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e efikasitetit operacional të Agjencisë.

1.1 ROLI DHE MANDATI I AKP-së

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) është organ i pavarur publik që ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në mënyrë tërësisht autonome. Ajo gëzon zotësi të plotë juridike, përfshirë të drejtën për të lidhur kontrata, për të fituar, mbajtur dhe shitur pronë, si dhe të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë të detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Ligjin nr. 04/L-034. AKP ka të drejtë të padisë dhe të paditet në emër të saj.

Agjencia është themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në korrik të vitit 2008, si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e cila ishte themeluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2002/12 "Për Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit". Të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së janë trashëguar nga AKP-ja.

AKP i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës në baza vjetore.

1.2 FUSHËVEPRIMI I AKP-së

Ndërmarrjet Shoqërore (NSh) nën administrimin e AKP-së veprojnë në sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë përpunimin e metaleve, plastikës dhe letrës, hotelerinë, industrinë minerare, agro-industrinë, bujqësinë, pylltarinë, prodhimin e materialeve ndërtimore, ndërtimtarinë, industrinë tekstile, verarinë dhe vreshtarinë, prodhimin e birrës dhe duhanit, si dhe tregtinë me shumicë e pakicë.

Pjesa më e madhe e pronës industriale, tokave bujqësore dhe pronave komerciale në Kosovë janë në pronësi të këtyre ndërmarrjeve. Prandaj, administrimi, privatizimi ose likuidimi i tyre në mënyrë të drejtë, efikase dhe të përshtatshme në kohë, ka rëndësi thelbësore për rindërtimin dhe zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.

Aktualisht, nën administrimin e AKP-së ndodhen gjithsej **550 ndërmarrje shoqërore**, me statusin e tyre të paraqitur si më poshtë:

NDËRMARRJET SHOQËRORE NËN ADMINISTRIM TË AKP-së	
Përshkrimi	**Numri**
Numri total i ndërmarrjeve shoqërore të administruara nga AKP ndër vite	614
Numri i ndërmarrjeve të përmbyllura deri më tani me vendim të Dhomës së Posaçme	(64)

Numri aktual i Ndërmarrjeve Shoqërore nën administrim të AKP-së	**550**
Numri i ndërmarrjeve shoqërore që janë në proces të likuidimit	534
Numri i ndërmarrjeve shoqërore që akoma nuk janë vendosur në likuidim	16

1.3 REGULLAT DHE PROCEDURAT E AKP-së

AKP operon në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullat në fuqi, duke siguruar një proces të drejtë dhe konkurrues për shitjen dhe likuidimin e ndërmarrjeve dhe aseteve shoqërore. Ligji bazik i AKP-së është Ligji nr. 04/l-0341 për AKP, i ndryshuar[1]. Ndërsa aktet kryesore nënligjore të AKP-së janë:

1. Rregullore nr.01/2025 për Rregullat e Tenderit;
2. Procedurat Shitjes me tender publik;
3. Metodologjia-Shtojca e Procedurave të Shitjes;
4. Rregullore nr.3-2025 për Qiradhënien e Aseteve të NSH-ve;
5. Rregullore 05-2025-për angazhimin e ofruesve të shërbimeve;
6. Shtojca e Procedurave-Metodologjia e përcaktimit të çmimit;
7. Rregullorja nr. 08/2025 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore;
8. Rregullorja nr.09/2025 mbi Rregullat e Përgjithshme të Ankandit Publik.

Këto akte janë plotësuar në vitin 2025 me qëllim të rritjes së transparencës dhe efikasitetit të proceseve.

1.4 MISIONI DHE VIZIONI I AKP-së

Misioni i AKP - Agjencia Kosovare e Privatizimit është e autorizuar për administrimin e ndërmarrjeve shoqërore dhe aseteve të tyre, duke përfshirë shitjen, transferimin dhe/ose likuidimin e tyre. Për realizimin e këtij misioni, AKP ushtron mandatin e saj duke mbajtur dhe administruar çdo ndërmarrje në mirëbesim dhe në interes të pronarëve dhe kreditorëve përkatës, ndërsa proceset e shitjes apo likuidimit i zbaton në përputhje të plotë me dispozitat ligjore.

Vizioni i AKP - Agjencia është e përkushtuar të nxisë ndikime pozitive në zhvillimin ekonomik dhe të promovojë investimet në Ndërmarrjet Shoqërore, duke shfrytëzuar autorizimet e saj të gjera publike dhe administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete. Këto autorizime përfshijnë, ndër të tjera, mandatin dhe kompetencën për shitjen apo transferimin e ndërmarrjeve dhe/ose aseteve tek investitorët privatë, si dhe për likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent, konkurrues dhe pa vonesa të panevojshme, në përputhje me Ligjin për AKP-në, aktet nënligjore dhe legjislacionin në fuqi.

[1] Ligji nr. 04/l-0341 për AKP, është ndryshuar / plotësuar me ligjin nr. 04/l-115, ligjin nr. 05/l-080 dhe ligjin nr. 06/l-023.

1.5 STRUKTURA E RAPORTIT

Raporti është i ndarë në 8 kapituj, që ofrojnë një pasqyrë mbi aktivitetet dhe rezultatet e AKP-së:

Kapitulli 1 – Hyrje

Kapitulli 2 – Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti Ekzekutiv

Kapitulli 3 – Shitja e aseteve

Kapitulli 4 – Likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore

Kapitulli 5 – Menaxhimi i aseteve të mbetura të Ndërmarrjeve Shoqërore

Kapitulli 6 – Administrimi i Ndërmarrjeve Shoqërore dhe qiradhënia e aseteve

Kapitulli 7 – Fondet në Mirëbesim dhe buxhetit i AKP-s

Kapitulli 8 – Funksionet e përgjithshme

KAPITULLI 2. BORDI I DREJTORËVE DHE MENAXHMENTI

Ky kapitull përshkruan përbërjen, rolin dhe procesin e vendimmarrjes së Bordit të Drejtorëve dhe të Menaxhmentit Ekzekutiv të AKP-së si dhe aktivitetet, vendimet dhe sfidat e funksionimit gjatë vitit 2025.

2.1 STRUKTURA E QEVERISJES DHE ROLI I BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve (BiD) është organi më i lartë i AKP-së dhe ka kompetenca të plota mbi funksionimin e agjencisë. Bordi ka një strukturë të veçantë, që kombinon funksione mbikëqyrëse dhe ekzekutive. Përveç përcaktimit të strategjive dhe politikave të privatizimit, BiD ka autoritetin për të marrë vendime ekzekutive lidhur me menaxhimin operativ dhe zbatimin e këtyre politikave. Kjo strukturë mundëson që agjencia të veprojë me fleksibilitet dhe efikasitet në një mjedis privatizimi dinamik.

- Bordi i Drejtorëve përbëhet nga 8 anëtarë, përfshirë një përfaqësues të komunitetit jo-shumicë dhe një përfaqësues nga sindikatat e punëtorëve, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës;
- Bordi aktual ishte emëruar më 6 gusht 2021, me mandat 4-vjeçar;
- Nga gushti 2025, AKP-ja funksionon pa Bord të Drejtorëve.

Divizioni i Sekretarisë Ekzekutive të Bordit të Drejtorëve

Divizioni i Sekretarisë së Bordit ofron shërbime ligjore këshilluese, administrative, duke mbështetur procesin e vendimmarrjes së Bordit.

Gjatë vitit 2025, sekretaria ka:

- Organizuar mbledhjet e bordit dhe përgatitur dokumentacionin;
- Mbajtur procesverbale dhe dhënë këshilla ligjore;
- Monitoruar zbatimin e vendimeve të Bordit;
- Marrë pjesë në grupe punuese dhe komisione të themeluara nga Bordi.

2.2 AKTIVITETET DHE MBLEDHJET E BORDIT TË DREJTORËVE

Bordi i AKP-së takohet në baza të rregullta mujore. Gjatë vitit 2025, Bordi ka mbajtur 15 mbledhje, ku janë diskutuar dhe janë marrë 805 vendime formale dhe udhëzime për Menaxhmentin Ekzekutiv për çështje të ndryshme strategjike dhe operacionale.

Vendimet Kryesore të Bordit

Shitjet dhe Raportet:

- Janë aprovuar transaksionet e pesë (5) valëve të shitjes;
- Janë aprovuar 85 asete për shitje me tender, ndërsa 31 asete janë refuzuar;
- Janë aprovuar 344 raporte rekomanduese (aprovime/refuzime), përfshirë 58 raporte përfundimtare për shitje direkte;
- Janë aprovuar 56 raporte për klasifikimin dhe kategorizimin e aseteve sipas vendimeve paraprake;
- Janë aprovuar 29 kërkesa për shitje banesash (aprovime/refuzime);

- Janë aprovuar 5 raporte për heqje dorë nga 5 asete për interes publik.

Qiradhënia dhe Fondet:

- Janë miratuar 176 asete për qiradhënie përmes tenderit publik; 27 asete janë refuzuar; si dhe 73 qiradhënie direkte;
- Është miratuar vendimi për përdorimin e mjeteve nga tarifat administrative në shumën totale prej 998,000 €, për realizimin e investimeve me prioritet në NSH "Inex Sharr Planina – Brezovica", duke përfshirë 88,076 € mjete të mbetura dhe 909,924 € mjete shtesë për sezonin turistik 2025–2026).

Likuidimet dhe NSh-të:

- Është miratuar statusi i NSh-ve për dy (2) ndërmarrje/asete të reja;
- Është miratuar fillimi i likuidimit për tre (3) NSh/asete;
- Janë miratuar shpërndarjet për kreditorët e tetë (8) NSh-ve në likuidim.

Punëtorët dhe procedurat:

- Janë miratuar 35 lista përfundimtare të punëtorëve për përfitimin e 20%-shit dhe shpërndarjet përkatëse të mjeteve;
- Është miratuar rritja e buxhetit për finalizimin e procedurave të likuidimit për nëntë (9) NSh;
- Është miratuar plani i punës, buxheti dhe raportet tjera obligative për vitin 2025.

Rregulloret dhe akte nënligjore të miratuara

Gjatë vitit 2025, janë miratuar 13 rregullore dhe akte nënligjore kryesore, të cilat mbulojnë fushat më të rëndësishme të funksionimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, duke siguruar qartësi, transparencë dhe standardizim të procedurave. Këto përfshijnë:

1. Rregullore për Rregullat e Tenderit;
2. Procedurat e Shitjes me Tender Publik;
3. Shtojca dhe Metodologjia e Procedurave të Shitjes;
4. Rregullore për Menaxhimin e Arkës, Shpenzimet me Para të Gatshme dhe Udhëtimet Zyrtare;
5. Rregullore për Qiradhënien e Aseteve të NSh-ve;
6. Rregullore për procedurat e prokurimit për NSh-të;
7. Rregullore për angazhimin e ofruesve të shërbimeve;
8. Rregullore për procedurat e brendshme për parcelimin e pronave;
9. Procedurat e Shitjes Direkte dhe Metodologjia e përcaktimit të çmimeve;
10. Rregullore për Administrimin Direkt të Ndërmarrjeve Shoqërore;
11. Rregullore për Shitjet Direkte të Aseteve të Caktuara të NSh-ve;
12. Rregullore mbi Rregullat e Ankandit Publik;
13. Shtojca dhe akte të tjera nënligjore të standardizimit të procedurave operative.

Çështje lidhur me Menaxhmentin dhe Mandatin e Bordit

Më 04 korrik 2025, Bordi ka miratuar kërkesën për lirim nga detyra të ushtruesit të detyrës së Drejtorit Ekzekutiv (u.d. DE), i cili vazhdon mandatin e tij si Zëvendësdrejtor Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme. Në pozitën e u.d. Drejtorit Ekzekutiv është emëruar Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë, ndërsa Drejtori i Departamentit për Koordinim Rajonal ushtron detyrën e u.d. Zëvendësdrejtorit Ekzekutiv për Operativë. Pozita e Drejtorit Ekzekutiv mbetet e lirë dhe ushtrimi i detyrës nga Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë garanton vazhdimësinë e menaxhimit (shiko kapitullin 8.3).

Sa i përket mandatit të Bordit, gjashtë (6) anëtarëve u ka përfunduar mandati më 05 gusht 2025, duke lënë Bordin me vetëm dy (2) anëtarë – Kryesuesin dhe një (1) anëtar – pa kuorumin e nevojshëm për mbajtjen e mbledhjeve.

Aktivitetet e Komiteteve

Komiteti i Auditimit, i përbërë nga një drejtor i Bordit dhe dy (2) anëtarë të jashtëm, ka mbajtur gjashtë (6) takime gjatë vitit 2025.
Komisioni i vlerësimit të përformancës së Menaxhmentit, i përbërë prej tre (3) drejtorëve të Bordit, ka mbajtur gjashtë (6) takime gjatë vitit 2025.

2.3 MENAXHMENTI EKZEKUTIV DHE ROLI I TIJ

Menaxhmenti ekzekutiv i AKP-së ka përgjegjësi për administrimin e aktiviteteve të përditshme të Agjencisë dhe luan një rol mbështetës në zbatimin e vendimeve ekzekutive të Bordit. Edhe pse Bordi ka kompetenca ekzekutive, menaxhmenti mbetet i angazhuar në koordinimin dhe monitorimin e proceseve operative.

Gjatë periudhës raportuese, aktivitetet e përgjithshme të AKP-së janë menaxhuar nga Drejtori Ekzekutiv, Zëvendës Drejtori Ekzekutiv – Operativa, dhe Zëvendës Drejtori Ekzekutiv – Funksione të Përgjithshme. Sipas organogramit të ri të aprovuar në tetor 2023, AKP-ja ka pesë (5) departamente dhe shtatë 27 divizione.

2.4 PROCESI I VENDIMARRJES NË AKP

Vendimmarrja në AKP është një proces i strukturuar dhe i kontrolluar, i cili siguron që çdo hap të jetë në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret përkatëse. Procesi i vendimmarrjes përfshin këto hapa:

Propozimi i Vendimeve: Në fillim, divizionet e caktuara të AKP-së identifikojnë nevojat dhe mundësitë për privatizim, likuidim apo shitje të aseteve, si dhe shqyrtojnë situatën aktuale të aseteve. Pastaj, përgatisin propozime dhe raporte që paraqesin opsionet e mundshme për shitje.

Diskutimi dhe Rishikimi nga Bordi i Drejtorëve: Pas përgatitjes së propozimeve, menaxhmenti ekzekutiv i paraqet për shqyrtim dhe miratim në Bord. Bordi shqyrton propozimet dhe diskuton alternativat e mundshme. Bordi mund të kërkojë informacion shtesë dhe mund të sugjerojë ndryshime ose përmirësime në propozim.

Miratimi i Vendimeve: Pas shqyrtimit dhe diskutimeve, Bordi miraton vendimin përfundimtar. Ky vendim mund të jetë një vendim miratimi për procesin e privatizimit ose likuidimit të një NSh, për shitjen e një aseti, për shpalljen e ofertave, për qiradhënie ose për procedura të tjera të menaxhimit të aseteve.

Zbatimi i Vendimeve: Pas miratimit të vendimeve, Menaxhmenti Ekzekutiv është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të Bordit. Ky proces mund të përfshijë përgatitjen e tenderëve, kontratave dhe negociatave me investitorët. Menaxhmenti është përgjegjës për monitorimin e implementimit dhe siguron që të gjitha procedurat të ndodhin sipas ligjit dhe rregulloreve të përcaktuara.

Mbikëqyrja dhe Vlerësimi i Përformancës: Bordi gjithashtu mbikëqyrë procesin e implementimit dhe vlerëson rezultatet e shitjeve. Bordi mund të bëjë vlerësime periodike të përformancës dhe të kërkojë raporte mbi rezultatet e privatizimit dhe efektet afatgjata.

Përmes këtij procesi, AKP ka arritur të realizojë privatizime dhe likuidime të suksesshme, duke siguruar që pasuritë shtetërore të menaxhohen në mënyrë efikase dhe transparente.

KAPITULLI 3: SHITJA E ASETEVE

Metoda kryesore e AKP-së për shitjen e aseteve në procesin e likuidimit është shitja me tender publik. Në raste të veçanta dhe të arsyetuara ligjërisht, asetet shiten edhe përmes shitjeve direkte. Banesat në pronësi të NSh-ve u shiten shfrytëzueseve legjitim sipas kushteve dhe çmimit të përcaktuar me Ligjin për Banesa.

Përveç shitjeve të lartpërmendura, një numër i aseteve shpronësohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) dhe institucionet publike për interes të përgjithshëm, me kompensim të përcaktuar. Një numër më i vogël i aseteve përjashtohet nga procesi i shitjes për shkak të shfrytëzimit për interes publikë; AKP heqë dorë nga këto asete dhe pronësia mbi to bartet të komunat përkatëse pa kompensim.

Gjatë vitit 2025, përmes këtyre proceseve janë transformuar 307 asete në total, dhe janë realizuar të hyra në vlerë prej 19,760,716 €.

TRANSFORMIMI I ASETEVE (JANAR - DHJETOR 2025)		
Përshkrimi	**Nr. i aseteve të transformuara**	**Të hyrat nga shitja e aseteve €**
Shitja e aseteve me tender publik	81	16,123,308
Shitja direkte e aseteve	56	2,608,267
Shitja e banesave të NSh-ve	15	5,391
Shpronësimi i aseteve	11	1,023,750
Heqja dorë nga asetet	144[2]	n/a
Gjithsej:	**307**	**19,760,716**

3.1 SHITJA E ASETEVE ME TENDER PUBLIK

Procesi i shitjes së aseteve me tender realizohet përmes valëve të shitjes me likuidim, ku asetet individuale ofrohen blerësve potencial përmes tenderëve të hapur dhe konkurrues. Procesi përfshinë:

1. Përllogaritjen e çmimeve minimale (orientuese) dhe aprovimin e tyre nga Bordi;
2. Shpalljen e listës së aseteve për shitje;
3. Dorëzimin e ofertave;
4. Hapjen e ofertave;
5. Aprovimin e shitjeve;
6. Nënshkrimin e kontratave.

Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar katër valë të Shitjeve të Aseteve përmes Likuidimit (SHAL71-74) me tender publik, në kuadër të të cilave janë tenderuar gjithsej 380 asete. Për 91 asete (24%) janë pranuar oferta, ndërsa për 289 asete (76%) nuk është pranuar asnjë ofertë.

Nga asetet me oferta, 80 asete (88%) janë aprovuar, ndërsa 11 asete (12%) janë refuzuar, kryesisht për shkak se ofertat kanë qenë më të ulëta se çmimi minimal orientues.

Transaksionet e SHAL70, të përfunduara në janar 2025 (tender realizuar në nëntor 2024), përfshijnë 5 asete të aprovuara dhe 20 të refuzuara.

[2] Numri 144 paraqet asetet për heqje dorë të dorëzuara në BiD dhe në DhPGjSK për aprovim me gjithsej 104 raporte.

SHITJA E ASETEVE ME TENDER (JANAR DHJETOR 2025)						
Përshkrimi	**SHAL 67,69,70**	**SHAL71**	**SHAL72**	**SHAL73**	**SHAL74**	**Gjithsej**
Asete të tenderuara		71	77	98	134	380
Asete pa oferta		57	49	71	112	289
Asete me oferta		14	28	27	22	91
Asete të aprovuara	5	10	24	25	21	85
Asete të refuzuara	20	4	4	2	1	31
Kontrata të përmbyllura	13	8	23	21	16	81

3.2 SHITJA DIREKTE E ASETEVE

Sipas ligjit të AKP-së dhe rregullores së brendshme, asetet me karakter specifik[3] shiten përmes procedurave të shitjes direkte. Procesi fillon me kërkesë të palëve të interesuara. Nëse aseti i kërkuar hynë në kategorinë e aseteve specifike, BiD aprovon fillimin e procesit të shitjes direkte. Pas arritjes së marrëveshjes për kushtet dhe çmimin e shitjes, BiD aprovon realizimin e transaksionit. Ndërsa pas kryerjes së pagesës, nënshkruhet kontrata dhe prona bartet tek blerësi.

Gjatë vitit 2025, janë paraqitur 253 kërkesa të reja për blerje direkte, duke rritur numrin total të kërkesave të pranuara në 3,110. Ndërsa BiD ka aprovuar 116 raporte rekomanduese për fillimin e procedurave dhe 58 raporte përfundimtare për realizimin e shitjes.

SHITJA DIREKTE E ASETEVE		
Përshkrimi	**Viti 2025**	**Tërë procesi – deri 31 dhjetor 2025**
Numri i kërkesave të pranuara për shitje direkte	253	3110
Numri i kërkesave të shqyrtuara për shitje direkte	349	1531
Numri i raporteve rekomanduese të miratuara në BiD	116	762
Numri i raporteve përfundimtare të miratuara në BiD	58	437
Numri i kërkesave të refuzuara në BiD	226	666
Numri i kontratave të nënshkruara	56	421

3.3 SHITJA E BANESAVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Disa NSh kanë banesa në pronësi të tyre, të cilat më parë janë ndarë për punonjësit e NSh-ve. Shitja e këtyre banesave me të drejtë banesore bëhet sipas Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave.

Sipas këtij ligji, banesat mund t'i blejnë personat që plotësojnë këto kushte:

i. kanë pasur kontratën e të drejtës banesore para vitit 1999;
ii. kanë pasur vendimin e NSh-së për ndarjen e banesës në shfrytëzim; dhe
iii. kanë vazhduar të banojnë në banesë.

Në raste të caktuara, të drejtën e blerjes mund ta ushtrojnë edhe trashëgimtarët e personit me të drejtën banesore, në përputhje me kriteret ligjore.

[3] **Asetet specifike -** aset me karakter specifik perkufizohen ato asete ose pjesë të aseteve të cilat sipas gjendjes faktike, bazës ligjore te pretendimit, vetive ose karakteristikave tjera, përbëjnë çështje me natyrë specifike ose komplekse, me ç'rast si pasojë e rrethanave të tilla të drejtat pronësore mbi këto asete nuk mund të barten tek palët e treta në mënyrë eksluzive përmes rregullave të tenderimit publik ose parashihet se tenderimi publik krijon efekte negative në procesin e transformimit pronësor të një aseti konkret.

Afati për paraqitjen e aplikimeve për blerjen e banesave ka përfunduar më 12 tetor 2024. Aktualisht pritet që Kuvendi i Kosovës të shqyrtojë mundësinë e zgjatjes së këtij afati, me qëllim që t'u mundësohet aplikimi edhe palëve që nuk kanë arritur të paraqesin kërkesë brenda afatit të përcaktuar.

Procesi i trajtimit të kërkesave fillon me paraqitjen e kërkesës nga palët e interesuara. Kërkesat shqyrtohen nga Komisioni i Banesave i AKP-së, ndërsa BiD merr vendim për aprovimin on ose refuzimin e tyre .

Gjatë vitit 2025, janë shqyrtuar 41 kërkesa; 15 janë aprovuar për shitje, 12 janë refuzuar si të pabazuara, dhe 16 janë refuzuar për shkak të jo kompetencës së AKP-së. Ndërkohë, 91 kërkesa mbeten pa u shqyrtuar dhe do të trajtohen gjatë vitit vijues.

SHITJA E BANESAVE		
Përshkrimi	**2025**	**Tërë procesi**
Numri total i kërkesave të pranuara në AKP	132	1,945[4]
Numri i kërkesave të shqyrtuara në BiD	41	1,742
Numri i kërkesave të aprovuara nga BiD	13	941
Numri i kërkesave të refuzuara nga BiD	12	401
Numri i kërkesave të refuzuara për shkak se AKP nuk është kompetente	16	400
Numri i kërkesave të pa shqyrtuara	91	91
Numri i kontratave të nënshkruara për shitjen e Banesave	15	375

3.4 SHPRONËSIMI I ASETEVE TË NSH-VE

Shpronësimi është një proces ligjor, ku Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK), apo institucioni publik merr një aset të NSh-së për interes publik, duke paguar kompensim. Vendimin për shpronësim e merr QRK, ndërsa AKP ndihmon në menaxhimin e procesit dhe zgjidhjen e çështjeve ligjore.

Procesi i shpronësimit kalon nëpër disa faza:

1. Institucioni përkatës propozon shpronësimin për një projekt publik;
2. QRK merr vendimin preliminar, ndërsa Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) e shqyrton statusin e pronës, përgatitë elaboratin dhe bënë vlerësimin e saj;
3. QRK merr vendimin përfundimtar dhe Ministria e Financave bënë vlerësimin e asetit.

Sa i përket kompensimit, QRK fillimisht paguan 20% të çmimit të caktuar, që përdoret për të paguar punëtorët e NSh-ve në emër të 20%-shit. Nëse NSh-ja përkatëse nuk ka fonde të mjaftueshme për të paguar kreditorët e ligjshëm, QRK paguan kreditorët, por gjithmonë jo me shumë se shuma e papaguar e mbetur, që do të thotë deri në 100% të çmimit të caktuar.

Gjatë vitit 2025, janë marrë 11 vendime përfundimtare për shpronësimin e aseteve , ndërsa të hyrat e pranuara nga shpronësimi ishin 1,023,750 €.

SHPRONËSIMI I ASETEVE		
Përshkrimi	**2025**	**2010-2025**
Vendimete preliminare të QRK për shpronësim	33	700

[4] Nga gjithsej 1,945 kërkesa të pranuara, Komisioni i Banesave ka konstatuar se vetëm 1,742 kërkesa kanë plotësuar kushtet për trajtim të mëtutjeshëm.

VendimeT përfundimtare të QRK për shpronësim	11	194
Vlera totale e aseteve të shpronësuara sipas vendimeve përfundimtare (€)	*[5]	107,927,644
Shuma e paguar nga QRK për asetet e shpronësuara (€)	1,023,750	30,318,616
Shuma e mbetur për pagesë (€)	N/A	77,609,028

Gjatë periudhës 2010-2025, QRK ka marr 894 vendime për shpronësim me vlerë totale prej 107,927,644 €. Nga kjo shumë, janë paguar 30,318,616 €, ndërsa 77,609,028 € mbeten të papaguara. Shuma e mbetur shlyhet vetëm për kreditorë të ligjshëm dhe në përputhje me kërkesat e tyre; në mungesë të kreditoreve ose nëse kërkesat e aprovuara janë më të ulëta se shuma e mbetur, QRK nuk është e detyruar të paguajë të gjithë shumën. Vonesat eventuale në këtë proces mund të ndikojnë në përmbylljen e likuidimit të NSh-ve.

3.5 HEQJA DORË NGA ASETET

Disa asete apo pjesë të aseteve përjashtohen nga procesi i shitjes, pasi shfrytëzohen për interes publik (p.sh. varreza, lapidare, rrugë publike, shtretër të lumenjve etj). AKP heqë dorë nga këto asete, dhe pronësia mbi to bartet tek komunat përkatëse pa kompensim. Vendimin për heqje dorë nga asetet e merr BiD sipas propozimit të Autoritetit të Likuidimit, ndërsa vendimin përfundimtar e jep Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK). Gjatë vitit 2025, AKP ka hequr dorë nga 144 asete.

HEQJE DORË NGA ASETET		
Përshkrimi	**Janar-dhjetor 2025**	**Tërë procesi**
Numri total i aseteve për heqje dorë	144	225
Numri i raporteve të dorëzuara në BiD për aprovim	104[6]	168
Numri i raporteve të aprovuara / refuzuara nga BiD	0	0
Numri i raporteve të aprovuara / refuzuara nga DhPGjSK	0	0
Numri i raporteve në pritje të aktvendimit nga DhPGjSK	64	168
Numri i aseteve të mbetura për heqje dorë	347	347

Sfidat kryesore të procesit të heqjes dorë prej aseteve janë:

i. Mungesa e informatave / aktvendimeve nga DhPGjSK;
ii. Mungesa e të dhënave kadastrale;
iii. Vendimet e autoriteteve publike të vendit ku ndodhen asetet;
iv. Çështjet që kanë të bëjnë me uzurpimin e këtyre aseteve; si dhe
v. Vështirësitë në qasjen në objektet e aseteve që ndodhen jashtë vendit.

[5] Nuk janë bërë ende raportet e vlerësimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës
[6] Numri 104 paraqet raportet për heqje dorë të aseteve të dorëzuara në BiD dhe në DhPGjSK për aprovim me gjithsej 144 asete/ngastra.

KAPITULLI 4: LIKUIDIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore (NSh) është procesi i mbylljes së NSh-ve të paqëndrueshme dhe transformimin e aseteve për përdorim optimal dhe për të stimuluar zhvillimin ekonomik.

Pas përcaktimit të statusit të një NSh-je, me vendim të BiD, ajo vendoset në likuidim dhe i caktohet Autoriteti i Likuidimit (AL)i cili e udhëheq procesin e likuidimit. Funksionin e AL-së e ushtron Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (OShP) i angazhuar përmes procedurave të prokurimit[7]. Në rast se NSh nuk ka asete ose kërkesa kreditore, procesin e udhëheq Divizioni i Likuidimit i AKP-së.

Shitja e aseteve kryhet sipas procedurave përkatëse, ndërsa pas shitjes shpërndahen mjetet për punëtorët (20%) dhe kreditorët. Procesi përfundon me vendim të Dhomës së Posaçme dhe ndërmarrja shuhet.

Në këtë kapitull paraqiten aktivitetet e AKP-së dhe rezultat e arritura në procesin e likuidimit të NSh-ve, duke përfshirë: përcaktimin e statusit të NSh-ve; vendosjen e tyre në likuidim; shpërndarjen e fondeve për punëtorët (në emër të 20%-shit) dhe të kreditorët; si dhe përmbylljen e procesit të likuidimit.

4.1 PËRCAKTIMI I STATUSIT TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Për të vendosur një ndërmarrje në likuidim, duhet të vlerësohet nëse ajo është NSh dhe bën pjesë në mandatin e AKP-së, apo ka status tjetër juridik jashtë mandatit të Agjencisë. Statusin e NSh-ve e shqyrton dhe rekomandon komisioni i posaçëm i AKP-së, ndërsa vendimin e merr BiD. Gjatë vitit 2025, BiD ka aprovuar statusin për një (1) ndërmarrje, me rekomandim të komisionit.

STATUSI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE	
Statusi i NSH-ve	**Viti 2025**
Numri i NSh-ve me status të aprovuar nga BiD	1
Numri i ndërmarrjeve në pritje të shqyrtimit të statusit nga BiD	10

4.2 VENDOSJA E NSH-ve/ASETEVE NË LIKUIDIM

Pas përcaktimit të statusit të një NSh-je, me vendim të BiD ndërmarrja/aseti vendoset në likuidim, shpallet fillimi i procesit dhe caktohet AL për ta udhëhequr procesin.

Nëse NSh-ja nuk ka asete dhe / ose kërkesa kreditore, procesin e likuidimit e udhëheq divizioni i likuidimit i AKP-së. Gjatë vitit 2025, tre (3) NSh të reja janë vendosur në likuidim, ndërsa aktualisht janë 534 NSh në proces likuidimi.

LIKUIDIMI I NSH-ve			
Përshkrimi	**Numri i NSh-ve**	**Të vendosura në likuidim**	**Të likuiduara**
Likuidimi nga Autoriteti i Likuidimit	543	513	30
Likuidimi nga divizioni i likuidimit i AKP	55	21	34
Numri i NSH-ve në likuidim	**598**	**534**	64

[7] Gjatë vitit 2025, funksionin e AL-së e ka ushtruar konzorciumi i përbërë prej tri kompanive ndërkombëtare konsulente Curtis Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton LLC.

NSH ende të pavendosura në likuidim	16	-	-
Gjithsej NSH nën administrim të AKP-së	**614**	**534**	**64**

4.3 SHQYRTIMI I KËRKESAVE TË PUNËTORËVE PËR 20% NGA SHITJA DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE

Punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore kanë të drejtë të përfitojnë 20% nga të hyrat e realizuara nga shitja e aseteve të NSh-ve. Procesi i hartimit dhe përpunimit të listave të punëtorëve përfitues rregullohet me Rregulloret e UNMIK-ut 2003/13 dhe 2004/45, si dhe me aktet nënligjore të AKP-së.

Lista fillestare e punëtorëve hartohet nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK) dhe shqyrtohet nga AKP, e cila bën korrigjimet e nevojshme dhe e publikon për ankesa. Punëtorët e pakënaqur kanë të drejtë ankese brenda afatit prej 20 ditësh.

Pas shqyrtimit të ankesave, formohet lista përfundimtare e punëtorëve të kualifikuar, e cila miratohet nga BiD i AKP-së së bashku me shpërndarjen e parakohshme të 20%-it. Pas publikimit të listës përfundimtare, palët e pakënaqura mund të paraqesin ankesa pranë Dhomës së Posaçme brenda 20 ditësh. Pas vendimit final të Dhomës së Posaçme, realizohet shpërndarja e fondeve të mbetura për punëtorët përfitues.

Gjatë vitit 2025, janë shpërndarë 5,822,538.19 € për 7,566 punëtorë përfitues të 20%-shit nga shitja e aseteve të NSh-ve.

LISTAT E PUNËTORËVE TË NSH-VE PËR 20%		
Përshkrimi	**Janar- dhjetor 2025**	**Tërë procesi**
Shuma e shpërndarjeve të 20%-it për punëtorët	5,822,538	172,743,241
Numri i listave finale të punëtorëve	23	416
Numri i punëtorëve për të cilët janë bërë pagesat	7,566	52,187
Numri vendimeve të formës së prerë nga Dhoma e Posaçme	0	306
Numri i listave finale në pritje për shqyrtim nga gjykata	23	110

4.4 SHQYRTIMI I KËRKESAVE KREDITORE DHE SHPËRNDARJA E MJETEVE

Pas vendosjes së një NSh-je në likuidim, kreditorët kanë të drejtë të paraqesin kërkesat për borxhet e pretenduara ndaj ndërmarrjes. AL i shqyrton këto kërkesa dhe harton listën e përkohshme të kreditorëve, në të cilën pasqyrohen kërkesat e pranuara dhe të refuzuara. Kundër vendimeve të AL-së, kreditorët kanë të drejtë ankese.

Pas shqyrtimit të ankesave, hartohen listat përfundimtare të kreditorëve, kundër të cilave mund të parashtrohen ankesa pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës. Pas vendimit përfundimtar të Dhomës së Posaçme realizohet shpërndarja përfundimtare e fondeve për kreditorët[8]. Kreditorët paguhen sipas rendit të përparësisë të përcaktuar me legjislacionin në fuqi[9]. Pas përfundimit të pagesave, procesi i likuidimit mbyllet me raport përfundimtar, i cili dorëzohet për aprovim në

[8] Mund të bëhet shpërndarja e pjesshme e mjeteve ndaj kreditorëve para vendimit të Dhomës së Posaçme nëse dihet numri dhe vlera e pretenduar e ankesave dhe mjetet janë rezervuar për vlerën e ankesave.
[9] Trajtimi i kërkesave kreditore me prioritet: i) shpenzimet e likuidimit, ii) punëtorët (paga të papaguara dhe benefite), iii) kreditorët e siguruar (ata që kanë kolateral), dhe iv) kreditorët e tjerë të zakonshëm.

Dhomën e Posaçme. Në rastet kur fondet e realizuara nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha kërkesat kreditore, kreditorët mund të pësojnë humbje të pjesshme ose të plotë.

Gjatë vitit 2025, janë aprovuar pagesa për 1,889 kërkesa kreditore në vlerë prej 2,751,476 €, ndërsa janë shpërndarë mjete në shumë totale prej 3,576,357 €.

PAGESA E KREDITORËVE TË NSh-ve					
Përshkrimi	**Viti 2025 (€)**	**Viti 2024 (€)**	**Viti 2023 (€)**		**2011- 2025 (€)**
Pagat e punëtorëve	3,084,029	2,654,378	735,798		29,064,695
ATK	25,883	168,058	700,239		10,403,164
Trustet pensionale	178,407	142,374	104,932		4,794,801
Tatimi në pronë	7856	54,860	318,586		3,175,904
Komunalitë	60,713	35,808	221,490		4,160,103
Kreditorë të tjerë	219,469	1,691,142	1,749,683		18,334,423
Gjithsej	**3,576,357**	**4,746,620**	**3,830,728**		**69,933,090**

PAGESAT E APROVUARA KUNDREJT PAGESAVE TË SHPËRNDARA NDAJ KREDITORËVE			
Viti	**Shuma (në €)**	**Pagesa (në €)**	**Diferenca (në €)**
2010-2019	30,526,889	30,392,813	134,076
2020	5,766,047	5,686,030	80,017
2021	8,357,696	8,261,818	95,878
2022	15,077,430	14,834,895	242,535
2023	2,941,587	2,906,255	35,332
2024	5,659,765	5,206,289	453,476
2025	2,751,476	2,644,990	106,486
Për korrigjim v.2024	(809)	-	(809)
Gjithsej	**71,080,081**	**69,933,090**	**1,146,991**[10]

Sfidat kryesore që ndikojnë në shqyrtimin e kërkesave kreditore janë:

I. Mos-realizimi i shitjeve sipas planit apo kalendarit të shitjes;
II. Vonesat eventuale të Dhomës së Posaçme në zgjidhjen e ankesave të kreditorëve;
III. Mungesa e informatave nga Dhoma e Posaçme për numrin dhe vlerën e ankesave të kreditorëve;
IV. Mos-realizimi i pagesave nga ana e QRK-së për asetet e shpronësuara.

4.5 MBYLLJA E PROCESEVE TË LIKUIDIMIT

Mbyllja e procesit të likuidimit të NSh-ve bëhet me aktvendim të Dhomës së Posaçme, bazuar në raportin përfundimtar të aprovuar nga BiD i AKP-së. Një NSh konsiderohet e mbyllur pas përfundimit të shitjes së të gjitha aseteve, shlyerjes së kërkesave të punëtorëve dhe kreditorëve dhe shpërndarjes së fondeve, marrjes së vendimit për shuarje, si dhe çregjistrimit të ndërmarrjes nga regjistrat përkatëse.

Deri në fund të vitit 2025, sipas aktvendimeve të Dhomës së Posaçme, janë mbyllur gjithsej 64 NSh. Aktualisht, në DhPGjSK janë në shqyrtim raportet përfundimtare për përmbylljen e pesë (5) NSh-ve të tjera.

[10] Shuma e papaguar prej 1,146,991 përfshinë periudhën nga viti 2019 deri 31 dhjetor 2025.

NUMRI I NSH-VE TË MBYLLURA & NË PROCES TË MBYLLJËS		
Aktivitetet	**Viti 2025**	**Tërë procesi**
Numri i NSh-ve të mbyllura me aktvendim nga DhPGjSK	5	64
Numri i NSh-ve në proces të mbylljes nga DhPGjSK	5	5

Sfidat kryesore që ndikojnë në përmbylljen e procesit të mbylljes së NSh-ve janë:

i. Kontestet pronësore dhe ligjore;
ii. Ankesat e kreditorëve;
iii. Procedurat e gjata gjyqësore të Dhomës së Posaçme;
iv. Mos-realizimi i shitjes së aseteve;
v. Lëndët/paditë për vërtetim të pronësisë të deleguara nga DhPGjSK në Gjykatat Themelore;
vi. Vështirësitë në identifikimin e aseteve të NSh-ve të deklaruara si pa asete.

KAPITULLI 5: MENAXHIMI I ASETEVE TË MBETURA TË NSH-VE

Ky kapitull jep një pasqyrë të detajuar mbi asetet e NSh-ve që ende nuk janë privatizuar, duke përfshirë gjendjen aktuale, kategoritë e aseteve të mbetura, si dhe planet e AKP-së për menaxhimin dhe transformimin e tyre në përputhje me mandatin ligjor dhe interesin publik.

5.1 PLANI I TRAJTIMIT TË ASETEVE TË MBETURA

Në fund të vitit 2025, asetet e mbetura (të pa shitura) të NSh-ve nën administrimin e AKP-së janë gjithsej **15,507** asete. Prej tyre, **15,163** janë parcela me ose pa objekte , ndërsa 344 janë objekte pa tokë. Veç këtyre, evidencohen edhe 191 asete tjera të NSh-ve që ndodhen jashtë jashtë territorit të Kosovës. Sipas planit strategjik të AKP-së, asetet e mbetura të NSh-ve planifikohet të trajtohen dhe transformohen si vijon:

- **5,703 parcela dhe objekte** planifikohet të barten tek Fondi Sovran (FS). Aktualisht, FS nuk është themeluar ende, pasi Ligji për FS (i miratuar në vitin 2023) është dërguar për shqyrtim në Gjykatë Kushtetuese dhe pritet vendimi përfundimtar. Deri në themelimin e FS-së, këto asete mund të barten për menaxhim të përkohshëm tek ndonjë institucion tjetër publik.
- **3,121 parcela** (tokë, pyje, kullosa) planifikohet të barten tek Agjencia Pyjore. Sipas Ligjit për Pyjet nr. 08/L-137 i vitit 2023, pronësia mbi pyjet dhe tokat pyjore ka kaluar tek Agjencia Pyjore në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Megjithatë, procesi i dorëzim – pranimit ende nuk ka ndodhur për shkak të mosgatishmërisë së Agjencisë së Pyjeve për pranimin e këtyre aseteve.
- **574 parcela** planifikohet të barten tek institucione të ndryshme për interes publik, përmes procedurave të shpronësimit, bazuar në vendimet e QRK-së.
- **545 parcela** do të jenë subjekt i heqjes dorë në interes publik, pasi aktualisht shfrytëzohen si pasuri të përbashkëta publike dhe si të tilla nuk mund t'i nënshtrohen procesit të shitjes.
- **4,268 parcela dhe 332 objekte** planifikohet të shiten përmes procedurave të tenderimit publik.
- **952 parcela** do të trajtohen përmes shitjes direkte, për shkak të kërkesave të paraqitura nga palët e interesuara. Në rast se këto kërkesa refuzohen si të pabazuara, asetet përkatëse do t'i nënshtrohen procedurave të tenderimit publik.

Numri total i aseteve si dhe kategorizimi i tyre mund të ndryshojnë në periudhat pasuese, varësisht nga ndryshimi i statusit të NSh-ve apo identifikimi e aseteve të reja.

RI-KATEGORIZIMI I PARCELAVE / NGASTRAVE				
Përshkrimi	**Numri i parcelave me / pa objekte**	**Numri i objekteve pa parcela**[1]	**Total parcela dhe objekte**	**Në %**
Asetet për Fond Sovran	5,703	12	5,715	36.86%
Asetet për Agjencinë Pyjore	3,121	0	3,121	20.12%
Asetet interes Publik	574	0	574	3.70%
Asetet për heqje dorë	545	0	545	3.51%
Asete për shitje me tender	4,268	332	4,600	29.66%
Asete për shitje direkte	952	0	952	6.13%
Gjithsej	**15,163**	**344**	**15,507**	**100%**

Është përfunduar projekti për vizualizimin e pronave në platformën e tatimit në pronë. Faza e dytë e projektit ka përfunduar në fund të vitit 2025, ndërsa gjatë muajit janar 2026 është finalizuar i gjithë projekti.

Sfidat kryesore në procesin e administrimit të aseteve të mbetura dhe transformimit të tyre janë:

i. Vendosja e masave të përkohshme nga DhPGjSK;
ii. Vendosja e masave të përkohshme nga Gjykatat e tjera, përfshirë kërkesat për masa të përkohshme pa vendim të DhPGjSK;
iii. Procesi i komasacionit;
iv. Mungesa e dokumentacionit të pronësisë si dhe të dhënat e vjetruara kadastrale në rastet kur NSh-të posedojnë informacione të pasakta sa i përket pronësisë të aseteve të caktuara;
v. Mungesa e bashkëpunimit nga zyrat Komunale Kadastrale, të cilat në shumë raste refuzojnë azhurnimin e të dhënave kadastrale;
vi. Mosrealizimi me kohë i pagesave për pronat e shpronësuara nga ana e QRK-së;
vii. Parcelimet, mospërputhjet e gjendjes grafike dhe asaj tekstuale, mungesa e ndarjeve grafike dhe çështje të tjera teknike Kadastrale .

5.2 ASETET JASHTË KOSOVËS

Përveç aseteve të paraqitura më lartë, evidencohen edhe 191 asete të NSh-ve që ndodhen jashtë territorit të Kosovës, në vendet e rajonit. Në këtë numër përfshihen edhe 22 asete të Ndërmarrjes Trepça.

Deri në vitin 2025, AKP është përballur me vështirësi të konsiderueshme në procesin e shitjes së këtyre aseteve. Për shkak të mungesës së të dhënave të mjaftueshme dhe dokumentacionit përkatës, ka qenë e pamundur të realizohet shitja e tyre përmes procedurave të përcaktuara me ligjin e AKP-së. Si pasoj, ekziston rreziku që këto asete të barten në pronësi të palëve të treta, bazuar në vendimet e gjykatave të shteteve ku ndodhen asetet përkatëse.

Gjatë vitit 2025 janë bërë përpjekje për ritenderimin e aseteve për shitje, mirëpo janë hasur pengesa kadastrale në evidencat e Agjencisë Kadastrale të Malit të Zi**.** Këto pengesa janë mënjanuar në fund të vitit, dhe pritet që gjatë vitit 2026 të tenderohen asetet e ndërmarrjeve shoqërore në Mal të Zi**.**

ASETET E PASHITURA JASHTË KOSOVËS	
Shteti	**Numri i Aseteve**
Bosna dhe Hercegovina	20
Kroaci	8
Mali i Zi	40
Maqedoni	7
Serbi	115
Slloveni	1
Gjithsej	**191**[11]

[11] Brenda totalit të aseteve jashtë Kosovës janë edhe 22 asete të ndërmarrjes Trepca dhe atë: 3 asete në Bosne dhe Hercegovinë, 3 në Kroaci, 5 në Mal të Zi, dhe 11 në Serbi.

KAPITULLI 6: ADMINISTRIMI I NSH-VE DHE QIRADHËNIA E ASETEVE

Ndërmarrjet shoqërore administrohen nga AKP deri në përmbylljen e plotë të procesit të likuidimit të tyre, në përputhje me kompetencat autorizimet ligjore dhe rregullative në fuqi. Gjatë kësaj periudhe, AKP mban përgjegjësi të plotë për administrimin, ruajtjen dhe menaxhimin e aseteve të NSh-ve, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerës së tyre ekonomike dhe juridike.

Deri në momentin e shitjes, tjetërsimit ose bartjes së aseteve tek institucionet përkatëse publike ose tek subjektet tjera, asetet jepen në shfrytëzim përmes procedurës së qiradhënies. Kjo paraqet një masë të përkohshme të menaxhimit aktiv, me synim gjenerimin e të hyrave, parandalimin e degradimit të aseteve dhe sigurimin e mirëmbajtjes së tyre.

Ky kapitull paraqet një pasqyrë të detajuar dhe të strukturuar të procesit të administrimit të NSh-ve dhe të qiradhënies së aseteve të tyre, duke trajtuar aspektet ligjore, administrative dhe operative, si dhe sfidat kryesore që shoqërojnë këto procese deri në përmbylljen përfundimtare të likuidimit.

6.1 ADMINISTRIMI I NSH-VE

Prej momentit të vendosjes së NSh-ve në likuidim dhe deri në përmbylljen përfundimtare të këtij procesi, ato administrohen nga Autoriteti i Likuidimit në kuadër të AKP-së, në përputhje me mandatin ligjor dhe rregullativ në fuqi. Aktualisht, 534 NSh gjenden në proces likuidimi.

Nga ky numër, 532 ndërmarrje nuk zhvillojnë aktivitet operativ dhe administrohen kryesisht në aspektin e ruajtjes, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes juridike të aseteve të tyre. Vetëm dy (2) NSh, përkatësisht NSh “Grand Hotel” dhe NSh “Tregu”, kanë vazhduar operimin edhe pas vendosjes në likuidim, nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Autoritetit të Likuidimit.

Vazhdimi i operimit të këtyre dy (2) ndërmarrjeve paraqet një situatë të jashtëzakonshme dhe komplekse, e cila kërkon angazhim të shtuar institucional nga AKP, përtej detyrave standarde të administrimit të likuidimit. Ky angazhim përfshin menaxhimin e përkohshëm operativ, mbikëqyrjen financiare, trajtimin e çështjeve të marrëdhënieve të punës, mirëmbajtjen e objekteve, si dhe koordinim të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe lokale, me qëllim të sigurimit të funksionimit minimal dhe ruajtjes së vlerës ekonomike dhe publike të aseteve përkatëse.

Zgjidhja përfundimtare e statusit të NSh “Grand Hotel” dhe NSh “Tregu” nuk varet ekskluzivisht nga AKP, por është e kushtëzuar nga vendimmarrja e institucioneve qendrore dhe lokale, duke përfshirë çështjet që lidhen me funksionin publik të këtyre objekteve, planifikimin urban, interesin publik dhe modelet e ardhshme të menaxhimit apo tjetërsimit të tyre. Në këtë kontekst, AKP ushtron rol administrues dhe stabilizues të përkohshëm, deri në marrjen e vendimeve përfundimtare nga autoritetet kompetente.

Ndërkohë, nga gjithsej pesë (5) NSh që gjenden nën administrim direkt të AKP-së, vetëm NSh “Inex Sharr Planina – Brezovicë” vazhdon të operojë me aktivitetin e saj primar, për shkak të rëndësisë së saj ekonomike dhe turistike, si dhe nevojës për menaxhim të vazhdueshëm operacional.

Shumica e ndërmarrjeve shoqërore, pavarësisht mungesës së aktivitetit operativ, disponojnë asete të ndryshme të luajtshme dhe të paluajtshme, të cilat administrohen nga AKP përmes Autoritetit të Likuidimit dhe administratorëve të emëruar, me fokus në ruajtjen e tyre, gjenerimin e të hyrave përmes qiradhënies dhe parandalimin e uzurpimeve ose degradimit.

NSH OPERATIVE DHE JO OPERATIVE		
	Në administrim të AL-së	**Në administrim direkt**
NSh me aktivitet operativ	2	1
NSh pa aktivitet operativ	532	4
Gjithsej	**534**	**5**

NSH INEX SHARR PLANINA BREZOVICË

Me Vendimin e Bordit të Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), Nr. BD-144-13, të datës 22 dhjetor 2020, Ndërmarrja Shoqërore Inex Sharr Planina, Brezovicë është vendosur nën Administrim Direkt të AKP-së, për shkak të rëndësisë së saj strategjike ekonomike dhe turistike, si dhe për nevojën e një menaxhimi të vazhdueshëm dhe të centralizuar.

Bordi i Drejtorëve të AKP-së, bënë emërimin e anëtarëve të Bordit të Përkohshëm Menaxhues të NSH "Inex Sharr Planina" – Brezovicë.
Bordi i ndërmarrjes përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët ushtrojnë funksionet e tyre në përputhje me mandatin e përcaktuar nga AKP.

Burimet Njerëzore dhe Operimi

Aktualisht, ndërmarrja ka të punësuar gjithsej 102 persona, të strukturuar si vijon:

- 69 punëtorë aktivë, me paga të rregullta;
- 22 punëtorë të angazhuar përmes skemës sociale, me kompensim mujor prej 100 €;
- 11 punëtorë pa pagesë.

Gjatë sezonit dimëror turistik, ndërmarrja angazhon rreth 50 punëtorë sezonalë, të cilët kontribuojnë drejtpërdrejt në funksionimin e Qendrës së Skijimit në Brezovicë, në pozita të ndryshme operative dhe teknike.

Të hyrat dhe Performanca Financiare

Të hyrat kryesore të ndërmarrjes janë realizuar gjatë sezonit dimëror janar–mars 2025, kryesisht nga aktivitetet operative të Qendrës së Skijimit dhe Hotelit "Molika".

Të ardhura shtesë janë siguruar nga:

- Dhënia me qira e aseteve të ndryshme të ndërmarrjes; dhe
- Shfrytëzimi i sallës së Hotelit "Narcis" për organizimin e dasmave dhe ngjarjeve gjatë sezonit veror.

Falë këtyre aktiviteteve, deri në fund të vitit 2025 ndërmarrja ka arritur:

- Të realizojë pagesat e rregullta për punëtorët;
- Të mbulojë shpenzimet operative dhe funksionale; dhe
- Të kryejë një pjesë të konsiderueshme të pagesave të nevojshme për përgatitjen e sezonit dimëror 2025/2026.

Gjatë vitit 2025:

- Janë dhënë me qira 15 asete, nga të cilat janë inkasuar 75,601 €;
- Të hyrat nga aktivitetet operative kanë arritur shumën prej 779,998 €.

Investimet Strategjike dhe Huazimi i Mjeteve

Për zbatimin e Planit Strategjik të Investimeve 2025–2026, të miratuar me Vendimin Nr. Ref. BD-224/3, ndërmarrja ka pasur nevojë për huazim të mjeteve financiare, me qëllim të realizimit të investimeve strategjike dhe përgatitjes adekuate për sezonet e ardhshme turistike.

Në këtë kuadër, janë huazuar mjete nga Tarifa Administrative, në vlerë totale prej 998,000 €, të përbëra nga:

- 88,076.26 € mjete të mbetura nga huazimi paraprak; dhe
- 909,923.74 € mjete shtesë.

Këto fonde janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve që lidhen me:

- Servisimin dhe furnizimin e makinerive me pajisje për mirëmbajtjen dhe rrafshimin e shtigjeve të skijimit;
- Sanimin, rinovimin dhe pajisjen e Hotelit "Molika";
- Zhvillimin e aktiviteteve të turizmit veror;
- Blerjen e dy (2) rrafshuesve të borës;
- Instalimin e sistemit Access Control;
- Implementimin e një programi gjithëpërfshirës ERP për menaxhimin e biznesit.

Ndërhyrjet Teknike dhe Përgatitjet për Sezonin Dimëror 2025/2026

Në kuadër të zbatimit të Planit Strategjik të Investimeve dhe përgatitjes për sezonin dimëror 2025/2026, gjatë vitit 2025 janë realizuar një sërë ndërhyrjesh dhe riparimesh teknike, përfshirë:

- Incizimin, servisimin dhe mirëmbajtjen e sajllave dhe pajisjeve të skijimit;
- Përmirësimin e teleferikut "Bacila" përmes furnizimit me pjesë rezervë;
- Blerjen e pjesëve rezervë për rifunksionalizimin e skiliftit "Munika", me qëllim rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve;
- Riparimin e rrafshuesit ekzistues të borës, përmes zëvendësimit të zingjirit lëvizës.

Shpenzimet nga Tarifa Administrative

Gjatë vitit 2025, vlera e mjeteve të shpenzuara nga Tarifa Administrative ka arritur 153,829.91 €. Këto mjete janë përdorur për mbulimin e nevojave operative dhe investuese të ndërmarrjes dhe parashihet të kthehen në momentin kur ndërmarrja të sigurojë të hyra vetanake të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e saj operative.

Një sfidë me ndikim të drejtpërdrejtë financiar për Ndërmarrjen Shoqërore "Inex Sharr Planina" – Brezovicë mbetet rritja e pagës minimale, e cila ka sjellë një shtim të ndjeshëm të kostove të personelit dhe të ngarkesës financiare operative.

Kjo rritje ka ndikuar veçanërisht në strukturën aktuale të punësimit, e cila është trashëguar nga periudha të mëhershme dhe nuk është plotësisht e harmonizuar me nevojat reale operative dhe kapacitetet financiare të ndërmarrjes.
Në mungesë të një riorganizimi të plotë funksional e strukturor, rritja e pagës minimale ka ushtruar presion shtesë mbi buxhetin e ndërmarrjes, duke rritur shpenzimet fikse mujore dhe duke kufizuar fleksibilitetin financiar për investime të reja dhe zhvillim të mëtejshëm operativ.
Si masë afatmesme, gjatë vitit 2026 është planifikuar riorganizimi i ndërmarrjes në përputhje me organogramin e ri, i cili do të reflektojë nevojat reale operative, racionalizimin e burimeve njerëzore, qartësimin e përgjegjësive funksionale dhe rritjen e efikasitetit organizativ.

Deri në realizimin e këtij riorganizimi, ndërmarrja do të vazhdojë të përballet me barrë të shtuar financiare, që kërkon menaxhim të kujdesshëm dhe mbështetje institucionale për të ruajtur stabilitetin operativ.

TË HYRAT DHE SHPENZIMET GJATË VITIT 2025 PËR NSH BREZOVICA					
Paraja më 01.01.2025	**Inkasimet nga Aktiviteti Operativ**	**Inkasimet nga qiratë**	**Total inkasimet 2025**	**Paraja më 31.12.2025**	**Rritja / Zvogëlimi i parave**
42,911	779,998	75,601	855,600	886,987	11,524

HUAZIMI NGA TARIFA ADMINISTRATIVE E AKP-së	SHPENZIMET NGA TARIFA ADMINISTRATIVE E AKP-së
998,000	153,829.91

6.2 QIRADHËNIA E ASETEVE TË NSH-VE

Ndërmarrjet Shoqërore nën administrimin e AKP-së disponojnë një numër të konsiderueshëm asetesh të cilat, për shkak të çështjeve pronësore dhe/ose kadastrale, aktualisht nuk mund t'i nënshtrohen procesit të shitjes. Deri në zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe realizimin e shitjes, asetet jepen me qira me qëllim të ruajtjes dhe, në masën e mundshme, rritjes së vlerës së tyre ekonomike, si dhe gjenerimit të të hyrave të rregullta.

Në parim, qiradhënia realizohet përmes procedurave të tenderimit publik, ndërsa në raste të veçanta dhe të arsyetuara, aplikohet procedura e drejtpërdrejtë, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Kontratat e qirasë zakonisht lidhen për periudhë njëvjeçare, me mundësi vazhdimi ose shkëputjeje të parakohshme sipas kushteve kontraktuale. Qiramarrësi nuk fiton të drejtë përparësie për blerje dhe nuk konsiderohet i kualifikuar për blerje direkte të asetit.

Gjatë vitit 2025, totali i të hyrave nga asetet në likuidim dhe tranzicion arriti në 6,455,610 €, që përfaqëson rreth 500,000 € më shumë krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje ka kontribuar në përmirësimin e likuiditetit dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve operative të ndërmarrjeve në administrim.

Përformanca financiare nga qiradhënia

Të dhënat financiare tregojnë një trend rritës të të hyrave nga qiraja, veçanërisht gjatë vitit 2025, si rezultat i intensifikimit të aktiviteteve të qiradhënies, rritjes së numrit të aseteve aktive në qira dhe përmirësimit të menaxhimit të portofoliot. Kjo rritje ka kontribuar në përmirësimin e likuiditetit dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve operative të ndërmarrjeve në administrim.

Gjatë vitit 2025, totali i të hyrave nga asetet ne likuidim dhe tranzicion arriti në 6,455,610 €, apo afërsisht 500,000€ më shumë krahasuar me vitin 2024. Kjo rritje ka kontribuar në përmirësimin e likuiditetit dhe në mbulimin e një pjese të shpenzimeve operative të ndërmarrjeve në administrim.

Në fund të vitit 2025, numri i përgjithshëm i aseteve të dhëna me qira ishte 1,445 asete, prej të cilave:

- 1,374 janë asete të NSh-ve në likuidim (nga të cilat 672 i përkasin NSh "Tregu") ;
- 71 asete të NSh-ve në administrim direkt;
- 5 asete të ndërmarrjeve në tranzicion.

Pavarësisht rritjes së të hyrave, AKP vazhdon të përballet me sfida të theksuara në vjeljen e qirave, të cilat lidhen kryesisht me:

- Mos pagesa ose vonesa të përsëritura nga qiramarrësit;
- Konteste pronësore dhe juridike që ndikojnë në ekzekutimin e kontratave;
- Uzurpime dhe shfrytëzim pa kontratë;
- Procedura të zgjatura të përmbarimit dhe shkëputjes së kontratave.

Këto sfida ndikojnë drejtpërdrejt në efikasitetin e inkasimit dhe kërkojnë angazhim të vazhdueshëm administrativ dhe juridik.

Aktivitetet e tenderimit gjatë vitit 2025

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025, AKP në përputhje me planin vjetor të aktiviteteve, ka zhvilluar dy (2) procese të tenderimit publik për qiradhënien e aseteve.

Tenderi i parë është realizuar më 14 janar 2025, ku janë ofruar për qiradhënie gjithsej 212 asete. Nga këto, 29 asete kanë pranuar oferta, ndërsa 182 asete nuk kanë pranuar asnjë ofertë, si dhe një (1) ofertë është shpallur e pavlefshme. Pas shqyrtimit nga BiD, nga 29 asetet me oferta, janë aprovuar 19 , ndërsa 10 janë refuzuar për arsye procedurale dhe ekonomike.

Tenderi i dytë është shpallur më 30 qershor 2025 në portalet dhe ueb-faqen zyrtare të AKP-së. Procesi i ofertimit është zhvilluar më 14 korrik 2025 për asetet komerciale dhe më 15 korrik 2025 për qiradhënien vjetore apo sezonale të tokave bujqësore. Në këtë tender janë përfshirë gjithsej 668 asete. Nga to, 179 asete kanë pranuar oferta, ndërsa 489 asete nuk kanë pranuar asnjë ofertë.

Pas shqyrtimit nga Bordi i Drejtorëve, nga 179 asetet me oferta, janë aprovuar 157, 16 janë refuzuar për shkak të mosarritjes së çmimit minimal të pranueshëm, ndërsa 6 janë diskualifikuar për mos përmbushje të kritereve të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit.

TË HYRAT E PËRGJITHSHME NGA QIRADHËNIA E ASETEVE GJATË VITIT 2025		
Përshkrimi	**Numri i aseteve me qira**	**Inkasimi i qirave €**
Asetet e NSh-ve në likuidim	1,369	5,739,904
Asetet e NSh-ve në AD	71	698,433
Asetet e NSh-ve ne Tranzicion	5	17,273
Gjithsej	**1,445**	**6,455,610**

Të hyrat nga qiraja janë: 6,455,610 €. Prej tyre, 353,801 € janë të hyrave nga qiradhënia e aseteve të ndërmarrjeve shoqërore Brezovica dhe Jatex të cilat ndërmarrje llogaritë i kanë në bankat komerciale. Ndërsa 6,101,809 € janë në llogaritë bankare në BQK.

Duhet të theksohet se gjatë vitit 2025 janë dërguar në procedurë përmbarimore 114 raste të qiramarrëseve me pagesa të parregullta për periudhat paraprake, me vlerë të përgjithshme të borxhit prej **565,715.90 €.**

Gjatë vitit 2025 janë iniciuar tre (3) kallëzime penale (dy (2) për ndërtime të kundërligjshme dhe një (1) për uzurpim prone), si dhe janë proceduar 12 kërkesa për asistencë nga Policia e Kosovës.

Në mbrojtje të interesit pronësor dhe juridik të ndërmarrjeve janë ushtruar gjithsej 40 padi të llojeve të ndryshme, kryesisht për vërtetim pronësie, masa të përkohshme, anulim aktvendimesh dhe lirim prone.

Identifikimi dhe administrimi i aseteve të reja

Gjatë vitit 2025 janë identifikuar dhe vënë nën administrim të AKP-së gjithsej **460 parcela/asete të reja**, të cilat më parë nuk kanë qenë të evidentuara në regjistrat e agjencisë.

Identifikimi i këtyre aseteve është bërë i mundur pas marrjes së Regjistrit të Aseteve Shoqërore nga Agjencia Kadastrale e Kosovës**.**

KAPITULLI 7: FONDET NË MIRËBESIM DHE BUXETI I AKP-SË

Në këtë kapitull paraqiten të hyrat nga procesi i privatizimit dhe likuidimit, shpërndarja e fondeve në mirëbesim, si dhe pasqyra e shpenzimeve dhe gjendjes financiare për vitin 2025 përfshirë krahasimin me vitin paraprak dhe të dhënat kumulative nga viti 2003.

7.1 TË HYRAT NGA PRIVATIZIMI DHE SHPËRNDARJA E FONDEVE NË MIRËBESIM

Fondet në mirëbesim janë fonde të administruara nga AKP në emër të NSh-ve dhe kreditorëve të tyre deri në shpërndarjen përfundimtare sipas legjislacionit në fuqi.

Këto fonde krijohen nga:

- Të hyrat nga shitja e aseteve gjatë procesit të privatizimit dhe likuidimit;
- Të hyrat nga qiradhënia e aseteve të administruara përkohësisht nga AKP;
- Interesi i fituar dhe të hyra të tjera të lidhura me procesin.

Fondet mbahen në llogari të veçanta në Bankën Qendrore të Kosovës dhe janë të ndara nga buxheti operativ i AKP-së. Ato përdoren për:

- Shpërndarjen e 20%-it të të hyrave për punëtorët e NSh-ve;
- Pagesat ndaj kreditorëve;
- Tarifën administrative të AKP-së;
- Detyrime tjera ligjore dhe financiare sipas ligjit nr. 04/L-034 për AKP;
- Çështje të tjera të tilla si mallra dhe shërbime gjatë procesit të administrimit apo likuidimit të NSh-ve.

AKP i menaxhon këto fonde në emër të NSh-ve.

Gjatë vitit 2025, të hyrat në fondet në mirëbesim arritën në 26.4 milion €, ndërsa pagesat në 11.4 milion €, duke rezultuar me një bilanc neto vjetor 14.9 milion €. Për krahasim, në raport janë përfshirë edhe të dhënat për vitin 2024.

Në periudhën 2003–2025, gjithsej pranimet kumulative arrijnë 955.1 milion €, pagesat në 761 milion €, ndërsa bilanci i mbetur në fund të vitit 2025 është 194.1 milion €.

PRANIMET DHE PAGESAT GJATË VITIT 2025						
PRANIMET		**2024 Hyrje (€)**	**2025 Hyrje (€)**	**% 2025 vs 2024 (€)**		**2003 -2025 Hyrje (€)**
Të hyrat nga shitja e aseteve		17,370,921	19,760,716	13.76%		826,264,907
Të hyrat nga qiraja		5,519,944	6,101,809	10.54%		74,403,737
Interesi i fituar		517,127	555,712	7.46%		36,229,987
Të hyrat nga tarifa & konfiskimet e depozitave në tenderët e shitjes		159,500	99,002	(37.93)%		9,287,167
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender		208,500	(330,000)	(258.27)%		-
Të hyra tjera		181,427	214,652	18.31%		7,943,407
Kapitali themeltar i AKP-së		-	-	0.00%		1,013,200
Gjithsej pranimet		**23,957,419**	**26,401,891**	**10.20%**		**955,142,405**
PAGESAT / SHPËRNDARJET		**2024 Dalje (€)**	**2025 Dalje (€)**	**% 2024 vs 2023 (€)**		**2003 -2025 Dalje (€)**

20% i punëtorëve transferuar në BSPK		3,445,372	5,822,538	69.00%		172,725,021
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)		499,800	541,650	8.37%		18,947,507
Mallra dhe shërbime		1,792,552	1,568,755	(12.48)%		29,182,024
Shpenzimet komunale		105,587	144,712	37.05%		3,690,792
Tatimet		750,624	961,218	28.06%		14,453,410
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)		89,028	21,329	(76.04)%		8,648,193
Transferi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së		-	-	0.00%		45,777,947
Të tjera		7,098	3,234	(54.44)%		894,506
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-ve		4,746,620	3,576,357	(24.65)%		69,933,090
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës		(248,794)	(1,198,530)	381.74%		396,786,417
Gjithsej pagesat		**11,187,887**	**11,441,263**	2.26%		**761,038,907**
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE		**12,769,532**	**14,960,628**	**17.16%**		**194,103,498**

Në fund të vitit 2025, obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj AKP-së (llogaritë e arkëtueshme) arritën në 59.8 milion €, ndërsa obligimet e papaguara nga AKP ndaj palëve të treta (llogaritë e pagueshme) ishin në vlerë prej 1.4 milion €.

LLOGARITË E ARKËTUESHME DHE TË PAGUESHME TË FONDEVE NË MIRËBESIM		
Llogaritë e arkëtueshme	**Viti 2025 (€)**	**Viti 2024 (€)**
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	29,318,296	29,318,296
Nga shitja e aseteve	11,717,983	8,171,724
Nga shpronësimi i aseteve të NSH-ve	3,071,250	4,095,000
Të hyra nga qiraja	15,756,634	15,617,250
Gjithsej	**59,864,163**	**57,202,270**
Llogaritë e pagueshme	**Viti 2025 (€)**	**Viti 2024 (€)**
Obligimet ndaj kërkesave kreditore	1,146,991	2,084,595
Mallra dhe Shërbime	302,903	111,070
Gjithsej	**1,449,894**	**2,195,665**

7.2 BUXHETI OPERATIV I AKP-SË

Buxheti operativ i AKP-së përdoret për mbulimin e shpenzimeve administrative dhe operative, duke përfshirë pagat, mallrat dhe shërbimet. Ky buxhet mbahet i ndarë nga Fondet në Mirëbesim, duke siguruar që funksionimi i AKP-së të mos financohet nga të hyrat e privatizimit të ndërmarrjeve.

Buxheti vjetor i AKP-së për vitin 2025, sipas Ligjit të Buxhetit, ishte 4,54 milion €, ndërsa shpenzimet e realizuara arritën në 4.41 milion €, apo 94.90% e buxhetit të planifikuar. Shpenzimet kryesore janë

- 3.308 milion € për paga dhe shtesa;
- 0.841 milion € për mallra dhe shërbime.

PËRFORMANCA FINANCIARE PËR BUXHETIN E AKP-SË							
Kategoria ekonomike	**Buxheti 2025 (€)**	**Shpenzimet 2025 (€)**	**Buxheti i mbetur 2025 (€)**	**% e shpenzuar (€)**		**Shpenzime 2024 (€)**	**% e buxhetit 2024 (€)**

Pagat & mëditjet	3,308,019	3,307,537	482	99.99%	3,466,481	93.99%
Mallrat dhe shërbimet	894,283	840,685	54,598	93.90%	924,047	89.90%
Shërbimet komunale	110,000	109,823	176	99.84%	106,178	70.79%
Subvencionet dhe transferet	-	-	-	-	-	-
Shpenzimet kapitale	230,000	53,768	176,232	23.38%	56,188	93.65%
Gjithsej	**4,543,303**	**4,311,813**	**231,489**	**94.90%**	**4,552,894**	**96.77%**

KAPITULLI 8: FUNKSIONET E PËRGJITHSHME

Ky kapitull përshkruan funksionet mbështetëse të AKP-së, të cilat sigurojnë operimin efikas dhe në përputhje me kornizën ligjore dhe rregullative. Funksionet e përgjithshme kryhen nga departamente dhe divizione specifike, secili me përgjegjësi të qarta në menaxhimin e shërbimeve ligjore, administratës së përgjithshme, burimeve njerëzore, prokurimit, marrëdhënieve me publikun dhe auditimit të brendshëm.

8.1 DEPARTAMENTI LIGJOR

Departamenti Ligjor ka një rol kyç në sigurimin që proceset e privatizimit dhe likuidimit zhvillohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet profesionale dhe rregulloret përkatëse. Gjatë vitit 2025, Departamenti ka kryer aktivitet kryesore si më poshtë:

Përfaqësimi ligjor dhe procedurat gjyqësore

Gjatë vitit 2025, AKP është përfaqësuar në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe në gjykata tjera, në çështje që përfshijnë konteste pronësore, mosmarrëveshje kontraktuale, ankesa ndaj vendimeve të AKP-së dhe ekzekutimin e detyrimeve financiare.

- Janë pranuar 134 lëndë të reja dhe janë zhvilluar 333 seanca gjyqësore;
- Dhoma e Posaçme ka nxjerrë 90 aktgjykime dhe 146 aktvendime përfundimtare;
- Gjatë vitit, Departamenti Ligjor ka dhënë përgjigje për:
  - 133 përgjigje ndaj urdhrave të gjykatave;
  - 90 ndaj padive;
  - 49 ndaj ankesave;
  - 30 ndaj kërkesave për masa sigurie;
  - 13 padi dhe 21 ankesa në gjykata;
  - 65 parashtresa të tjera të ndryshme.

Në fund të vitit 2025, në Dhomën e Posaçme janë 8,366 lëndë aktive, prej të cilave 7,334 lëndë janë në Kolegjet e Shkallës së Parë dhe 1,032 lëndë janë në shqyrtim në Kolegjin e Apelit.

Përgatitja e kontratave të shitjes

Gjatë vitit 2025 janë hartuar gjithsej 152 kontrata të shitjes, përfshirë:

- 81 kontrata për shitjen e aseteve përmes tenderit;
- 56 kontrata për shitje direkte;
- 15 kontrata për shitjen e banesave.

Shqyrtimi i ankesave për 20%-shin e punëtorëve

Gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar 61 ankesa të punëtorëve të NSh-ve lidhur me përfitimin e fondeve nga 20%-shi:

- 40 ankesa janë aprovuar;
- 21 ankesa janë refuzuar.

Gjithashtu, janë shqyrtuar dhe aprovuar 35 lista përfundimtare të punëtorëve për përfitimin e 20%-shit.

Ofrimi i opinioneve dhe këshillave ligjore

Gjatë vitit 2025, Divizioni i Opinioneve Ligjore ka:

- Ofruar 29 opinione dhe këshilla ligjore;
- Dhënë përgjigje ndaj 3 kërkesave të divizioneve tjera të AKP-së;
- Përgatitur dhe shqyrtuar rregullore dhe akte juridike;
- Marrë pjesë në 46 komisione të brendshme.

8.2 DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti i Administratës ka një rol thelbësor në menaxhimin e aktiviteteve dhe shërbimeve mbështetëse, duke siguruar që operacionet e tjera të AKP-së të realizohen pa pengesa. Roli i tij përfshin administrimin e teknologjisë informative (TI), menaxhimin e zyrave dhe infrastrukturës, dokumentacionit dhe arkivave, resurseve dhe pajisjeve të zyrës si dhe mbështetje logjistike për aktivitete, transport, përkthime, pastrim dhe siguri.

Shërbime të teknologjisë informative

Gjatë vitit 2025, është realizuar modernizimi i plotë i infrastrukturës së TI-së, duke përfshirë:

- Përmirësimin e serverëve fizikë, sistemeve SAN/NAS, rrjetit dhe sistemit të backup-it;
- Përditësime të harduerit dhe firmware-it, konfigurime të avancuara si MPIO, snapshot-e, replikim) dhe politika GFS për ruajtjen afatgjatë të të dhënave;
- Rikonfigurimin e sistemit të backup-it me VEEAM v13, DataDomain dhe Quantum SuperLoader LTO-8, duke përfshirë edhe autentikimin me MFA;
- Migrimin e sigurt të mbi 13 TB të dhënash dhe konfigurimin e NAS-eve me snapshot-e të pa modifikueshme (immutable) së bashku me testimin funksional të të gjithë infrastrukturës.

Këto veprime kanë rritur ndjeshëm sigurinë, qëndrueshmërinë dhe përformancën e sistemit TI, duke përmirësuar mbështetjen për të gjitha aktivitetet e AKP-së.

Menaxhimi i dokumentacionit dhe arkivave

Gjatë vitit 2025, janë organizuar dhe menaxhuar dokumente dhe arkiva, duke siguruar ruajtjen, arkivimin dhe qasjen e informacionit në mënyrë efikase:

- 3126 dokumente janë regjistruar në databazën e arkivit;
- Dokumentacioni i NSh-ve në Likuidim të Regjionit të Pejës, Prizrenit dhe Mitrovicës është transferuar në arkivat nder komunale përkatëse;
- Janë arkivuar 149 kontratave të shitjes;
- Janë përpunuar 28 kërkesa për arkivim dhe 107 kërkesa për dokumentacion;
- Është siguruar qasje në dosje personale të ish-punëtorëve për qëllime pensioni, (67 kërkesa).

Përkthimet dhe Protokollimi i Dokumentacionit

Gjatë vitit 2025, janë menaxhuar përkthimet dhe protokollimi i dokumentacionit për të siguruar qasje të shpejtë dhe të rregullt në informacion:

- Janë përkthyer 228 dokumente me gjithsej 1,358 faqe;
- Është siguruar përkthyes për 3 takime;
- Janë protokolluar/pranuar 3,835 shkresa hyrëse;
- Janë regjistruar 2,726 shkresa dalëse;
- Janë proceduar dhe dorëzuar 2,626 shkresa administrative tjera tek zyrtarët përgjegjës.

Sfida dhe Vërejtje

Shumë procese administrative varen nga institucionet tjera publike. Vonesa në ofrimin e mallrave dhe shërbimeve sipas procedurave të centralizuara të AQP-së ndikon drejtpërdrejtë në përformancën e AKP-së dhe paraqet sfida për menaxhimin efektiv të aktiviteteve.

8.3 BURIMET NJERËZORE

Gjatë vitit 2025, struktura dhe përbërja e personelit të AKP-së ishte si më poshtë:

- Numri total: 201 nëpunës (pa 8 anëtarët e Bordit);
- Funksionet: 52% operative, 48% administrative;
- Gjinia: 52% meshkuj, 48% femra;
- Edukimi: PhD 1%, pasuniversitare 27%, universitare 61%, shkollë e lartë 2%, mesëm 8%;
- Mosha mesatare: 44 vjet;
- Pozitat udhëheqëse:
  - 1 Drejtor Ekzekutiv;
  - 2 Zëvendës Drejtorë Ekzekutiv;
  - 5 Drejtorë Departamentesh;
  - 27 pozita të ulëta drejtuese.
- Pozitat operative/administrative: 10 specialistë, 156 punonjës profesionalë;
- Trajnime profesionale: 21 punonjës kanë ndjekur trajnime vendore për zhvillim profesional dhe përmirësim të përformancës organizative.

Lëvizja e stafit

Gjatë vitit 2025, pozita e Drejtorit Ekzekutiv mbeti e lirë. Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë ushtron detyrën e Drejtorit Ekzekutiv deri në përzgjedhje të drejtorit të ri, ndërsa Drejtori i Departamentit për Koordinim Rajonal (DKRO) ushtron detyrën e Zëvendësdrejtorit Ekzekutiv për Operativë. Konkursi për rekrutimin e Drejtorit Ekzekutiv është shpallur dy herë dhe ende nuk ka përfunduar. Këto lëvizje janë bërë sipas vendimeve të Bordit të datës 04 korrik 2025 (shiko kapitullin 2.2).

Gjatë vitit 2025, janë iniciuar 11 procese rekrutimi: një (1) proces u përfundua me sukses, duke plotësuar dy (2) pozita, tetë (8) procese dështuan dhe dy (2) janë ende në zhvillim. Nga lista e pritjes prej katër (4) punonjësve, një (1) është transferuar në mënyrë të përhershme brenda AKP-së, ndërsa tre (3) të tjerë mbeten në listë të pritjes si pasoj e ri-organizimit të vitit 2023.

LËVIZJET E STAFIT GJATË VITIT 2025								
Rekrutimet	Dorëheqjet	Pensionimet		Pushim pa pagesë	Pushim Lehonie	Ushtrues detyre	Transferimet	
		Sipas moshës	Para kohëshme				Përkohshme	Përhershme
11	3	7	4	9	4	8	23	2

8.4 PROKURIMI

Aktivitetet e prokurimit realizohen nga divizioni i prokurimit. Gjatë vitit 2025 janë zhvilluar gjithsej 27 aktivitete prokurimi dhe janë nënshkruar 29 kontrata, (dy kontrata të bartura nga procedurat e vitit 2024) të cilat kryesisht kanë qenë për furnizime me mallra dhe kryerje të shërbimeve.

REALIZIMI I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT GJATË VITIT 2025		
Lloji i kontratave	Numri i kontratave	Shuma e kontratave (€)

Furnizimi me mallra	10	185,060
Shërbime	17	461,700
Gjithsej	**27**	**646,760**

8.5 ZYRA PËR MEDIA DHE MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun siguron komunikim transparent dhe mbështet marrëdhëniet me publikun, mediat, qytetarët, investitorët dhe palët e tjera të interesuara gjatë proceseve të privatizimit dhe likuidimit.

Gjatë vitit 2025, zyra ka realizuar:

- 37 komunikata për media dhe 7 artikuj të sponsorizuar;
- 108 postime në rrjete sociale dhe web-faqen e AKP-së;
- 53 përgjigje për media dhe 525 kërkesa të palëve të jashtme përmes emailit zyrtar;
- 36 kërkesa për qasje në dokumente publike.

Këto aktiviteteve kanë kontribuar në zhvillimin e raporteve të mira me publikun dhe në mbështetjen e proceseve të AKP-së në mënyrë të hapur dhe të drejtë.

8.6 AKTIVITETET E MARKETINGUT

Gjatë vitit 2025, AKP ka fokusuar aktivitetet e marketingut në rritjen e transparencës dhe efikasitetit të proceseve të privatizimit dhe likuidimit. Pas ndryshimeve të rregullativës së shitjes me tender publik, u ndërmorën hapa për komunikimin dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë publikimin e çmimit minimal orientues dhe kategorisë për çdo aset në shitje.

Aktivitetet kryesore të vitit 2025 përfshijnë:

- **Publikime për informim të publikut:** 15 publikime për shitje asetesh, qiradhënie, raportet përfundimtare të likuidimit, listat e punëtorëve për 20% dhe njoftimet për kreditorë, në RTK, portalet mediale dhe faqen zyrtare të AKP-së;
- **Përdorimi i Google Maps:** Ofrimi i informacionit të detajuar mbi lokacionin dhe karakteristikat e 84 aseteve për blerësit potencial, duke lehtësuar qasjen dhe përmirësuar përvojën e përdoruesve.
- **Shërbime këshilluese për investitorët:** Sigurimi i qasjes në dosjet e tenderit dhe ofrimi i informacioneve të nevojshme për pjesëmarrje në procesin e privatizimit;
- **Web faqja zyrtare e AKP-së:** Përditësim i vazhdueshëm me njoftime dhe dokumente të rëndësishme, publikim i 17 shpalljeve, 1,289 dokumente/foto/video dhe azhurnimi i përmbajtjes së postimeve në 58 raste.

Këto aktivitete kanë kontribuar në përmirësimin e transparencës, qasjes së informacionit dhe përvojës së investitorëve në proceset e AKP-së.

8.7 AUDITIMI I BRENDSHËM

Divizioni i Auditimit të Brendshëm (DAB) ka realizuar planin e punës për vitin 2025, duke finalizuar 9 raporte auditimi, përfshirë edhe auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të mëparshme.

Auditimet kanë qenë të fokusuara në:

- Vlerësimin dhe forcimin e sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Përmirësimin e proceseve të menaxhimit dhe rritjen e efikasitetit operacional;
- parandalimin e gabimeve dhe parregullsive.

Identifikimi i dobësive dhe rekomandimet e DAB-it kanë ofruar siguri të arsyeshme për Bordin dhe menaxhmentin, duke mbështetur funksionimin efektiv dhe të qëndrueshëm të aktiviteteve operative dhe funksioneve të përgjithshme të AKP-së.

AUDITIMET E KRYERA GJATË VITIT 2025		
Nr	**Fushat e audituara**	**Periudha**
1	Procesi i zbatimit të politikave dhe procedurave lidhur me menaxhimin e burimeve njerëzore	TM1/2025
2	Procesi i menaxhimit të qiradhënies së aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve)	TM1/2025
3	Menaxhimi i Divizionit të Protokollimit dhe Shkresave Gjyqësore	TM2/2025
4	Menaxhimi i Divizionit të Shërbimeve të Përgjithshme	TM2/2025
5	Procesi i menaxhimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të TI në AKP-së	TM3/2025
6	Procesi i menaxhimit të qirasë së aseteve të N.Sh Lidhja Automoto Kosova	TM3/2025
7	Procedurat e shitjes së aseteve përmes negocimit direkt	TM4/2025
8	Menaxhimi i procesit të likuidimit të NSh-ve dhe zbatimi i kontratës me OShP-në	TM4/2025
9	Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të auditimit	

Aktivitete të tjera të Divizionit:

- Pjesëmarrja në 6 takime të Komitetit të Auditimit, ku u shqyrtuan raportet e Auditimit dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve;
- Përgatitja e Planit Vjetor të Punës për vitin 2026, i miratuar nga Komiteti i Auditimit dhe dorëzuar në Departamentin Qendror Harmonizues (DQH) të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT);
- Përgatitja dhe dorëzimi i raporteve periodike gjashtëmujore dhe vjetore mbi aktivitetet e Divizionit të Auditimit të Brendshëm, të cilat janë dorëzuar në DQH.


SHTOJCAT

1. Struktura organizative e Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
2. Lista e ndërmarrjeve të Likuiduara;
3. Pjesa tekstuale e Raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës;

3.1. Shënimet shpjeguese për mallra 2025;

4. Pjesa tabelare e raportit financiar sipas formatit të Komisionit për Buxhet dhe Financa të Kuvendit të Republikës së Kosovës;
5. Pasqyrat Financiare të Buxhetit Vjetor të Agjencisë;
6. Pasqyrat Financiare të Fondeve në mirëbesim.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT



LISTA E NSh-ve TË LIKUIDUARA

Nr.	PAK ID	Emri i ndërmarrjes	Rajoni	Data e dorëzimit në Bordin e Drejtorëve	Data e dorëzimit në DHPGJSK	Data e pranimit të Aktvendimit nga DHPGJSK	Numri i Aktvendimit të DHPGJSK	OSHP/AKP
1	GJI016	K.B "Kishna Pole"	Gjilan	25-Jul-18	2-Aug-18	29-Mar-21	C-IV-18-0066	Njësia e AKP-së
2	GJI019	K.B "Perlepnica"	Gjilan	29-Mar-19	15-Apr-19	27-May-19	C-IV-19-0004	Njësia e AKP-së
3	GJI054	N.P.SH.T."Metalografika"	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0074	OSHP
4	GJI074	Barnatorja Gjilan (pharmacy)	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	1-Jul-22	C-IV-18-0076	OSHP
5	GJI108	N.Sh.T "Fertrans"	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0079	OSHP
6	GJI128	Agrokultura/Ferizaj	Gjilan	30-Mar-17	11-Apr-17	21-Jun-17	C-IV-17-0018	Njësia e AKP-së
7	GJI130	Bibaj	Gjilan	17-May-16	18-Jul-16	24-Aug-16	C-IV-13-0333	Njësia e AKP-së
8	GJI134	Gacke	Gjilan	23-Nov-16	25-Jan-17	21-Jan-17	C-IV-17-0004	Njësia e AKP-së
9	GJI136	KB Bujku Kosina	Gjilan	25-Sep-20	20-Sep-20	17-Dec-20	C-IV-20-0060	Njësia e AKP-së
10	GJI143	Visoca	Gjilan	21-Sep-16	23-Sep-16	14-Oct-16	C-IV-16-0381	Njësia e AKP-së
11	GJI144	Xhafa	Gjilan	31-Aug-16	21-Sep-16	30-Sep-16	C-IV-16-0371	Njësia e AKP-së
12	GJI151	Vet Station - Ferizaj/Urosevac	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0072	OSHP
13	GJI154	Cinema Gjilan	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0081	OSHP
14	GJI156	Universiteti i Punetoreve/Cinema - Ferizaj	Gjilan	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0082	OSHP
15	GJI157	N.N. 16 Nentori	Gjilan	27-Apr-17	2-Apr-17	21-Jun-17	C-IV-17-0034	Njësia e AKP-së
16	GJI169	Partizan, Babush	Gjilan	22-Nov-18	4-Dec-18	30-Jan-19	C-IV-18-0094	Njësia e AKP-së
17	MIT004	KB Bujku	Mitrovica	23-Oct-21	2-Dec-21	24-Mar-22	C-IV-21-0225	OSHP
18	MIT006	KB Likovci	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	11-Jan-13	C-IV-12-0015	Njësia e AKP-së
19	MIT007	KB Liria	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	31-Jan-13	C-IV-12-0016	Njësia e AKP-së
20	MIT017	Graniti	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	10-Dec-12	C-IV-12-0017	Njësia e AKP-së
21	MIT032	Stacioni i Veterinës Skenderaj	Mitrovica	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0070	OSHP
22	MIT046	N.P.SH.T DEN	Mitrovica	23-Sep-10	4-Sep-13	6-Nov-17	C-IV-13-1675	OSHP
23	MIT075	SH.A.M. Ruzhdi Bytyqi	Mitrovica	31-Jan-14	4-Feb-14	13-Mar-14	C-IV-14-0109	Njësia e AKP-së
24	MIT098	Hidrotermika	Mitrovica	20-Jul-12	16-Aug-12	15-Oct-12	C-IV-12-0018	Njësia e AKP-së
25	MIT164	Ndermarrja Ndertimore Ndertimtari	Mitrovica	30-Jun-22	19-Jul-22	3-Aug-22	C-IV-22-0215	Njësia e AKP-së
26	MIT141	Konfekcioni Rashka	Mitrovica	23-Oct-21	2-Dec-21	11-Jan-24	C-IV-21-0224	OSHP
27	PEJ010	Fabrika e ushqimit te kafshëve Klinapremix	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0083	OSHP
28	PEJ011	Fabrika e Farës Dardania	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0071	OSHP
29	PEJ012	Fabrika e Kërpudhave Shampinjoni i Kosovës	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0080	OSHP
30	PEJ049	Koop. Bujqësore Ozdrim	Peja	19-Dec-13	26-Dec-13	27-Feb-14	C-IV-13-3950	Njësia e AKP-së
31	PEJ053	Koop. Bujqësore Vitomirica	Peja	26-May-16	18-Jul-16	1-Aug-16	C-IV-16-0332	Njësia e AKP-së
32	PEJ145	Dardania	Peja	22-Nov-21	10-Dec-21	15-Apr-22	C-IV-21-0234	OSHP
33	PEJ184	NT Petrans Pejë/Pec	Peja	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0078	OSHP

34	PRN013	KB ORLLAN	Prishtina	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0075	OSHP
35	PRN059	KOSOVA CONTROL	Prishtina	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0077	OSHP
36	PRN086	19 NENTORI	Prishtina	25-Jul-18	6-Aug-18	23-May-25	C-IV-18-0069	OSHP
37	PRZ030	Ndertimi	Prizren	25-May-17	6-Jun-17	31-Jul-17	C-IV-17-0114	Njësia e AKP-së
38	PRZ051	N.SH.Auto Moto	Prizren	17-May-16	18-Jul-16	2-Aug-16	C-IV-16-0331	Njësia e AKP-së
39	PRZ056	SHAM Semafor	Prizren	27-Jun-13	28-Jun-13	17-Jan-14	C-IV-13-1068	Njësia e AKP-së
40	PRZ072	KB Mushtishti-Mushtisht (Suhareka)	Prizren	25-Jul-18	6-Aug-18	30-Jan-19	C-IV-18-0073	OSHP
41	PRZ076	OLT -Osijek NJP Rahovec	Prizren	28-Jul-22	22-Aug-22	4-Jan-23	C-IV-22-0295	OSHP
42	PRZ085	KB Lubizhda Malishevë	Prizren	28-Jul-22	5-Aug-22	11-Dec-23	C-IV-22-0283	Njësia e AKP-së
43	PRZ089	KB Vlashki Drenovc Malishevë	Prizren	25-Jul-18	2-Aug-18	29-Mar-21	C-IV-18-0067	Njësia e AKP-së
44	PRZ087	KB Zocishta Zoqishtë Rahovec	Prizren	29-Oct-21	15-Nov-21	19-Nov-21	C-IV-21-0214	Njësia e AKP-së
45	PRZ090	KB Hoqa e Qytetit	Prizren	31-May-22	9-Jun-22	11-Dec-23	C-IV-22-0163	Njësia e AKP-së
46	PRZ091	KB Opterusha	Prizren	29-Oct-21	15-Nov-21	19-Nov-21	C-IV-21-0215	Njësia e AKP-së
47	PEJ017	Ag Coop "Prapaçani" Prapaçan	Peja	30-Nov-22	8-Dec-22	18-Apr-23	C-IV-22-0411	Njësia e AKP-së
48	PEJ048	Ag coop Kuqishte	Peja	30-Nov-22	7-Dec-22	19-Dec-23	C-IV-22-0410	OSHP
49	PEJ078	"Fabrika e Pompave me Piston"	Peja	29-Mar-23	30-May-23	17-Jan-24	C-IV-23-0115	OSHP
50	GJI082	G.T. Grafikos	Gjilan	29-May-23	13-Jul-23	17-Jan-24	C-IV-23-0124	OSHP
51	PEJ186	DES Bratstvo	Peja	29-Jun-23	13-Jul-23	21-Mar-24	C-IV-23-0125	OSHP
52	GJI152	Stacioni i Veterinarisë	Prizren	30-Oct-23	4-Dec-23	3-Jan-24	C-IV-23-0687	OSHP
53	PRZ061	Ambulanca Veterinare	Prizren	30-Oct-23	4-Dec-23	4-Jun-24	C-IV-23-0688	OSHP
54	PEJ054	KB Zahaq	Peja	21-Dec-23	28-Dec-23	9-Feb-24	C-IV-23-0712	Njësia e AKP-së
55	PEJ207	Auto Moto Rival	Peja	21-Dec-23	28-Dec-23	7-Feb-24	C-IV-23-0713	Njësia e AKP-së
56	MIT148	Muharrem Bekteshi	Mitrovica	27-Jun-24	3-Jul-24	10-Jul-24	C-IV-24-0106	Njësia e AKP-së
57	PEJ069	Erozioni	Peja	27-Jun-24	16-Jul-24	16-Sep-25	C-IV-24-0109	OSHP
58	GJI150	Stacioni i Veterines - Kaçanik	Gjilan	27-Jun-24	15-Jul-24	2-Aug-24	C-IV-24-0110	OSHP
59	MIT034	Trepça Konfeksioni	Mitrovica	27-Jun-24	15-Jul-24	27-Aug-24	C-IV-24-0108	OSHP
60	MIT152	Bagat Beograd	Mitrovica	27-Jun-24	15-Jul-24	27-Aug-24	C-IV-24-0111	OSHP
61	PRZ093	KB Mamusha	Prizren	19-Aug-24	5-Sep-24	21-Oct-24	C-IV-24-0155	Njësia e AKP-së
62	GJI142	GJI142 KB "Novobërda", Novobërdë	Gjilan	30-Jun-25	3-Jul-25	6-Oct-25	C-IV-25-0040	Njësia e AKP-së
63	GJI015	KB "Cërrnica", Cërrnicë	Gjilan	30-Jun-25	3-Jul-25	28-Jul-25	C-IV-25-0039	Njësia e AKP-së
64	PRZ082	KB "Banja", Banjë - Malishevë	Prizren	24-Jul-25	7-Aug-25	15-Sep-25	C-IV-25-0044	Njësia e AKP-së

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Vula pranuese e Njësisë për Propozime dhe Parashtresa

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
- Raporti Financiar për vitin 2025

Kodi i Organizatës Buxhetore: 239

Informatat kontaktuese:

Zyrtari Kryesor Administrativ: Burim Leci, u.d. Drejtor Ekzekutues
Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail: Burim.Leci@pak-ks.org

Zyrtari Kryesor Financiar: Adem Selishta, Drejtor i Financave dhe Buxhetit,
Rr. Dritan Hoxha Nr. 55, 10000 Prishtinë , Tel, 038 500 400 E-mail: adem.selishta@pak-ks.org
Data: 02.02.2026

1) Hyrje:

Në mungesë të mjeteve nga tarifa e të Hyrave të Dedikuara buxheti i AKP-së për vitin 2025 është financuar nga Granti Qeveritar (GQ).
Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2025, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 5,111,731.00, ndërsa buxheti përfundimtar, pas kursimeve dhe ndërrimeve në buxhet është EUR 4,543,302.64 .
Realizimi përfundimtar i buxhetit është gjithsej 94.90%
Teprica e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 231,489.23 dhe kryesisht i përket kategorisë ekonomike të shpenzimeve kapitale dhe kategorisë së mallrave dhe shërbimeve.

2) Përmbledhje për të hyrat dhe kategoritë e veçanta të shpenzimeve:

a) Të hyrat:

Pas përfundimit të gjashtëmujorit kemi identifikuar kursime buxhetore, mirëpo për shkak se në këtë vit nga Ministria e Financave Punës dhe Transfereve (MFPT) nuk ka pasur instruksion (proces) të rishikimit gjysmë vjetor, kursimet e identifikuara i kemi paraqitur gjatë përmbylljes së vitit fiskal në tremujorin e katërt.
Sipas krekës së AKP-së, MFPT përmes Vendimeve të Qeverisë Nr. 03/261, 01/276, 01/281 dhe 04/282 ka aprovuar kursimet dhe ka reduktuar buxhetin e Agjencisë.

b) Pagat dhe mëditjet:

Gjithsej numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2025 është 242.
Shpenzimet për paga dhe mëditje përfshijnë pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimin e 8 anëtarëve të bordit të AKP-së.
Në kategorinë paga dhe meditje buxheti fillestar ka qenë EUR 3,661,731.00 ndërsa ai përfundimtar është EUR 3,308,019.42. Diferencën e shumës prej EUR 353,711.58, MFPT e ka reduktuar nga buxheti i Agjencisë me vendimin e Qeverisë Nr. 01/281.
Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është EUR 3,307,537.35.
Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%.
Pagat dhe mëditjet e zyrtareve të AKP-së sipas listës së pagave procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratës Tatimore të Kosovës.
Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2025 janë gjithsej EUR 3,168,273.87.
Kompenzimi dhe Kontributet e pagesave të Bordit janë realizuar nga kodi ekonomik punëtoret me kontratë jo në listën e pagave (11400). Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve për vitin 2025 është në vlerën EUR 139,263.48.

c) Mallra dhe Shërbime:

Buxheti i aprovuar fillestar në kategorinë mallra dhe shërbime është EUR 1,105,000.00 ndërsa ai përfundimtar EUR 895,283.22.
Diferenca prej EUR 209,716.78 është rezultat kursimeve buxhetore të cilat AKP i ka paraqitur pranë MFPT ku rrjedhimisht me vendimet e Qeverisë me Nr. 01/276 dhe 04/282 janë reduktuar nga buxheti i Agjencisë.

Fondet e aprovuara në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime kanë qenë të destinuara:

- Për të mbuluar shpenzimet operative dhe administrative;
- Mbulimin e shpenzimeve të procesit të Privatizimit dhe Likuidimit;
- Për të mbështetur në aspektin ligjor procesin e privatizimit dhe likuidimit;

Gjithsej mbetja e buxhetit të pashpenzuar (pas kurimeve) për vitin 2025 është EUR 54,598.45.
Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 93.90%.

d) Shpenzime komunale:

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar dhe përfundimtar i aprovuar për shërbime komunale është EUR 110,000. Buxheti i pa shpenzuar është EUR 176.55.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 99.84%.

e) Investimet Kapitale:

Për periudhën raportuese, buxheti fillestar dhe përfundimtar i aprovuar për shpenzime kapitale është EUR 230,000.00.
Mjetet kanë qenë të destinuara për dy projekte kapitale:

1. Blerja e pajisjeve të TI-së për ngritjen e cilësisë së shërbimeve (Kodi i projektit 18941), vlera EUR 30,000.00. Projekti është realizuar dhe teprica e shumës së pa shpenzuar është EUR 2,429.66.
2. Data baza e arkivës së AKP-së (kodi i projektit 19256), vlera EUR 200,000.00.

Kontrata për projektin është nënshkruar në shumën prej 74,850 EUR. Shumën prej 125,150 EUR e kemi paraqitur pranë MFPT si kursim buxhetor dhe kemi kërkuar të reduktohet nga buxheti i vitit 2025, mirëpo MFPT mjetet nuk i ka reduktuar nga buxheti i AKP-së. Sipas kushteve të kontratës, realizimi i projektit do të zgjasë 12 muaj, ndërsa pagesat do të bëhen periodikisht në përputhje me realizimin e punëve të parapara me kontratë. Implementimi i projektit ka filluar me datën 29 tetor 2025, ndërsa përfundimi dhe pranimi final sipas Kontratës do të përfundojë me 28 tetor 2026.

Projekti është duke u implementuar dhe për të siguruar ekzekutim të rregullt financiar në përputhje me obligimet kontraktuale në vitin 2026, me datën 12 nëntor 2025 kemi kërkuar nga MFPT bartjen e buxhetit në vitin 2026 për pjesën e mbetur të vlerës së kontratës në shumë prej EUR 48,652.50.

Në vitin 2025 pagesat për projektin janë realizuar në vlerë prej EUR 26,197.50 ndërsa pjesa tjetër do të realizohet në vitin 2026.

Realizimi përfundimtar i buxhetit në këtë kategori është gjithsej 23.38%.

f) Subvencionet dhe Transferet:

Për periudhën raportuese, buxheti i fillestar për subvencione dhe transfere është EUR 5,000.00 ndërsa ai përfundimtar është zero.
Buxheti ka qenë i planifikuar për të mbështetur funksionin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve Shoqërore që janë në Administrim Direkt të AKP-së me qëllim të ruajtjes dhe rritjes së vlerës së këtyre Ndërmarrjeve para privatizimit.
Në tremujorin e fundit mjetet janë paraqitur si kursime dhe si të tilla sipas vendimit të Qeverisë Nr. 01/276 janë zbritur nga buxheti i AKP-së. Arsyeja e kursimit ka qenë fakti se Ndërmarrjet kane pasur mjetet e tyre financiare dhe nuk ka pasur nevoje për subvencionim.

3) Përmbledhje:

Buxheti fillestar i AKP-së për vitin fiskal 2025, i aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, është në vlerën prej EUR 5,111,731.00, ndërsa buxheti përfundimtar, pas kursimeve është EUR 4,543,302.64.
Realizimi përfundimtar i buxhetit është gjithsej 94.90%.
Shuma e buxhetit të pa shpenzuar është EUR 231,489.23.

Në renditjen e mëposhtme janë shpalosur kategoritë shumat dhe disa nga linjat më relevante në të cilat ka pasur shpenzim më të ulët se sa planifikimi:

- **Pagat & mëditjet**, shuma e buxhetit të pa shpenzuar EUR 482.07
- **Mallrat dhe shërbimet**, shuma e buxhetit të pa shpenzuar EUR 54,598.45
- **Shpenzimet kapitale,** shuma e buxhetit të pa shpenzuar EUR 176,232.16
- **Shpenzimet komunale,** shuma e buxhetit të pa shpenzuar EUR 152.92

<u>Linjat buxhetore:</u>

1. *Derivate dhe lëndë djegëse.*
2. *Mirëmbajtja e ndërtesave, mobileve dhe pajisjeve.*
3. *Blerje tjera-furnizime për zyrë, furnizime me ushqim dhe pije, furnizime pastrimi dhe veshmbathje.*
4. *Softuerët-licencat dhe mirëmbajtja e tyre , shërbimet e shtypjes dhe printimit.*

- **Shërbimet komunale**, shuma e buxhetit të pa shpenzuar 176.55.
- **Shpenzimet kapitale**, shuma e buxhetit të pa shpenzuar 176,232.16.

Arsyeja e mbetjes së buxhetit të pa shpenzuar është fakti se oferta për projektin kapital “Data baza e arkivës së AKP-së ka qenë më e ulët se sa planifikimi i buxhetit fillestar. Buxheti i planifikuar për projektin ka qenë EUR 200,000, ndërsa kontrata është nënshkruar në shumën prej 74,850.00.

Burim.Leci - u.d. Drejtor Ekzekutues

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2024			Buxheti 2025		
13000	**Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2024**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024**	**% e shpenzimeve**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2025**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2025**	**% e shpenzimeve**
	Gjithsej	**1,049,872**	**924,047**	**88%**	**895,284**	**840,685**	**94%**
1310	**SHPENZIMET E UDHËTIMIT (NËNTOTALI)**	**3,900**	**1,963**	**50%**	**-**		**0%**
13130	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-		-	-	
13131	Mëditja e udhëtim zyrtar brenda vendit	-	-		-	-	
13132	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar brenda vendit	-	-		-	-	
13133	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar brenda vendit		-		-	-	
13140	Shpenzimet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit	1,000	575		-	-	
13141	Mëditja e udhëtim zyrtar jashtë vendit	200	184		-	-	
13142	Akomodimi gjatë udhëtimit zyrtar jashtë vendit	700	475		-	-	
13143	Shpenzimet tjera të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	2,000	729		-	-	
1330	**SHËRBIMET E TELEKOMUNIKIMIT (NËNTOTALI)**	**26,821**	**25,636**	**96%**	**25,342**	**24,854**	**98%**
13310	Shpenzimet për internet	4,321	4,320	100%	4,166	4,166	100%
13320	Shpenzimet e telefonisë mobile	20,500	19,510	95%	18,699	18,594	99%
13330	Shpenzimet postare	2,000	1,806	90%	2,476	2,093	85%
13340	Shpenzimet e përdorimit të kabllit optik	-	-		-	-	
1340	**SHPENZIMET PËR SHËRBIME (NËNTOTALI)**	**348,100**	**330,904**	**95%**	**352,692**	**351,192**	**100%**
13410	Shërbimet e arsimit dhe trajnimit	9,000	8,594	95%	7,992	7,992	100%
13420	Shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës		-	0%			0%
13430	Shërbime të ndryshme shëndetësore		-	0%			0%
13440	Shërbime të ndryshme intelektuale dhe këshilldhënëse (nuk ka pasur pagesa nga ky kod ekonomik)	-	-	0%			0%
13450	Shërbime shtypje- jo marketing	3,000	2,974	99%	5,700	5,195	0%
13460	Shërbime Kontraktuese Tjera Në planin e ri kontabël në vitin 2024 është kodi i ri ekonomik 13475 (sigurimi fizik i objekteve publike)sigurimin nga Policia e Kosovës të cilin e gjeni me poshtë tek kodi ri ekonomik 13475)	59,000	52,092	88%	72,000	71,976	100%
13470	Shërbime Teknike	10,000	170	2%	1,000	380	38%
13475	Sigurimi fizik i objekteve publike	267,100	267,074	100%	266,000	265,650	100%
13480	Shpenzimet për Antarësim	-	-	0%			0%
1350	**BLERJE E MOBILJEVE DHE PAISJEVE (ME PAK SE 1000 EURO) (NËNTOTALI)**	**40,500**	**33,897**	**84%**	**33,957**	**31,786**	**94%**
13501	Mobilje (më pak se 1000 euro)	6,000	-	0%	6,000	4,666	78%
13502	Telefona (më pak se 1000 euro)	-	-	0%			0%
13503	Kompjuterë (më pak se 1000 euro)	28,000	27,928	100%	10,000	9,474	95%
13504	Harduer për teknologji informative (me pak se 1000 euro)	5,000	4,582	92%	10,000	9,690	97%
13505	Makina fotokopjuese (me pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13506	Pajisje speciale mjeksore (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2024			Buxheti 2025		
13000	**Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2024**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024**	**% e shpenzimeve**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2025**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2025**	**% e shpenzimeve**
13507	Pajisje të shërbimit policor (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13508	Pajisje trafiku (më pak se 1000 euro)	-	-		-	-	
13509	Pajisje tjera (më pak se 1000 euro)	1,500	1,388	93%	7,957	7,957	100%
1360	**BLERJE TJERA - MALLRA DHE SHËRBIME (NËNTOTALI)**	**23,000**	**21,862**	**95%**	**22,178**	**22,059**	**99%**
13610	Furnizime për zyrë, Furnizim me materail administrativë dhe letër për fotokopje	8,000	7,767	97%	5,000	4,882	98%
13620	Furnizime me ushqim dhe pije (jo dreka zyrtare)	8,000	7,229	90%	6,417	6,417	100%
13630	Furnizime mjekësore		-		-	-	
13640	Furnizime pastrimi	7,000	6,867	98%	10,760	10,760	100%
13650	Furnizim me veshmbathje	-	-		-	-	
13660	Akomodimi	-	-		-	-	
13670	Municion dhe armë zjarri	-	-		-	-	
13680	Tiketat siguruese(banderollat)	-	-		-	-	
13681	Bllombat	-	-		-	-	
1370	**DERIVATET DHE LËNDËT DJEGËSE (NËNTOTALI)**	**40,000**	**31,820**	**80%**	**55,000**	**38,554**	**70%**
13710	Vaj	-	-		-	-	
13720	Naftë për ngrohje qendrore	5,000	4,450	89%	17,000	16,734	98%
13730	Vaj për ngrohje		-		-	-	
13740	Mazut		-		-	-	
13750	Qymyr		-		-	-	
13760	Dru		-		-	-	
13770	Derivate për gjenerator	5,000	-		-	-	
13780	Derivatet për automjete, gjeneratorë dhe makineri	30,000	27,371	91%	38,000	21,820	57%

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2024			Buxheti 2025		
13000	**Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2024**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024**	**% e shpenzimeve**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2025**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2025**	**% e shpenzimeve**
1380	**LLOGARITE E AVANSIT (NËNTOTALI)**	**1,000**	**500**	50%	**500**	**480**	**96%**
13810	Avans për para të imëta (p.cash)	1,000	500	50%	500	480	96%
13820	Avans për udhetime zyrtare	-	-		-	-	
13821	Avans	-	-		-	-	
13830	Avans për mallra dhe shërbime	-	-		-	-	
13850	Avans - për ambasadat	-	-		-	-	
1390	**SHËRBIMET FINANCIARE (NËNTOTALI)**	**-**	**-**		**-**	**-**	
13911	Provizion Bankar-Banka Qendrore	-	-		-	-	
13912	Provizion Bankar-Raiffeisen Bank	-	-		-	-	
13913	Provizion Bankar-Procredit Banke	-	-		-	-	
13915	Provizion Bankar-Banka Private e Biznesit	-	-		-	-	
13916	Provizion Bankar-Banka Ekonomike	-	-		-	-	
13917	Provizion Bankar-NLB Banka Prishtina	-	-		-	-	
13918	Provizion për Tarifa të Ndryshme	-	-		-	-	
13940	KPA-Provizioni Bankar	-	-		-	-	
1395	**SHËRBIMET E REGJISTRIMIT DHE SIGURIMEVE (NËNTOTALI)**	**10,850**	**9,704**	**89%**	**9,250**	**8,874**	**96%**
13950	Regjistrimi i automjeteve	3,000	1,925	64%	2,000	1,810	91%
13951	Sigurimi i automjeteve	7,600	7,529	99%	7,000	6,824	97%
13952	Taksa komuale e regjistrimit të automjeteve	250	250	100%	250	240	96%
13953	Sigurimi i ndertesave dhe tjera		-			-	
1400	**MIRËMBAJTJA (NËNTOTALI)**	**96,427**	**76,962**	**80%**	**129,700**	**123,155**	**95%**
14010	Mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve	25,000	18,688	75%	21,000	20,659	98%
14020	Mirëmbajtja e ndertesave	1,300	1,225	94%			
14021	Mirëmbajtja e ndertesave të banimit		-				
14022	Mirëmbajtja e ndërtesave administrative afariste	1,000	985	99%	2,000	1,650	83%
14023	Mirëmbajtja e shkollave		-			-	
14024	Mirëmbajtja e objekteve shëndetesore		-			-	
14030	Mirëmbajtaj e auto rrugeve		-			-	
14031	Mirëmbajtja e auto rrugeve regjionale		-			-	
14032	Mirëmbajtja e auto rrugeve lokale		-			-	
14040	Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative	9,137	531	6%	700	649	93%
14050	Mirëmbajtja e mobileve dhe paisjeve	37,990	34,068	90%	67,000	62,114	93%
13471	Softuerët - lizencat dhe mirembajtja e tyre	22,000	21,465	98%	39,000	38,083	98%

Agjencia Kosovare e Privatizimit

Mallra dhe Shërbime

4.c) DETAJET E SHPENZIMEVE SIPAS KODEVE EKONOMIKE

		Buxheti 2024			Buxheti 2025		
13000	**Mallra dhe Shërbime Emri i kategorisë ekonomike**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2024**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2024**	**% e shpenzimeve**	**Planifikimi Janar - Dhjetor 2025**	**Shpenzimet Janar - Dhjetor 2025**	**% e shpenzimeve**
1410	**QIRAJA (NËNTOTALI)**	**330,074**	**294,188**	**89%**	**196,666**	**195,690**	**100%**
14110	Qiraja për ndërtesa	117,000	92,224	79%	88,000	87,339	99%
14120	Qiraja për tokë		-				
14130	Qiraja për paisje	2,000	1,422	71%	500	400	80%
14160	Qiraja për automjete	22,500	22,188	99%	5,166	5,166	100%
14150	Qiraja për përdorime tjera hapësinore	188,574	178,354	95%	103,000	102,785	100%
1420	**SHPENZIMET E MARKETINGUT (NËNTOTALI)**	**94,000**	**63,387**	**67%**	**62,000**	**37,336**	**60%**
14210	Reklamat dhe konkurset	-	-		-	-	
14220	Botimet e publikimeve	10,000	118	1%	5,000	4,379	88%
14230	Shpenzimet për informim publik	84,000	63,269	75%	57,000	32,958	58%
1430	**SHPENZIMET E PËRFAQËSIMIT (NËNTOTALI)**	**10,000**	**8,053**	**86%**	**8,000**	**6,704**	**86%**
14310	Shpenzimet e përfaqësimit mbrenda vendit (drekat zyrtare)	10,000	8,053	81%	8,000	6,704	84%
1440	**SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATAVE (NËNTOTALI)**	**25,200**	**25,172**	**0%**	**-**	**-**	**0%**
14410	Shpenzime-vendimet e gjykatave (vendim përmbarimor)	25,200	25,172	100%			
1700	**SERVISIMI I BORGJIT (NËNTOTALI)**	**-**	**-**		**-**	**-**	
17000	Pagesa e borgjit qeveritar	-	-		-	-	

Agjencia Kosovare e Privatizimit

4.g) Personeli dhe struktura e pagave

Niveli	Pozitat e aprovuara me Ligjin për Buxhet	Pozitat e plotësuara	Buxheti I aprovuar me ligjin për paga dhe meditje	Buxheti I shpenzuar për paga deri më 31 Dhjetor 2025	a) Orari i punës (orar i plotë/gjysëm orari) dhe b) Të specifikohet lloji i pagesës shtesë
1	2	3	4	5	6
*Niveli i Bordit	8	8	139,749	139,263	1 mbledhje në muaj
Niveli i menaxhmentit të lartë	3	3	122,750	122,750	Me orar të plotë
Niveli i menaxhmentit	37	35	770,880	770,880	Me orar të plotë
Niveli profesional	178	145	2,094,818	2,094,818	Me orar të plotë
Niveli mbështetës	16	15	99,452	99,452	Me orar të plotë
Lista teprice	0	3	80,370	80,370	nuk aplikohet
TOTALI	**242**	**209**	**3,308,019**	**3,307,533**	Me orar të plotë

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Agjencia Kosovare e Privatizimit
Kosovska Agencija za Privatizaciju

239

RAPORTI VJETOR FINANCIAR

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT

Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE 5
Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT 7
1.1. POLITIKAT KONTABËL 9
1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE 9
1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA 10
1.4. SHUMAT RAPORTUESE 10
1.5. VALUTA RAPORTUESE 10
1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE 11
Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT 11
SHËNIMI 2 PAGA DHE SHTESAT 17
2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2025 18
2.2 SHPALOSJE E PAGESAVE NDAJ ANËTARËVE TË BORDIT TË AKP-SË Kodi: “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441) 21
SHËNIMI 3 MALLRA DHE SHËRBIME 22
3.1 SHPJEGIME LIDHUR ME PERFORMANCEN E BUXHETIT NË KATEGORINE MALLRA DHE SHËRBIME 24
SHËNIMI 4 SHPENZIME KOMUNALE 25
SHËNIMI 5 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE 26
SHËNIMI 6 SHPENZIME KAPITALE 27
SHËNIMI 7 TJERA 28
SHËNIMI 8 TË HYRAT TATIMORE 29
SHËNIMI 9 TË HYRAT JO TATIMORE 29
SHËNIMI 10 TË ARDHURAT E DEDIKUARA 30
10.1. TË ARDHURAT E DEDIKUARA PËR TË MBULUAR SHPENZIMET OPERATIVE DHE ADMINISTRATIVE TË AKP-SË 30
SHËNIMI 11 GRANTET E PËRCAKTUARA TË DONATORËVE 31
SHËNIME TJERA 12 32
SHËNIME 13 PAGESA NGA PALËT E TRETA 32
Neni 16 TË ARKËTUESHMET 32
Neni 17 RAPORT PËR DETYRIMET (FATURAT) E PAPAGUARA 33
Neni 18 DETYRIMET KONTINGJENTE 34
Neni 19 RAPORT PËR PASURINË JO FINANCIARE 37

19.3.1 PASURITË KAPITALE (ME VLERË MBI 1000 EURO) 37
19.3.2 PASURITË JO KAPITALE (ME VLERË NËN 1000 EURO) 38
19.3.3 STOQET 39
Neni 20 RAPORT PËR AVANCE E PAARSYETUARA 40
Neni 21 RAPORT PËR TË HYRAT VETANAKE TË PASHPENZUARA 40
Neni 22 RAPORT PËR BILANCET E PASHPENZUARA TË FONDIT ZHVILLIMOR NË MIRËBESIM 41
Neni 23 RAPORT PËR TË HYRAT E DEDIKUARA 41
Neni 24 RAPORT PËR FONDET E DONATORËVE TË PASHPENZUARA 42
Neni 25 RAPORT PËR NUMRIN E PUNËTORËVE SIPAS LISTËS SË PAGAVE 42
Neni 26 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE JASHTË LISTËS SË PAGAVE 44
Neni 27 RAPORT PËR NUMRIN E TË PUNËSUARVE ME KONTRATE PËR SHËRBIME TË VEÇANTA 45
Neni 28 RAPORT PËR GJENDJEN/ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT (ZKA) 45

Neni 13: PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE

Pasqyra e Pranimeve dhe Pagesave në para të gatshme për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

	Shënime	2025 Llogaria e vetme e Thesarit BKK '000	2024 Llogaria e vetme e Thesarit BKK '000	2023 Llogaria e vetme e Thesarit BKK '000
BURIMET E FONDEVE - Pranimet				
Granti Qeveritar		4,312	4,553	4,594
Të hyrat vetanake		-	-	-
Të hyrat e dedikuara		-	-	-
Të hyrat nga AKP		-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve		-	-	-
Klauzola e investimeve		-	-	-
Fondi zhvillimor në mirëbesim		-	-	-
	GJITHSEJ	**4,312**	**4,553**	**4,594**
SHFRYTEZIMI I FONDEVE - Pagesat				
Operacionet				
Paga dhe Shtesa	2	3,307	3,467	3,620
Mallra dhe Shërbime	3	841	924	879
Shpenzime Komunale	4	110	106	82
	GJITHSEJ	**4,258**	**4,497**	**4,581**
Transferet				
Transfere dhe Subvencione	5	-	-	-
Shpenzime kapitale				
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6	54	56	13
Pagesa tjera	7	-	-	-
	GJITHSEJ	**4,312**	**4,553**	**4,594**

Neni 14: RAPORTI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025

		Janar – Dhjetor 2025				2024	2023
	Shënime	Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
		A '000	B '000	C '000	D=B-A '000	E '000	F '000
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit							
Të hyrat tatimore	8	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	9	-	-	-	-	-	-
*Të hyrat e dedikuara	10	-	-	-	-	-	-
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11	-	-	-	-	-	-
Tjera	12	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Dalja e parasë së gatshme nga llogaria e Thesarit							
Paga dhe shtesa	2	3,307	3,308	3,662	1	3,467	3,620
Mallra dhe shërbime	3	841	895	1,105	54	924	879
Shpenzime komunale	4	110	110	110	-	106	82
Transfere dhe subvencione	5	-	-	5	-	-	-
Shpenzime kapitale	6	54	230	230	176	56	13
Tjerat	7	-	-	-	-	-	-
Gjithsej		**4,312**	**4,543**	**5,112**	**231**	**4,553**	**4,594**

*AKP nuk planifikon të hyra. AKP vetëm depoziton mjetet (Të Hyrat e Dedikuara) në Buxhetin e Përgjithshëm të Kosovës për të mbuluar buxhetin e aprovuar me Ligjin e Buxhetit. AKP, nuk planifikon të hyrat si në rastin e komunave, por për çështje të raportimit, nga Departamenti i Thesarit, Ministria e Financave Punës dhe Transfereve është kërkuar që të raportohet në këtë mënyrë. Detajet janë të shpalosura në shënimin nr. 10 dhe nr. 23.

1.1. POLITIKAT KONTABËL

Pasqyrat Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025 janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik si dhe rregullores të Ministrisë së Financave Nr. 01/2017 " Për Raportim Financiar për Organizatat Buxhetore". Rregullorja i përmbush të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063, Ligjin nr. 05/L-007 dhe Ligjin 08/L-183 për mbështetjen e punëve publike.

1.2. INFORMATA PËR ORGANIZATËN BUXHETORE

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka përgatitur Pasqyrat Financiare në harmoni me kërkesat e Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007.

Sipas LMFPP të gjitha transaksionet me fonde brenda Fondit të Konsoliduar të Republikës se Kosovës bëhen përmes Llogarisë se Vetme të Thesarit, MFPT.

Agjencia Kosovare e Privatizimit është një organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit Nr. 04/L-034, ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05-/L-080, ligjin Nr. 04/L-115 për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës si dhe ndryshim plotësimin me ligjin Nr. 06/L-023.

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve takohet në baza të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit. Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të ligjit nr. 06/L -023.
Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2025.

Aktiviteti kryesor i AKP-së është privatizimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore (NSh-ve). Aktivitet tjetër i AKP-së është administrimi, ristrukturimi dhe riorganizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore aty ku paraqitet nevoja deri në përmbylljen e procesit të likuidimit. Agjencia Kosovare e Privatizimit administron Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë dhe i mban këto Ndërmarrje në mirëbesim. Si administruese e besuar, AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës të NSh-ve.

Në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë, Menaxhmenti i AKP-së përbëhet nga:
- Drejtori Ekzekutiv, i emëruar z. Burim Leci, në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës (U.D.);
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë, i emëruar z. Petrit Ibraj, në cilësinë e U.D., meqenëse z. Burim Leci është emëruar U.D. në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv; dhe
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme, i emëruar z. Ibrahim Gjylderen.

Më 30 shtator 2024, Bordi i Drejtorëve të AKP-së pranoi dorëheqjen e z. Arben Limani, Drejtor Ekzekutiv, me efekt nga data 21 nëntor 2024. Nga data 22 nëntor 2024 deri më 6 korrik 2025, në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv ishte emëruar z. Ibrahim Gjylderen, në cilësinë e U.D.

Nga data 7 korrik 2025, me vendim të Bordit të Drejtorëve, është emëruar z. Burim Leci në cilësinë e U.D. Drejtor Ekzekutiv.

Pasqyrat Financiare paraqesin subjektin raportues ashtu siç është specifikuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Periudha raportuese e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në këto pasqyra financiare është prej **1 janar deri më 31 dhjetor 2025**. Buxheti i AKP-së gjatë periudhës raportuese është financuar nga **Granti Qeveritar (GQ).**

Të hyrat e Dedikuara (THD) - Sipas nenit 15 të Ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, **janë**: *Të gjitha të ardhurat e Agjencisë do të jenë të ardhura të dedikuara të Agjencisë sipas nenit 64 të LMFPP-së. Përveç kësaj, pesë përqind (5%) e të gjitha të hyrave të pranuara si rrjedhojë e çfarëdo shitje në të kaluarën apo të ardhmen, transferimit, privatizimit, likuidimit apo mënyrave tjera të disponimit me cilëndo ndërmarrje apo aset, pavarësisht nëse është bërë nga Agjencia apo paraardhësja e saj, do të jetë tarifë administrative e Agjencisë për të mbuluar shpenzimet e veta të përgjithshme administrative dhe operative; dhe ajo tarifë do të jetë pjesë e të ardhurave të dedikuara të Agjencisë. Agjencia në baza vjetore i transferon dhe depoziton të gjitha ato të ardhura nga tarifa në Fondin e Konsoliduar të Kosovës, në pajtim me rregullat në fuqi të LMFPP-së. Thesari dhe Ministria e Financave sigurojnë që ato fonde të vendosen dhe mbahen në llogarinë e dedikuar të ardhurave të Agjencisë*.

Granti Qeveritar (GQ) është fondi i cili financon të gjitha aktivitetet e organizatave buxhetore. Në rastin e Agjencisë, nga Granti Qeveritar janë financuar të gjitha aktivitetet administrative dhe operative për vitin fiskal 2025.

1.3. PAGESAT NGA PALËT E TRETA

Në zbatim të SNKSP pagesat nga palët e treta shpalosen në shënimin 13.

1.4. SHUMAT RAPORTUESE

Shumat raportuese nga formati i pasqyrave financiare nga neni 13 deri te neni 15 janë në `000 (mijë) Euro (€) dhe nga neni 16 deri te neni 24 shumat janë të plota Euro (€).

1.5. VALUTA RAPORTUESE

Shumat janë raportuar në valutën Euro (€).

1.6. DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare autorizohen në datën e nënshkrimit të deklaratës së Pasqyrave Financiare nga Z. Burim Leci, U.D. Drejtor Ekzekutiv (Zyrtar Kryesorë Administrativ) dhe Z. Adem Selishta - Drejtor i Financave dhe Buxhetit (Zyrtar Kryesorë Financiar).

Neni 14.6: SHPALOSJA E NDARJEVE FILLESTARE DHE FINALE TË BUXHETIT

		Ndryshimet e autorizuara nga LMFPP						
Kategoria e ndarjes	**Buxheti Fillestar (Ligji Nr. 08/L-332)**	**Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 03/261**	**Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 01/276**	**Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 01/281**	**Ndryshimi buxhetor vendimi i Qeverisë nr. 04/282**	**Të hyrat vetanake**	**Burime tjera të financimit**	**Buxheti përfundimtar SIMFK**
	€ '000	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**	**€ '000**
Hyrjet								
Të hyrat tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat jo tatimore	-	-	-	-	-	-	-	-
Të hyrat e dedikuara	-	-	-	-	-	-	-	-
Grandet e përcaktuara të donatorëve	-	-	-	-	-	-	-	-
Huamarrjet	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Daljet								
Paga dhe shtesat	3,662	77	-	(431)	-	-	-	3,308
Mallra dhe shërbime	1,105	-	(105)	-	(105)	-	-	895
Shpenzime komunale	110	-	-	-	-	-	-	110
Transfere dhe subvencione	5	-	(5)	-	-	-	-	0

Shpenzime kapitale	230	-	-	-	-	-	-	230
Kthimi i huamarrjeve	-	-	-	-	-	-	-	-
Tjerat	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	**5,112**	**77**	**(110)**	**(431)**	**(105)**	**-**	**-**	**4,543**

Më poshtë do paraqesim një shpalosje lidhur me shkurtimet buxhetore dhe kërkesat shtesë nga AKP-ja dhe vendimet e qeverisë përkatësisht vendimi nr. **03/261/, 01/276, 01/281 dhe 04/282** lidhur me kërkesat e parashtruara nga AKP-ja.

Vlera e kursimeve që AKP-ja ka identifikuar dhe deklaruar përmes shkresës drejtuar MFPT-së është **EUR 139,769**. Nga kjo shumë, si kursime janë marrë parasysh vetëm **EUR 109,769**, të realizuara nga dy kategori ekonomike, përkatësisht **EUR 5,000** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe **EUR 104,769** nga kategoria ekonomike e mallrave dhe shërbimeve.

AKP-ja nga vlera e përgjithshme ka kërkuar që shuma prej **EUR 30,000**, nga mjetet e kursyera brenda programeve buxhetore të saj, të transferohet në programin buxhetor të Administratës Qendrore, konkretisht në kategorinë ekonomike të shërbimeve komunale. Meqenëse kjo kërkesë nuk është aprovuar nga MFPT-ja, mjetet përkatëse nuk janë bartur dhe, rrjedhimisht, obligimet për faturat e shërbimeve komunale për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor janë bartur si obligime të papaguara dhe janë reflektuar në buxhetin e vitit 2026.

Përveç kursimeve të lartcekura, gjatë periudhës raportuese janë realizuar edhe lëvizje të tjera buxhetore, të cilat kanë rezultuar nga vendime të Qeverisë dhe të cilat paraqiten dhe shpjegohen në vazhdim të pasqyrave financiare.

Mallra dhe Shërbime:

Në kategorinë mallra dhe shërbime buxheti fillestar ka qenë EUR 1,105,000. Me kërkesën e AKP-së dhe vendimeve të marra nga qeveria, kursimet buxhetore në kategorinë e Mallrave dhe Shërbimeve kanë vlerën EUR 209,716. Kursimet janë bërë nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, dhe buxheti përfundimtar ne këtë kategori ekonomike është EUR 895,283.

Paga dhe Shtesat:

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2025, numri i aprovuar i të punësuarve në AKP është 234 nëpunës, si dhe 8 anëtarë të Bordit të Drejtorëve, gjithsej 242 persona.

Në kategorinë ekonomike Pagat dhe Shtesat, buxheti fillestar ka qenë **EUR 3,661,731**. Me Vendim të Qeveris nr. 03/261 të datës 05 qershor 2025, AKP ka pranuar shumën prej **EUR 76,732** si shtesë buxhetore për zbatimin e nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 për rritjen e dytë prej 0.5 njësi të koeficientit, mirëpo AKP ka reaguar dhe ka njoftuar me shkrim Departamentin e Buxhetit të MFPT meqenëse zyrtaret e AKP-s sipas Ligjit te Pagave përfitojnë shtesën tranzitore dhe rritja e sasisë se koeficient prej 0.5 (EUR 55.00) reflekton vetëm ne disa pozita (stafi mbështetës teknik) dhe ne nuk i kemi shfrytëzuar këto mjete.

Ndërkaq, në fund të muajit dhjetor 2025, me vendim të Qeverisë, janë identifikuar kursime buxhetore në këtë kategori nga MFPT-ja në vlerë prej EUR 430,444.00, duke rezultuar në një buxhet përfundimtar prej EUR 3,308,019.00.

Ndërsa në fund të vitit, sipas vendimi të Qeveris Nr. 01/276 të datës 24 dhjetor 2025,MFPT ka reduktuar buxhetin e pagave nga buxheti i Agjencisë shumën prej EUR 430,444.00 .

Në këtë kategori përfshihen pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së, si dhe kompensimi për **8 anëtarët e Bordit të Drejtorëve të AKP-së**.

Shpenzimi total në kategorinë e pagave dhe shtesave për vitin 2025 është **EUR 3,307,537**, që përfaqëson një nivel realizimi prej **99.99%** të buxhetit final. Detajet përkatëse janë të shpalosura në **Shënimin 2.1 – Pagat e Stafit të AKP-së** dhe **Shënimin 2.2** të pasqyrave financiare.

Pagat dhe mëditjet e zyrtarëve të AKP-së, sipas listave të pagave, procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT). AKP-ja dorëzon listat e stafit për periudhat përkatëse pranë këtij divizioni, nga i cili realizohen pagesat në llogaritë përkatëse të punonjësve. Pagesat për kontributet e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen drejtpërdrejt në Administratën Tatimore të Kosovës.

<u>Shpenzimet Kapitale:</u>

Sipas Ligjit të Buxhetit për vitin fiskal 2025, buxheti i aprovuar për shpenzime kapitale ka qenë **EUR 230,000**, ndërsa realizimi i buxhetit në këtë kategori është **23.38%**.

Mjetet kanë qenë të dedikuara për dy projekte kapitale, si më poshtë:

1. **Blerja e pajisjeve të teknologjisë informative (TI) për ngritjen e cilësisë së shërbimeve**
   (Kodi i projektit: **18941**), me vlerë të aprovuar EUR 30,000.00. Projekti është realizuar në tërësi dhe teprica e mjeteve të pashpenzuara është EUR 2,429.66.

2. **Data Baza e Arkivës së AKP-së**
   (Kodi i projektit: **19256**), me vlerë të aprovuar EUR 200,000.00.

Kontrata për projektin "Data Baza e Arkivës së AKP-së" është nënshkruar në vlerë prej EUR 74,850.00. Diferenca prej EUR 125,150.00 është paraqitur pranë MFPT-së si kursim buxhetor, me kërkesë për reduktim nga buxheti i vitit 2025.

Sipas kushteve kontraktuale, realizimi i projektit do të zgjasë 12 muaj, ndërsa pagesat do të realizohen në mënyrë periodike, në përputhje me ecurinë e punimeve të parapara në kontratë. Implementimi i projektit ka filluar më 29 tetor 2025, ndërsa përfundimi dhe pranimi final pritet të realizohet më 28 tetor 2026.

Me datë 12 nëntor 2025, AKP-ja ka njoftuar MFPT-në lidhur me periudhën e implementimit të kontratës dhe ka kërkuar bartjen e buxhetit për këtë projekt në vitin 2026, me qëllim të sigurimit të ekzekutimit të rregullt financiar në përputhje me obligimet kontraktuale.

Gjatë vitit 2025, pagesat e realizuara për këtë projekt janë në vlerë prej EUR 26,197.50, ndërsa pjesa e mbetur EUR 48,652.50 do të realizohet gjatë vitit 2026.

Vlera e kursimeve nga vendimet e Qeverisë për AKP-në për vitin fiskal 2025 sipas kategorive ekonomike është paraqitur në formë tabelare si më poshtë:

- **Ndryshimi buxhetore I - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 03/261 të datës 05/06/2025**

		1	2	3	4	5	6	7=∑(1:6)
Nr.	**Përshkrimi**	**Administrata Qendrore**	**Auditimit**	**Departamenti Ligjor**	**Riorganizimi dhe administrimi i NSh**	**Privatizimi**	**Likuidimi**	**Totali**
1	Paga dhe shtesa	77	-	-	-	-	-	77
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	-
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	-
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	-
	Gjithsej	**77**	**-**	**-**	**-**	-	**-**	**77**

- **Ndryshimi buxhetore II - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 01/276 datës 24/11/2025**

		1	2	3	4	5	6	7=∑(1:6)
Nr.	**Përshkrimi**	**Adminsitrata Qendrore**	**Auditimit**	**Departamenti Ligjor**	**Riorganizimi dhe administrimi i NSh**	**Privatizimi**	**Likuidimi**	**Totali**
1	Paga dhe shtesa	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	-	(5)	(4.5)	(2.5)	(19.4)	(73.3)	**(104.7)**
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	(5)	-	-	**(5)**
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	**-**
	Gjithsej	**-**	**5**	**4.5**	**7.5**	**19.4**	**73.3**	**109.7**

- **Ndryshimi buxhetore III - sipas vendimit të Qeverisë me nr.**

		1	2	3	4	5	6	7=∑(1:6)
Nr.	**Përshkrimi**	**Adminsitrata Qendrore**	**Auditimit**	**Departamenti Ligjor**	**Riorganizimi dhe administrimi i NSh**	**Privatizimi**	**Likuidimi**	**Totali**
1	Paga dhe rroga	(431)	-	-	-	-	-	**(431)**
2	Mallra dhe shërbime	-	-	-	-	-	-	**-**
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	**-**
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	**-**
	Gjithsej	**431**	**-**	**-**	**-**	-	-	**431**

- **Ndryshimi buxhetore IV - sipas vendimit të Qeverisë me nr. 04/282 të datës 26/12/2025**

		1	2	3	4	5	6	7=∑(1:6)
Nr.	**Përshkrimi**	**Adminsitrata Qendrore**	**Auditimit**	**Departamenti Ligjor**	**Riorganizimi dhe administrimi i NSh**	**Privatizimi**	**Likuidimi**	**Totali**
1	Paga dhe rroga	-	-	-	-	-	-	-
2	Mallra dhe shërbime	(49)	-	-	-	(53)	(3)	**(105)**
3	Shpenzime komunale	-	-	-	-	-	-	-
5	Transfere dhe subvencione	-	-	-	-	-	-	**-**
6	Shpenzime kapitale	-	-	-	-	-	-	**-**
	Gjithsej	**49**	**-**	**-**	**-**	53	3	**105**

SHËNIMI 2 PAGA DHE SHTESAT

	2025					2024	2023
Përshkrimi	**Gjithsej Pagesat € '000**	**GQ € '000**	**THD € '000**	**Buxheti Final € '000**	**Ndryshimi Buxheti - Pagesat € '000**	**€ '000**	**€ '000**
Pagat neto përmes listës së pagave	1,558	1,558	-	1,558	-	1,420	2,832
Shtesat Tranzitore	978	978	-	978	-	1,190	-
Përvoja e punës për stafin e AKPs	109	109	-	109	-	94	-
Funksionar me kohë të pjesshme	139	139	-	140	1	219	214
Tatimi i ndaluar në të ardhura personale	215	215	-	215	-	231	249
Kontributi pensional-punëtori	151	151	-	151	-	155	162
*Vendim Gjyqësorë	5	5		5			
Kontributi pensional-punëdhënësi	151	151	-	151	-	155	162
Shtesa për kushte të tregut të punës	1	1	-	1	-	3	-
PAGA DHE Shtesa -	**3,307**	**3,307**	**-**	**3,308**	1	**3,467**	**3,620**

***Në Tetor 2024 Zyrtari N.I.** kishte deponuar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbyesit Civil të Kosovës (KPMSHCK) për mos aplikimin e shtesës për kushte të tregut, në pagë. Kërkesa është në vlerë prej 250 Euro në muaj - nga muaji Prill 2023 deri në pagesën definitive. Sipas vendimit të KPMSHCK, ankesa i ishte aprovuar zyrtarit në fjalë për pagesën prej EUR 250.00 në muaj nga Prill 2023 deri në Maj 2025. Ngjarja ishte parashikuar dhe shpalosur edhe si detyrim kontigjentë në PF 2024.

2.1 PAGAT E STAFIT TË AKP-SË dhe Buxheti shtesë në kategorinë e pagave për vitin fiskal 2025

Numri i punëtorëve dhe Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve i aprovuar sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2025 është 242 (234 nëpunës dhe 8 Anëtarët e Bordit ët Drejtorëve). Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 25.

Po ashtu në numrin e përgjithshëm të punëtorëve të buxhetuar janë të përfshirë edhe 8 Anëtarët e Bordit të Drejtorëve. Detajet janë paraqitur në shënimin shpjegues nr. 2.2.

Pagat dhe mëditjet procedohen përmes Divizionit të Pagave në kuadër të Departamentit të Thesarit të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve. AKP dërgon listat e punëtorëve (stafit të saj) për periudhat përkatëse në këtë Divizion dhe nga i cili procedohen pagesat në llogaritë përkatëse të punëtorëve të AKP-së. Pagesat për kontributin e punëdhënësit dhe tatimin në burim realizohen direkt në Administratën Tatimore të Kosovës.

Shpenzimet për paga dhe shtesa përfshijnë pagat bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së si dhe kompensimin e 8 anëtarëve të bordit të AKP-së.

Në kategorinë paga dhe shtesa buxheti fillestar ka qenë **EUR 3,661,731** ndërsa ai përfundimtar është **EUR 3,308,019**. Diferenca e shumës **prej EUR 353,711**, MFPT në kategorinë e pagave dhe shtesës ka ardhur si rezultat i dy vendimeve të Qeveris së Kosovës:

Vendimi i Qeveris me NR. 03/261 të datës 05 qershor 2025, AKP ka pranuar shumën prej EUR 76,732 si shtesë buxhetore për zbatimin e nenit 33, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-332 për rritjen e dytë prej 0.5 njësi të koeficientit, mirëpo AKP ka reaguar dhe ka njoftuar me shkrim Departamentin e Buxhetit të MFPT meqenëse zyrtaret e AKP-s sipas Ligjit te Pagave përfitojnë shtesën tranzitore dhe rritja e sasisë se koeficient prej 0.5 (EUR 55.00) reflekton vetëm ne disa pozita (stafi mbështetës teknik) dhe ne nuk i kemi shfrytëzuar këto mjete.
Ndërsa në fund të vitit, sipas vendimi të Qeveris Nr. 01/276 të datës 24 dhjetor 2025,MFPT ka reduktuar buxhetin e pagave nga buxheti i Agjencisë shumën prej EUR 430,444.00 .

Shpenzimet për Pagat Bruto dhe kontributet për nëpunësit e AKP-së për vitin 2025 janë gjithsej **EUR 3,168,274**. Buxheti i shpenzuar për kompensimin e Anëtarëve të Bordit të Drejtorëve, Komitetin Auditimit dhe Komisionit për vlerësim të performancës së Menaxhmentit për vitin 2025 është në vlerën **EUR 138,476**. Ndërsa, **EUR 787.00** janë shpenzime e angazhimit të ekspertëve të jashtëm të angazhuar si anëtar të komisionit sipas Ligjit për rekrutimin e pozitave të larta. Kompensimi dhe Kontributet e pagesave të Bordit dhe të komisioneve janë realizuar nga kodi ekonomik “Funksionarët me kohë të pjesshme” (11441).

Gjithsej shpenzimi i buxhetit në kategorinë e pagave është **EUR 3,307,537**. Realizimi i buxhetit në këtë kategori është 99.99%.

LËVIZJET E STAFIT:

- **REKRUTIMET:** Gjatë kësaj periudhe, Divizioni i Burimeve Njerëzore (DBNJ) ka udhëhequr me njëmbëdhjetë (11) procedura të rekrutimit, prej tyre dhjetë (10) janë ne procesin si me poshtë:
  - Dy (2) procese janë në vazhdim dhe aktualisht ndodhen në fazën e verifikimit paraprak.
  - Një (1) proces ka përfunduar me sukses.

Tetë (8) procese janë anuluar, si në vijim:

- Dy (2) procese janë anuluar me vendim të KPMSHC;
- Një (1) proces ka dështuar pasi kandidati nuk është paraqitur në intervistë;
- Dy (2) procese janë anuluar për shkak të gabimeve teknike;
- Dy (2) procese janë anuluar për shkak të problemeve në sistem;
- Një (1) proces është anuluar për shkak të skadimit të mandatit të Bordit të Drejtorëve.

Lista e proceseve:

- **Drejtor Ekzekutiv** – anuluar me vendim të KPMSHC për shkak të ankesës së një kandidati
- **Zyrtar Kadastral, ZR Prizren (Rishpallje III – RN00016519)** – ka dështuar pasi vetëm një (1) kandidat ka kaluar testimin me shkrim dhe nuk është paraqitur në intervistë
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt – Kadastër** – ka përfunduar me sukses
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt** – anuluar me vendim të KPMSHC për shkak të ankesës së një kandidati
- **Drejtor Ekzekutiv (Rishpallje – RN00018306)** – anuluar për shkak të skadimit të mandatit të Bordit të Drejtorëve
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00018930)** – anuluar për shkak të lëshimit teknik
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (RN00018931)** – anuluar për shkak të lëshimit teknik
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00018940)** – anuluar për shkak të punimeve në rrjetet softuerike të sistemit të AShI
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (Rishpallje – RN00018939)** – anuluar për shkak të punimeve në rrjetet softuerike të sistemit të AShI
- **Zyrtar i Lartë i Shitjes Direkt (Rishpallje – RN00019105)** – në proces
- **Zyrtar i Zyrës Rajonale, ZR Prishtinë (Rishpallje – RN00019106)** – në proces

- **DORËHEQJE:** Për arsye personale tre (3) punonjës kanë dhënë dorëheqje.
- **TRANSFERET E PËRHERSHME:** Tre (3) punonjës janë transferuar në mënyrë të përhershme.
- **TRANSFERET E PËRKOHSHME:** Njëzet (20) punonjës janë transferuar në mënyrë të përkohshme, prej tyre (pesë) 5 janë caktuar në vitin 2024 me afat deri në vitin 2025
- **PEZULLIM I DAKORDUAR:** Gjashtë (6) punonjësve u është lejuar pezullimi i dakorduar i marrëdhënies së punës sipas Ligjit në fuqi.
- **PUSHIM LEHONIE**: Katër (4) zyrtare kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë, prej të cilave tre (3) punonjëse pushimin e lehonisë e ka filluar ne vitin 2024.
- **PENSIONIME**: Shtatë (7) nëpunës janë pensionuar.
- **PENSIONIM TE PARAKOHSHEM**: Tre (3) nëpunës kanë shfrytëzuar pensionimin e parakohshëm;
Nr.	**Komponenta e auditimit (kapitulli)**	**Gjetja**	**Rekomandimi**	**Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit**	**Zyrtari-ët Përgjegjës**	**Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit**
1	Pagat dhe mëditjet	Emërimi i komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit nga Bordi i drejtorëve në	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se vlerësimi i menaxhmentit është në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe nuk i delegohet asnjë personi /komisioni tjetër. Për më tepër, të siguroj që për detyrat që janë pjesë e përgjegjësive të rregullta të mos bëjë asnjë kompensim shtesë.	Edhe pse është vlerësuar që pagesa e komisionit për vlerësim dhe raportim të punës së Menaxhmentit ishte e justifikuar, kemi deklaruar se nëse auditorët e konsiderojnë si të parregullt, ne do ta ndërpresim. Si rrjedhojë konfirmojmë se praktika e	Sekretariati i Bordit	1 korrik 2025

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e ndërmarra dhe rezultatet konkrete në lidhje me zbatimin të rekomandimit	Zyrtari-ët Përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
		kundërshtim me kërkesat ligjore		pagese së komisionit do të ndërpritet plotësisht nga muaji korrik 2025.Vlersimi i punës së menaxhmentit do të realizohet vetëm në përputhje të plotë me kërkesat ligjore.		
2	Pasuritë kapitale dhe jokapitale	Mos funksionimi i sistemit "e-pasuria"	Bordi i Drejtorëve duhet të marrë veprime të nevojshme dhe të vazhdueshme për ta vënë në funksion sistemin e-pasuria	Ne e ritheksojmë se funksionalizimi i sistemit e-pasuria është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë së Punëve të Brendshme. Megjithatë ne do të vazhdojmë që me ngulm të kërkojmë nga ata që të vë në funksion sistemin në mënyrë që të na mundësohet përdorimi i tij i rregullt dhe në përputhje me kërkesat ligjore.	Departamenti i Administratës	1 korrik – 31 dhjetor 2025

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

PASQYRAT FINANCIARE

FONDET NË MIRËBESIM

PËR PERIUDHËN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2025

TABELA E PËRMBAJTJES

I. PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM 7

II. GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM 11

III. SHËNIMET SHPJEGUESE 15

IV. TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE 17

2. TË HYRAT NGA SHITJA 17

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË 20

4. INTERESI I FITUAR 24

5. TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES 25

6. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER 25

7. TË HYRA TJERA 26

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT 28

V. SHPENZIMET/SHPËRNDARJA 29

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK 29

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP) PËR LIKUIDIMIN E NSH-ve 30

11. MALLRA DHE SHËRBIME 32

12. SHPENZIME KOMUNALE 37

13. TATIMET 38

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE 39

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së 40

16. SHPENZIME TJERA 42

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM 43

18. FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS 45

VI. LLOGARITË E ARKËTUESHME 46

19. NDËSHKIMET NDAJ NSH-ve ME SPIN-OFF SPECIAL 47

20. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETEVE 48

21. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHPRONËSIMI I ASETEVE 50

22. LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË DHE TJERA 51

VII. LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE 55

23. LLOGARITË E PAGUESHME 55

24. DETYRIMET KONTIGJENTE 58

VIII. PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE .. 62

IX. TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE 63

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM 63

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE 63

X. GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve 64

XI. LLOJET E LLOGARIVE BANKARE 67

XII. PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM 69

PASQYRAT FINANCIARE 2025

- PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM
- GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

I. PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Përshkrimi	Shënimi shpjegues	Gjendja fillestare 1 janar 2025	2025 Hyrje/dalje	Bilanci përfundimtar 31 dhjetor 2025
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE				
Të hyrat nga shitja e aseteve	*2*	806,504,191	19,760,716	826,264,907
Të hyrat nga qiraja	*3*	68,301,928	6,101,809	74,403,737
Interesi i fituar	*4*	35,674,275	555,712	36,229,987
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	*5*	9,188,165	99,002	9,287,167
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	*6*	330,000	(330,000)	-
Të hyra tjera	*7*	7,728,755	214,652	7,943,407
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	*8*	1,013,200	-	1,013,200
Gjithsej pranimet		**928,740,514**	**26,401,891**	**955,142,405**
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË				
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	*9*	166,902,483	5,822,538	172,725,021
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	*10*	18,405,857	541,650	18,947,507
Mallra dhe shërbime	*11*	27,613,269	1,568,755	29,182,024
Shpenzimet komunale	*12*	3,546,080	144,712	3,690,792
Tatimet	*13*	13,492,192	961,218	14,453,410
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	*14*	8,626,864	21,329	8,648,193
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	*15*	45,777,947	-	45,777,947
Të tjera	*16*	891,272	3,234	894,506
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-ve	*17*	66,356,733	3,576,357	69,933,090
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	*18*	397,984,947	(1,198,530)	396,786,417
Gjithsej pagesat/shpërndarja		**749,597,644**	**11,441,263**	**761,038,907**
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE		**179,142,870**	**14,960,628**	**194,103,498**

PASQYRA E PRANIMEVE DHE PAGESAVE TË FONDEVE NË MIRËBESIM PËR TRE VITET E FUNDIT

Përshkrimi	Shënim	2025	2024	2023	2025 Vs 2024	2025 Vs 2023
PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE						
					përqindje%	
Të hyrat nga shitja e aseteve	*2*	19,760,716	17,370,921	5,408,810	13.76%	265.34%
Të hyrat nga qiraja	*3*	6,101,809	5,519,944	5,310,881	10.54%	14.89%
Interesi i fituar	*4*	555,712	517,127	312,448	7.46%	77.86%
Të hyrat nga tarifa dhe konfiskimet e Bid Depozitave në tenderët e shitjes	*5*	99,002	159,500	36,200	(37.93)%	173.49%
Bid depozitat për Pjesëmarrje në Tender	*6*	(330,000)	208,500	(89,500)	(258.27)%	268.72%
Të hyra tjera	*7*	214,652	181,427	(235,440)	18.31%	191.17%
Kapitali themeltar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit	*8*	-	-	-	0.00%	0.00%
Gjithsej pranimet		**26,401,891**	**23,957,419**	**10,743,399**	**10.20%**	**145.75%**
PAGESAT/SHPËRNDARJA NGA LLOGARITË						
20% i punëtorëve transferuar në BSPK	*9*	5,822,538	3,445,372	3,229,677	69.00%	80.28%
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoritetet e Likuidimit)	*10*	541,650	499,800	499,800	8.37%	8.37%
Mallra dhe shërbime	*11*	1,568,755	1,792,552	1,660,991	(12.48)%	(5.55)%
Shpenzimet komunale	*12*	144,712	105,587	178,674	37.05%	(19.01)%
Tatimet	*13*	961,218	750,624	764,646	28.06%	25.71%
Vendimet e gjykatave/përmbaruesve (depozita dhe taksa)	*14*	21,329	89,028	47,226	(76.04)%	(54.84)%
Transferimi i mjeteve 5% për mbulimin e aktiviteteve të AKP-së	*15*	-	-	-	0.00%	0.00%
Të tjera	*16*	3,234	7,098	12,393	(54.44)%	(73.90)%
Pagesat ndaj kreditorëve të NSH-së	*17*	3,576,357	4,746,620	3,830,728	(24.65)%	(6.64)%
Fondet transferuar Buxhetit të Kosovës	*18*	(1,198,530)	(248,794)	-	381.74%	100.00%
Gjithsej pagesat/shpërndarja		**11,441,263**	**11,187,887**	**10,224,135**	**2.26%**	**11.90%**
BILANCI I PRANIMEVE DHE PAGESAVE		**14,960,628**	**12,769,532**	**519,264**	**17.16%**	**2,781.12%**

II. GJENDJA E LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Llogaritë bankare të paraqitura më poshtë janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Llojet e llogarive bankare	2003 deri 31 DHJETOR 2025	2003 deri 31 DHJETOR 2024	2003 deri 31 DHJETOR 2023	1 janar 31 dhjetor 2025	1 janar 31 dhjetor 2024	1 janar 31 dhjetor 2023
Privatizim	916,294	913,511	910,729	2,783	2,782	1,728
Likuidim	181,247,951	165,793,937	154,549,670	15,454,014	11,244,267	2,577,409
Para të NSh-ve në mirëbesim	2,092,875	2,119,404	1,017,059	(26,529)	1,102,345	(742,216)
Komercializim	-	-	-	-	-	-
Llogaritë e parave në mirëbesim për punëtorët	4,284,951	3,856,293	3,522,588	428,658	333,705	222,791
Depozita nga tenderët e privatizimit	-	-	-	-	-	-
Tarifa për Dorëzimin e Tenderit në Privatizim	-	-	-	-	-	-
Depozita nga tenderët e shitjeve me Likuidim	2,875	332,270	123,661	(329,395)	208,609	(89,529)
Tarifa e dorëzimit të ofertave në likuidim	6,187	10,911	42,839	(4,724)	(31,928)	36,211
Depozitat e Komisionit të Rishikimit të Likuidimit	25	25	25	-	-	-
Kapitali themeltar i AKP-së	901,962	899,223	896,485	2,739	2,738	1,702
Fondi rezervë i AKP-së	13,787	16,282	19,770	(2,495)	(3,488)	1,728
Donator	8,531	8,505	8,479	26	26	16
Tarifa administrative e AKP-së	1,683,856	1,068,593	1,406,393	615,263	(337,800)	(1,343,439)
Depozitat Kohor	-	-	-	-	-	-
Të hyrat nga shpronësimet	2,944,204	4,123,916	3,875,640	(1,179,712)	248,276	(147,137)
GJITHSEJ	**194,103,498**	**179,142,870**	**166,373,338**	**14,960,628**	**12,769,532**	**519,264**

SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE 2025

PËR FONDET NË MIRËBESIM

III. SHËNIMET SHPJEGUESE

BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik. Në përputhje me SNKSP, këto pasqyra janë prezantuar sipas parimit të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Gjithashtu, këto pasqyra financiare i përmbushin obligimet raportuese që dalin nga "Rregullorja e Kornizës Raportuese të Pasqyrave Financiare të Fondeve në Mirëbesim" e aprovuar nga Bordi i Drejtorëve më 23 Shkurt 2011.

Llogaritë e arkëtueshme, llogaritë e pagueshme dhe detyrimet kontingjente paraqiten vetëm si shpalosje në pasqyrat financiare të Fondeve në Mirëbesim.

Të gjitha të dhënat financiare të pranimeve dhe pagesave që janë paraqitur në këto shënime janë nga llogaritë bankare të NSH-ve që Agjencia menaxhon dhe administron në Bankën Qendrore të Kosovës.

SUBJEKTI RAPORTUES

Agjencia Kosovare e Privatizimit është themeluar me Ligjin mbi Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr. 03/L-067 që ka hyrë në fuqi me 1 korrik 2008 e shfuqizuar me Ligjin nr. 04/L-034 që ka hyrë në fuqi më 21 shtator 2011 dhe ndryshim/plotësimet të Ligjit nr. 04/L-115 të datës 7 shtator 2012, të Ligjit nr. 05/L-080 të datës 24 dhjetor 2015 dhe Ligjit nr. 06/L-023 të datës 3 maj 2018.

Në pajtim me Ligjin mbi themelimin e AKP-së, aktiviteti i AKP-së është privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore – NSH nëpërmjet metodave të "spin off-it", qiradhënie, administrimi, ristrukturimi dhe likuidimi i Ndërmarrjeve Shoqërore.

Agjencia Kosovare e Privatizimit, menaxhon ndërmarrjet shoqërore në Kosovë dhe i mban këto ndërmarrje në mirëbesim. AKP është e ngarkuar me "ruajtjen dhe rritjen" e vlerës së NSH-ve dhe aseteve të tyre brenda dhe jashtë Kosovës.

RAPORTIMI I TRANSAKSIONEVE PËRMES LLOGARIVE TË AKP-SË

AKP menaxhon dhe i kontrollon shpenzimet dhe të hyrat përmes llogarive në mirëbesim të hapura në Bankën Qendrore të Kosovës. AKP bën transferin e pagesave pasi të jetë bërë autorizimi kolektiv i urdhër-transfereve bankare sipas Procedurave Bankare të AKP-së të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve.

Periudha raportuese për pasqyrat financiare është prej 1 janar deri më 31 dhjetor 2025. Në këto pasqyra financiare janë paraqitur edhe raportet që paraqesin të dhënat financiare nga data 1 korrik 2003 deri më 31 dhjetor 2025.

Për vitin fiskal 2025 janë gjithsej 28,244 transaksione bankare, prej tyre 27,422 transaksione me palë të jashtme dhe 822 transaksione ndërbankare. Të gjitha këto të kategorizuar si pranime/pagesa në përputhje me regjistrin kontabël.

Agjencia Kosovare e Privatizimit në baza vjetore i raporton Kuvendit të Republikës të Kosovës sipas formatit të raportimit për Agjencitë e Pavarura. Raporti vjetor paraqet të gjitha detajet e aktiviteteve dhe informatave financiare dhe jo financiare për vitin fiskal 2025. Pasqyrat financiare përmbajnë një përmbledhje më të shkurtër të aktiviteteve.

VALUTA RAPORTUESE

Valuta raportuese është Euro. Të gjitha vlerat në pasqyrat financiare janë paraqitur në vlera aktuale e jo në mijëra ('000), përveç nëse është cekur ndryshe në raportin përkatës.

BORDI I DREJTORËVE

Bordi i Drejtorëve është organi më i lartë i Agjencisë dhe ka kompetencë të plotë mbi Agjencinë. Bordi i Drejtorëve mban mbledhje të rregullta mujore në mënyrë që t'i kryej funksionet dhe përgjegjësitë e tij sipas Ligjit.

Bordi i Drejtorëve emërohet nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Bordi i Drejtorëve përbëhet nga tetë (8) anëtarë vendor sipas nenit 8 të Ligjit nr. 06/L -023. Në përputhje me nenin 9 të Ligjit nr. 06/L-023, Bordi i Drejtorëve ka mandat katër (4) vjeçar, i cili fillon nga data e emërimit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës më 6 gusht 2021 emëroi Bordin e Drejtorëve të AKP-së prej tetë (8) anëtarë.

Më 2 gusht 2024 një anëtar i Bordit të Drejtorëve ka dhënë dorëheqje dhe nga kjo periudhë e deri më 6 gusht 2025, Bordi funksionoi me 7 (shtatë) anëtarë. Pas 6 gushtit 2025, pesë (5) anëtarëve të emëruar më 6 gusht 2021 u përfundoi mandati dhe, **sipas Ligjit nr. 06/L-023, Bordi nuk kishte më kuorum për mbajtjen e mbledhjeve**.

Më 13 gusht 2025 Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve dha dorëheqje dhe aktualisht me mandat aktiv ka mbetur vetëm një (1) anëtar deri më 12 korrik 2027.

MENAXHMENTI I AKP-SË

Në përputhje me nenin 16 të Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë, Menaxhmenti i AKP-së përbëhet nga:

- Drejtori Ekzekutiv, i emëruar z. Burim Leci, në cilësinë e Ushtruesit të Detyrës (U.D.);
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Operativë, i emëruar z. Petrit Ibraj, në cilësinë e U.D., meqenëse z. Burim Leci është emëruar U.D. në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv; dhe
- Zëvendësdrejtori Ekzekutiv për Funksione të Përgjithshme, i emëruar z. Ibrahim Gjylderen.

Më 30 shtator 2024, Bordi i Drejtorëve të AKP-së pranoi dorëheqjen e z. Arben Limani, Drejtor Ekzekutiv, me efekt nga data 21 nëntor 2024. Nga data 22 nëntor 2024 deri më 6 korrik 2025, në pozitën e Drejtorit Ekzekutiv ishte emëruar z. Ibrahim Gjylderen, në cilësinë e U.D.

Nga data 7 korrik 2025, me vendim të Bordit të Drejtorëve, është emëruar z. Burim Leci në cilësinë e U.D. Drejtor Ekzekutiv.


DATA E AUTORIZIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE

Pasqyrat Financiare të fondeve në mirëbesim janë autorizuar për lëshim me datën e deklaratës të nënshkruar nga: Burim Leci, u.d. Drejtor Ekzekutiv dhe Adem Selishta - Drejtor i Financave dhe Buxhetit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

IV. TË HYRAT DHE PRANIMET NË LLOGARITË BANKARE

2. TË HYRAT NGA SHITJA

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	2025 vs 2024	2025 vs 2023
Shitja e aseteve me tender	16,123,308	7,982,505	1,769,938	102%	811%
Pranimet nga shpronësimet	1,023,750	9,245,840	3,152,811	(89)%	(68)%
Shitja Direkte e Aseteve	2,608,267	130,950	445,658	1892%	485%
Shitja e Banesave	5,391	11,626	40,403	(54)%	(87)%
GJITHSEJ	**19,760,716**	**17,370,921**	**5,408,810**	**14%**	**265%**




Në tabelën në anën e majtë, **paraqiten bilancet e hyrjeve/daljeve në llogaritë bankare të NSH-ve** përkatëse për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2025.

1. **Shitjet e aseteve me tender –** janë asetet e tenderuar gjatë valëve të privatizimit.
2. **Pranimet nga shpronësimeve -** asetet që janë shpronësuar dhe atyre që janë në proces nga ana e Qeverisë së Kosovës.
3. **Shitjet Direkte e Aseteve** - në përputhje me paragrafin 1.4 të nenit 18 të shtojcës të Ligjit bazik nr. 04/L-034 dhe rregullores për "Shqyrtimin e Aseteve me Karakter Specifik dhe Shitja e tyre me Negocim Direkt", AKP ka filluar procesin e shitjes përmes kësaj metode. Këto rregulla përcaktojnë të drejtat dhe obligimet se si kategorizohen asetet si "asete me karakter specifik" dhe procedurat lidhur me aplikimin e atyre që kanë të drejtën për blerjen e aseteve me karakter specifik.
4. **Të hyra nga bartja e së drejtës banesore** janë pagesat nga bartja e të drejtës banesore të Ndërmarrjeve Shoqërore. Këto pagesa realizohen në përputhje me Ligjin nr. 04/L-061 për Shitjen e Banesave dhe Ligjin nr. 04/L-247 për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-061.

2.1. SHITJET E ASETEVE PËRMES VALËVE TË PRIVATIZIMIT

Grafiku Raporti pranime pagesa vs kontrata të nënshkruara



Dinamika e raporti të pagesave të pranuara dhe realizimin/nënshkrimin e kontratave

	VLERA E KONTRATAVE TË NËNSHKRUARA		
Pranimet	**2025**	**2024**	**2023**
Pranimet gjatë vitit 2020	-	-	-
Pranimet gjatë vitit 2021	-	-	-
Pranimet gjatë vitit 2022	-	-	109,555
Pranimet gjatë vitit 2023	-	462,300	1,304,137
Pranimet gjatë vitit 2024	1,620,233	6,345,772	-
Pranimet gjatë vitit 2025	16,143,308	-	-
GJITHSEJ	**17,763,541**	**6,808,072**	**1,413,692**

Në *grafikun* në anën e majtë janë paraqitur të dhënat dhe krahasimet për tre vitet e fundit sa i përket pagesave të pranuara dhe vlera e të cilave janë nënshkruar kontratat brenda atij viti për shitjen e aseteve përmes valëve të privatizimit dhe shitje të aseteve të paluajtshme.

Siç vërehet, për vitin 2025, për shitjen e aseteve përmes valës të privatizimit, bilanci i pranimeve/pagesave është në vlerën totale prej EUR 16,123,308, prej të cilave:
- kemi pranuar pagesa totale prej EUR **16,143,308** për shitje të aseteve të valës 67, 69 deri 74 të tenderuara gjatë periudhës mars 2025 – korrik 2025
- si kemi kthim të depozitit prej (EUR 20,000) si rezultat i anulimit të një shitjeje;

Duke shtuar pagesat e vitit 2024 prej EUR 1,620,233 dhe pagesave të pranuara prej EUR 16,143,308 (shih më lartë) vlera totale e kontratave të nënshkruara – shitje të realizuara është **EUR 17,763,541.**
Kontratat e realizuara janë për valët 67, 68 deri 74 të valëve të privatizimit.

Në tabelën në anën e majtë, janë të shpalosura vitet e pranimeve të pagesa për vlerën e kontratave të nënshkruara/përfunduara për shitjen e aseteve.

2.2. PRANIMET E MJETEVE NGA QEVERIA PËR SHPRONËSIMIN E ASETEVE

Ndërmarrjet Shoqërore	Vlera	Komente
PRZ014 – IGK Ballkan	1,023,750	Vlera totale e shpronësimit prej EUR 14,235,512 (vlera e shpronësimit EUR 2,110,040 dhe vlera e investimit EUR 12,125,472). Nga vlera e shpronësuar, kërkesat për pagesë në tërësi janë EUR 6,942,102.40 për 20%, kërkesa kreditore dhe kosto të likuidimit. Vlera e paguar prej EUR 1,023,750 është 25% e këstit të kërkesave kreditore prej EUR 4,095,000.
GJITHSEJ	**1,023,750**	

2.3. SHITJA DIREKTE E ASETEVE

	A	B	C	D	D	E=∑(A:D)
	Kontrata të nënshkruara				Pagesa në proces	Pagesa të pranuara në total
Përshkrimi	2025	2024	2023	2019-2022		
Pranimet gjatë vitit 2018	-	-	-	412,945	-	412,945
Pranimet gjatë vitit 2019	-	-	-	2,907,814	-	2,907,814
Pranimet gjatë vitit 2020	-	-	71,157	5,960,362	-	6,031,519
Pranimet gjatë vitit 2021	1,400	-	1,728	1,277,734	27,500	1,308,372
Pranimet gjatë vitit 2022	-	-	19,240	11,180	-	30,420
Pranimet gjatë vitit 2023	15,500	13,814	416,045	-	300	445,659
Pranimet gjatë vitit 2024	17,800	109,247	-	-	3,902	130,949
Pranimet gjatë vitit 2025	2,206,667	-	-	-	401,600	2,608,267
GJITHSEJ	**2,241,367**	**123,061**	**508,170**	**10,570,035**	**433,302**	**13,875,945**

Tabela e paraqitur më lartë paraqet dinamikën e pagesave të pranuara dhe kontratave të nënshkruara dhe rastet që janë ende në proces.

Gjatë vitit 2025 janë nënshkruar 56 kontrata të shitjes në vlerën totale prej EUR 2,241,367 duke përfshirë procesin e iniciuar në vitet paraprake deri më tani.

3. TË HYRAT E REALIZUARA NGA QIRATË

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	2025 vs 2024	2025 vs 2023	2003 deri 31 dhjetor 2025
Qiratë në llogaritë e NSH-ve në tranzicion	361,905	414,818	418,933	(12.76)%	(13.61)%	**17,740,773**
Qiratë në llogaritë e NSH-ve në likuidim	5,739,904	5,105,126	4,891,948	12.43%	17.33%	**51,641,646**
Qiratë nga komercializimi	-	-	-	0.00%	0.00%	**5,021,318**
GJITHSEJ	**6,101,809**	**5,519,944**	**5,310,881**	**10.54%**	**14.89%**	**74,403,737**

Në përgjithësi, dhënia e aseteve me qira të NSH-ve janë: lokalet, toka bujqësore, pikat e shitjes të derivateve, depot dhe të tjera.

- **Qiratë e NSH-ve në tranzicion** janë për periudhën para se NSH të hyjë në likuidim;
- **Qiratë në llogaritë e NSH-ve në likuidim** janë gjatë periudhës për NSH-të për të cilat janë në proces të likuidimit; dhe
- **Qiratë nga NSH e komercializuar -** Në këtë pozicion janë të paraqitura bilancet e pranimeve për kontratat e periudhës sa NSH ka qenë e komercializuar dhe të nënshkruara gjatë vitit 2000 nga UNMIK. Vlera e tërësishme e inkasimeve, nga viti 2003 deri në datën raportuese është EUR 5,021,319. Nga data 16 qershor 2012, AKP-ja nuk ka realizuar qira përmes metodës të komercializimit, sepse këto asete të NSH-ve ose janë shitur ose janë në proces të likuidimit.

Në krahasim me vitin 2024, kemi rritje prej 10.54% të të hyrave të qirave. Po ashtu, në krahasim me vitin 2023 rritja është me 14.89%. Një nga arsyet e rritjes së inkasimeve të qirasë gjatë vitit 2025 është se gjatë këtij viti janë nënshkruar kontrata të reja të qirasë përmes qiradhënies të aseteve përmes tenderit publik, si dhe si rezultat i rivlerësimit të çmimeve të qirave aktuale që ka rezultuar me inkasim më të lartë.

Po ashtu, meqenëse nuk janë pjesë e shënimeve tabelare më lartë, për shpalosje paraqesim edhe inkasimin e mjeteve në bankat komerciale që administrohen direkt nga Menaxhmenti i ndërmarrjeve përkatëse e ato janë:

- **Inkasimi nga qirate per NSH Jatex eshte ne vlere prej 281,578.73; dhe**
- **Inkasimi nga qirasë per NSH Brezovica eshte ne vlere prej 75,601.58**

Ndërsa, më poshtë janë paraqitur ndarazi tabelat e të hyrave të qirave për NSH në tranzicion dhe ato në likuidim për të cilat janë shënimet tabelare për të gjitha llogaritë bankare në Bankën Qendrore të Kosovës. Në tabela janë listuar disa NSH me të hyra të mëdha

3.1. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË TRANZICION

PËRSHKRIMI	2025	2024	2023	2025 Vs % 2024	2025 Vs % 2023	KOMENTE PËR DISA NSH QË KANË AKTIVITET TË LARTË TË QIRADHËNIES
NSH Metaliku	173,260	196,106	143,593	-11.65%	20.66%	Rivlerësime të qirasë dhe pagesa retroaktive në vitin 2024
Metaliku Fab e Eneve	164,568	210,131	242,676	-21.68%	-32.19%	Riprogramime dhe pagesa të borxheve në vitin 2024
NSH Liria	4,620	4,681	8,400	-1.30%	-45.00%	Inkasim i rregulltë i qirasë
NSh Trepça	8,523	7,423	7,423	14.82%	14.82%	Inkasim i rregulltë i qirasë
NSh Trepça Standard	8,750	8,976	-	-2.52%	100.00%	Inkasim i rregulltë i qirasë
NSH Jedinsvko	-	(14,683)	14,657	-100.00%	-100.00%	Bartje e mjeteve (përfshirë interesin) në llogari të likuidimit të NSH-së
NSH tjera Tranzicion	2,184	2,184	2,184	0.00%	0.00%	Inkasim i rregulltë i qirasë
GJITHSEJ	**361,905**	**414,818**	**418,933**	**(12.76)%**	**(13.61)%**	

Në krahasim me vitin 2024, zvogëlimi prej 12.76% është për shkak se gjatë vitit 2024 ishin bërë inasime të mëdha për shkak të ri-vlerësimit të qirave me efekt retroaktiv si dhe pagesa të borxheve. Të gjitha për borxhet dhe rivlerësime para vitit 2024. Po ashtu është edhe inkasimi i borxhit gjatë vitit 2023-2024 përmes përmbaruesit privat për NSH Jedinsvko.

3.2. QIRAJA E INKASUAR PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE NË LIKUIDIM

PËRSHKRIMI	2025	2024	2023	2025 Vs % 2024	2025 Vs % 2023	KOMENTE PËR DISA NSH QË KANË AKTIVITET TË LARTË TË QIRADHËNIES
Tregu	1,025,494	957,432	790,505	7.11%	29.73%	Inkasim i borxhit të vjetër, shtim i kontratave të qirasë
INA-TRGOVINA	883,947	752,127	881,328	17.53%	0.30%	Inkasim i borxhit borxheve të periudhave paraprake
Jugopetrol	735,080	722,117	707,904	1.80%	3.84%	Inkasim i rregulltë i qirasë
NewCo Grand Hotel	655,201	645,803	766,624	1.46%	-14.53%	Inkasim i rregulltë i qirasë, ndërsa në vitin 2023 kemi pagesa retroaktive të rivlerësimit të qirave
Perparimi	184,091	107,218	93,121	71.70%	97.69%	Qira të reja
Bankkos	122,694	125,572	66,261	-2.29%	85.17%	Qira të reja në fillim viti 2024
Rilindja Treg. Librare	97,363	96,183	89,988	1.23%	8.20%	Inkasim i rregulltë i qirasë

Ereniku.Prodh.Prim.	95,628	63,960	31,387	49.51%	204.67%	Qira të reja dhe rivlerësime të qirave paraprake
Auto Prishtina	88,988	114,824	103,729	-22.50%	-14.21%	Inkasim borxhi gjatë vitit 2024
Lux	86,812	83,782	112,322	3.62%	-22.71%	Ndërprerje të kontratave të qirave për shkak të shitjeve të aseteve
RTP	82,846	95,266	68,144	-13.04%	21.57%	Inkasim borxhi gjatë vitit 2024
Ereniku - Virgjinia	72,781	56,174	41,092	29.56%	77.12%	Qira të reja dhe inkasime të borxheve të periudhave paraprake
BANKA E VOJVODINES	70,045	59,269	54,057	18.18%	29.58%	Inkasim i borxhit borxheve të periudhave paraprake
K.B. Kosova	63,864	10,070	8,839	534.20%	622.53%	Qira të reja
Bauxite Mine Volljak	62,140	33,145	20,701	87.48%	200.18%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Lavërtari Blegtori	56,306	37,710	33,629	49.31%	67.43%	Qira të reja
Germia	55,355	41,785	42,085	32.48%	31.53%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Jugobanka	53,041	48,964	27,820	8.33%	90.66%	Qira të reja nga lirimi i aseteve në veri qira e re e ndërtesës të admin.
Urata	50,163	46,794	62,726	7.20%	-20.03%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake dhe se gjatë vitit 2023 kemi shitje të asetit
Përparimi - Podujevë	49,103	44,504	28,894	10.33%	69.94%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Magjistrala	46,162	37,689	43,982	22.48%	4.96%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Izolimi	44,971	33,423	51,749	34.55%	-13.10%	Qira të reja
Simpo	43,121	43,343	33,556	-0.51%	28.50%	Rivlerësime të qirave në fillim të vitit 2024
K.B. Bujqesia	42,539	32,730	25,626	29.97%	66.00%	Qira të reja
Amortizatorët	40,726	-	-	100.00%	100.00%	Qira të reja
Auto-Moto e KS	36,999	42,373	-	-12.68%	100.00%	Shkëputje e kontratave të qirasë pas shitjes së aseteve
Ratar - Laplje Selo	36,408	50,570	54,129	-28.00%	-32.74%	Shkëputje e kontratave të qirasë pas shitjes së aseteve
Farmakos	34,166	16,535	25,052	106.63%	36.38%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
K.B Agroprodukti	33,643	6,355	-	429.39%	100.00%	Qira të reja në (1 kontratë nëfund të vitit 2024) dhe dy gjatë vitit 2025
Elan	32,965	6,829	12,261	382.72%	168.86%	Qira të reja dhe inkasim borxhi i periudhave paraprake
K.B. Drenica	32,311	23,075	22,909	40.03%	41.04%	Qira të reja dhe inkasim borxhi i periudhave paraprake
Shpezëtaria	30,000	-	4,000	100.00%	650.00%	Inkasim i borxhit (përfshirë obligime të bartura nga vitet paraprake)
Sharrprodhimi	28,737	28,854	39,073	-0.41%	-26.45%	Inkasim i rregulltë i qirasë, ndërsa në vitin 2023 inkasime të borxheve
AGROBISERNICA	26,160	26,160	26,160	0.00%	0.00%	Inkasim i rregulltë i qirasë
Barnatoret Prishtinë	25,093	15,534	35,979	61.54%	-30.26%	Inkasim i borxhit retroaktiv (2023), inkasim i rregullt i qirasë mujore
Duhani	24,807	24,802	24,807	0.02%	0.00%	Inkasim i rregulltë i qirasë
DUNAV	24,266	23,340	36,985	3.97%	-34.39%	Inkasim i borxhit retroaktiv (2023), inkasim i rregullt i qirasë mujore
Branka Dinic (Aset)	23,172	23,154	-	0.08%	100.00%	Qira të reja nga viti 2024 dhe inkasim i rregullte i qirasë
Ereniku - Industrija	22,375	22,700	19,645	-1.43%	13.90%	Inkasim i rregulltë i qirasë
Tregjet	21,711	19,218	15,340	12.97%	41.53%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Ramiz Sadiku	16,944	13,088	11,511	29.46%	47.20%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Univerzal	16,455	12,141	11,196	35.53%	46.97%	Qira të reja
F.R.S.K Jugoterm	16,380	16,199	16,035	1.12%	2.15%	Inkasim i rregulltë i qirasë
Unimont	16,299	12,500	-	30.39%	100.00%	Qira të reja
Viktoria	15,058	13,673	19,094	10.13%	-21.14%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake

D.T.P. Mladost	14,653	14,443	14,388	1.45%	1.84%	Inkasim i rregulltë i qirasë
Emin Duraku	14,392	9,403	6,432	53.06%	123.76%	Qira të reja
Liria	12,701	23,663	29,600	-46.33%	-57.09%	Ndërprerje e qiradhënies për shkak të shpronësimit
Agrodukagjini	12,325	10,316	9,825	19.47%	25.45%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
FAM	12,012	8,008	-	50.00%	100.00%	Qiraja e nënshkruar në maj 2024
KB Rogova	11,960	1,672	-	615.31%	100.00%	Qira të reja
IGK Ballkan	10,935	10,935	10,289	0.00%	6.28%	Inkasim i rregulltë i qirasë
Zadruga Shterpce	10,889	6,155	5,192	76.91%	109.73%	Qira të reja
Deva	10,647	2,129	1,103	400.09%	865.28%	Qira të reja
Agrokultura	10,409	18,042	5,079	-42.31%	104.94%	Në vitet paraprake inkasim borxhi dhe shitje aseti
Zhupa Reqane Prizren	10,350	9,370	8,907	10.46%	16.20%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Plantacioni i Pemeve	10,218	2,231	1,756	358.00%	481.89%	Qira të reja dhe rivlerësime të qirave aktuale
Kosovarja	10,168	1,495	1,440	580.13%	606.11%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
Fabrika e Birrës	10,116	9,695	9,054	4.34%	11.73%	Inkasim i borxheve të periudhave paraprake
NSH tjera në likuidim	**255,719**	**290,585**	**228,638**	-12.00%	11.84%	
GJITHSEJ	**5,739,904**	**5,105,126**	**4,891,948**	**12.43%**	**17.33%**	

4. INTERESI I FITUAR

Viti	Interesi i fituar në llogari rrjedhëse	Interesi i fituar në afatizime (depozita kohor)	GJITHSEJ
2003	35,790	-	35,790
2004	228,337	-	228,337
2005	631,651	-	631,651
2006	3,898,373	-	3,898,373
2007	9,175,729	-	9,175,729
2008	11,585,047	-	11,585,047
2009	1,295,862	-	1,295,862
2010	342,621	308,730	651,351
2011	290,869	4,394,852	4,685,721
2012	126,734	2,380,145	2,506,879
2013	-	-	-
2014	-	144,960	144,960
2015	-	5,000	5,000
2016-2022	-	-	-
2023	312,448	-	312,448
2024	517,127	-	517,127
2025	555,712	-	555,712
GJITHSEJ	**28,996,300**	**7,233,687**	**36,229,987**

Të hyrat nga interesi janë:

- interesi i fituar nga llogaritë rrjedhëse në Bankën Qendrore të Kosovës. Për informatën e juaj, nga Korrik 2012 deri më 31 dhjetor 2022, norma e aplikuar e interesit nga BQK është **zero%. Ndërsa duke filluar nga muaji janar 2023 deri më 31 korrik 2023, BQK ka filluar me aplikimin e normës të interesit vjetor prej +0.15% në llogaritë rrjedhëse të ndërmarrjeve shoqërore dhe të Agjencisë të cilat mbahen në BQK. Nga muaji gusht 2023, norma e interesit vjetor është +0.30% Shuma e prezantuar përbën të hyrat e interesit për të gjitha llogaritë bankare që kanë gjendje bankare, me gjithsej 532 llogari bankare;**
- interesi bankar i fituar nga afatizimi për periudhat nga 1 muaj deri në 12 muaj i një pjese të mjeteve nga llogaritë bankare të fondeve në mirëbesim. Nga Korriku i vitit 2015 nuk ka të hyra nga interesi, meqenëse BQK nuk ka dërguar oferta për depozita kohor.

Gjithsej interesi i përgjithshëm i fituar nga viti 2003 deri në datën raportuese është **EUR 36,229,987.** Ndërsa pë`r vitin 2025 është inkasuar vetëm interesi në llogari rrjedhëse prej EUR 555,712 për gjendjen e llogarive bankare për periudhën dhjetor 2023 – nëntor 2025.

Sipas nenit 19B të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115 dhe me ligjin nr. 05/L-080 është paraparë që fondet tepricë, fondet e mbetura dhe fondet e përkohshme, të gjitha të ardhurat e mbledhura nga Agjencia që mbahen në mirëbesim mund të investohen në instrumentet në vijim:

- Llogari rrjedhëse që paguan interes apo depozitë të afatizuar në Bankën Qendrore të Kosovës; dhe
- Letra me vlerë të borxhit të emetuara nga ndonjë autoritet publik i Republikës së Kosovës ose të garantuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

5. TË HYRAT NGA TARIFA DHE KONFISKIMET E BID DEPOZITAVE NË TENDERËT E SHITJES

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar	**9,188,165**
Tarifa për pjesëmarrje në tender	47,602
Kthimet e tarifës administrative/anulim tenderi apo raste tjera	(2,400)
Konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve	53,800
Gjithsej të hyrat gjatë vitit në llogari për AKP	**99,002**
Gjendja më 31 dhjetor	**9,287,167**

Janë të hyra të realizuara për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Këto të hyra përfshijnë të hyra nga tarifat për paraqitjen e tenderëve dhe **konfiskimin e BID depozitave të ofertuesve, të cilët nuk i kanë përmbushur kushtet e pagesës**. Këto të hyra inkasohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Tarifa për dorëzimin e ofertave të privatizimit;
- Tarifa për dorëzimin e ofertave të likuidimit; dhe
- Fondi Rezervë i AKP-së.

Këto të hyra janë inkasimet me nga EUR 200.00 për dorëzimin e ofertave të likuidimit dhe konfiskimit të depozitave, por që nuk janë alokuar në tërësi në llogari të tarifës administrative për shkak të mbylljes të vitit fiskal dhe nevojës për likuiditet bankar në këto llogari. Në ndërlidhje shih dhe shënimin nr. 15.

6. BID DEPOZITAT PËR PJESËMARRJE NË TENDER

PËRSHKRIMI	SHUMA
Gjendja më 1 janar	**330,000**
BID Depozitat e paguara nga ofertuesit për tender	2,963,000
Kthimi i BID Depozitave ndaj Ofertuesve të pasuksesshëm	(2,738,700)
Bartje e BID dep. në llogari të NSh-ve (nënshkrimi i kontratave)	(554,300)
Gjithsej bilanci i pranimeve gjatë vitit	**(330,000)**
Gjendja më 31 dhjetor	**0.00**

Janë të hyra nga BID depozitat e ofertuesve që kanë marrë pjesë në tender (vlera EUR 200.00)dhe për të cilët ende nuk ka përfunduar procesi i shitjes. Me përfundim të procesit të shitjes, bilanci bankar do të jetë zero, sepse me nënshkrimin e kontratave, këto mjete si BID depozita, si pjesë e vlerës së blerjes, transferohen në llogari të NSh-ve përkatëse, për të cilat janë shituar asetet. Ofertuesve të pasukseshsëm ju kthehen mjetet/depozitat. Këto të hyra gjenerohen në llogaritë bankare, të cilat AKP, më përpara i ka hapur për qëllime të mbarëvajtjes të aktiviteteve operacionale dhe procedurale. Llogaritë janë si më poshtë:

- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të privatizimit;
- Llogaritë e BID depozitave të ofertës të likuidimit;

7. TË HYRA TJERA

PËRSHKRIMI	2025	2024	2023	2025 vs % 2024	2025 vs % 2023
Gjendja më 1 janar	7,728,755	7,547,328	7,782,768		
Inkasimet ditore në para të gatshme nga aktiviteti për NSH Tregu	-	-	-	0.00%	0.00%
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSH ABC Genci	-	22,184	33,048	(100.00)%	(100.00)%
Inkasimet ditore në para të gatshme për NSH Grand Hotel	214,652	159,243	108,065	34.80%	98.63%
Inkasimet nga llogari komerciale pasi që NSH ka hyrë në likuidim	-	-	-	0.00%	0.00%
Pranimet nga debitorët e NSh	-	-	-	0.00%	0.00%
Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh	-	-	-	0.00%	0.00%
Nga përmbarimi i lëndës, borxhe të papaguara për aktivitetin e NSH	-	-	-	0.00%	0.00%
Bartje e mjeteve/shitja e aksioneve për KEK, Kosovatrans dhe Enti për Pylltari	-	-	(249,318)	0.00%	(100.00)%
Bartje e mjeteve nga aktivitetet e Trepcës dhe "Rad Belgrade"	-	-	(127,385)	0.00%	(100.00)%
Të tjera	-	-	150	100.00%	0.00%
Gjithsej për periudhën	**214,652**	**181,427**	**(235,440)**	**18.31%**	**(191.17)%**
Gjendja më 31 dhjetor	**7,943,407**	**7,728,755**	**7,547,328**		

Tabela më lartë paraqet gjendjen e inkasimeve nga viti 2003, për vitin aktual si dhe gjendjen me 31 dhjetor 2025.

Të hyrat tjera përfshijnë

- **Inkasimet ditore –** para të gatshme në të mirë të llogarive të NSH-ve përkatëse kanë të bëjnë me mjetet që pranohen gjatë aktivitetit ditor për të hyrat si: bifet në kuadër të NSH, shitja e biletave, shërbimeve apo të tjera tek NSH të tilla si ABC Genci, NSH Grand Hotel si dhe NSH Tregu. ABC Genci, Grand dhe Tregu janë në likuidim, llogaritë e të cilave i menaxhon dhe administron;
- Marrëveshje për shfrytëzimin e minierave të Mim Golesh;
- Shitja e mallrave dhe shërbimeve;
- *Dividenta dhe shitja e aksioneve Gjatë vitit 2023 janë bartur mjetet nga shitja e aksioneve si rezultat i likuidimit të entitetit juridik "Kosova Insurance". Prcedurat e likuidimit të këtij entiteti janë kryer nga likuidatori i BQK-së;
- Transferimi i mjeteve nga llogaritë bankare të NSH-ve të cilat kanë qenë aktive dhe kanë pasur mjete në llogaritë e bankave komerciale; dhe
- NSH-të e paraqitur si kreditor për pretendimet e saj (Debitorët e NSH-ve);

Shpalosje detaje lidhur me Dividentën dhe shitjen e aksioneve

7.1 Bartje e mjeteve/shitja e aksioneve për KEK, Kosovatrans dhe Enti për Pylltari

Më 16 prill 2010, AKP kishte pranuar mjetet prej EUR 923,650 nga procesi i likuidimit të entitetit juridik "Kosova Insurance Company". Mjetet prej EUR 923,650 ishin paguar në emër të aksionarëve – ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet publike. Likuidatori kishte dërguar një listë të ndërmarrjeve si aksionar të entitetit juridik "Kosova Insurance Company". Përveç listës, Likuidatori kishte dërguar edhe pasqyrën e të ardhurave dhe bartjen e mjeteve në një llogari të AKP-së të hapur enkas për pranimin e kësaj vlere. Mjetet prej EUR 923,650 janë shpërndarë sipas numrit të aksioneve që janë prezantuar në listën e ndërmarrjeve shoqërore dhe ndërmarrjeve publike. Për pjesën e ndërmarrjeve shoqërore, mjetet janë bartur në llogari përkatëse të NSH-ve. Ndërsa, për ndërmarrjen publike "KEK", Enti për Pylltari dhe Kosovatrans Gjakovë, mjete janë bartur në llogari kryesore të Thesarit.

Shuma prej totale prej EUR 937,435.94 (përfshirë interesin e gjeneruar në llogari) janë bartur si në vijim:

1. Në llogarinë kryesore të **Thesarit janë bartur EUR 249,318.07**; ndërsa
2. Mjetet që janë bartur në llogaritë e NSH-ve (brenda llogarive) janë EUR 696,428.47; dhe

7.2 Bartje e mjeteve nga aktivitetet e Trepcës dhe "Rad Belgrade"

Më datën 28 dhjetor 2006, ish AKM ka pranuar mjete prej EUR 117,068.38 në llogari bankare "UNI Projekt" me qëllimin e kryerjes të aktivitetet e një kompanie ndërkombëtare për shërbimet që janë dhënë nga Trepca. Ndërsa më datën 12 dhjetor 2005, ish AKP ka pranuar prej EUR 1,450 si rezultat i përdorimit të vinçave të Kompanisë Rad Belgrade në komunat në veri të Kosovës.

Mjetet janë bartur me gjendjen aktuale bankare duke përfshirë interesin e gjeneruar bankar për "Uni Projekt" në total EUR 125,877.56 dhe "Rad Belgrade" në total EUR 1,506.60.

8. KAPITALI THEMELTAR I AGJENCISË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Në përputhje me nenin 17 të ligjit nr. 04/L-034, Agjencia ka hapur llogarinë bankare për kapitalin themeltar. Gjithsej vlera e kapitalit themeltar është EUR 10 milion, ndërsa shuma e transferuar nga Qeveria është EUR 1 milion. Pjesa e mbetur prej EUR 9 milion mund të kërkohet nga Bordi i Drejtorëve të AKP-së në kohën dhe në shumën e nevojshme për përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë.

Më poshtë janë të paraqitura detajet e kapitalit themeltar për të gjitha transaksionet nga viti 2003 deri në **datën raportuese:**

- **Të hyrat në llogarinë e kapitalit prej EUR 1,139,351**
  - Të hyra nga pagesa e kapitalit themeltar prej EUR 1,013,200. Pagesa është realizuar nga Qeveria e Kosovës. Pagesa e kapitalit është bërë më 2 dhjetor 2003;
  - Të hyrat nga interesi prej EUR 126,151. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 4.*
- **Pagesat nga llogaria e kapitalit prej EUR 237,389**
  - Pagesat e vendimeve të Gjykatave prej EUR 237,380. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 14.*
  - Shpenzimet bankare prej EUR 9. *Janë pjesë përbërëse e shënimit shpjegues nr. 16*
- **Gjendja bankare në fund të periudhës 901,962**

V. SHPENZIMET/SHPËRNDARJA

9. 20% I PUNËTORËVE TË TRANSFERUARA NË BSPK

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	2003 31 dhjetor 2025
Llogari të privatizimit	-	-	-	76,621,084
Llogari të likuidimit	5,821,444	3,101,446	1,005,929	44,004,520
Llogari në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve	1,094	343,926	2,223,748	52,099,417
GJITHSEJ	**5,822,538**	**3,445,372**	**3,229,677**	**172,725,021**

Për periudhën raportuese, shuma prej EUR 5,822,538 është shpërndarë nga 43 ndërmarrje Shoqërore dhe janë gjithsej 7,566 punëtorë që ka përfituar nga kjo shpërndarje.

Ndërsa nga tërë procesi i shpërndarjes gjatë viteve 2003-2025 kanë përfituar gjithsej 52,187 punëtorë.

Vlerat e prezantuara në tabelën e paraqitur më lartë janë mjete që janë transferuar në llogari të BSPK për 20% e punëtorëve përmes llogarive:

- Llogarive të privatizimit - 20% nga shitja përmes privatizimit të ndërmarrjeve të reja të ndodhura kohë më parë;
- Llogarive të likuidimit - 20% nga shitja e aseteve të mbetura përmes likuidimit;
- Llogarive të likuidimit – mjete të pranuara sipas marrëveshjeve për shpronësimin e aseteve nga Qeveria dhe institucionet relevante; dhe
- **Llogarive në mirëbesim për punëtorët** e NSH-ve – mjete të mbajtura në mirëbesim vetëm për rastet që ka ankesa gjyqësore për listat e shpërndarjes.

LLOGARITË NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT E NSH-ve janë llogari bankare që janë hapur në Bankën Qendrore të Kosovës dhe administrohen nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Këto llogari bankare për NSH-të përkatëse janë hapur për qëllim të mbajtjes të parave në mirëbesim në emër të punëtorëve vetëm për rastet kur ka ankesa kundrejt listave për shpërndarje. Pjesa e pa transferuar e 20%-it vetëm për rastet që ka ankesa mbahen në mirëbesim dhe shpërndahen nga këto llogari me aprovimin final të listave të punëtorëve nga Gjykata. Gjendja e mjeteve në llogarit bankare në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve është EUR 4,284,951 sipas datës 31 dhjetor 2025. Me shqyrtimin e kërkesave të 20% nga Gjykata, do të bëhet shpërndarja e tyre.

10. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE (OSHP) PËR LIKUIDIMIN E NSH-ve

Raporti i pagesave nëpër vite ndaj Ofruesve të Shërbimeve Profesionale

	1	2	3	4=1+2+3	5	6=4+5
	KONTRATA BAZË		ANEKS KONTRATA	Gjithsej Deloitte	Curtis	Gjithsej
VITET	FIKSE	VARIABILE	FIKSE		Fikse	
2012-2018	4,924,740	9,084,190	1,992,000	16,000,930	-	16,000,930
2019	-	-	-	-	136,309	136,309
2020	-	-	-	-	480,868	480,868
2021	-	-	-	-	358,250	358,250
2022	-	-	-	-	429,900	429,900
2023	-	-	-	-	499,800	499,800
2024	-	-	-	-	499,800	499,800
2025	-	-	-	-	541,650	541,650
GJITHSEJ	**4,924,740**	**9,084,190**	**1,992,000**	**16,000,930**	**2,946,577**	**18,947,507**

Raporti i pagesave sipas kontratave ndaj Ofruesve të Shërbimeve profesionale

Kontraktori	Lloji i pagesave	Vlera e kontraktuar	Pagesa	% e pagesave
Deloitte	Kontrata bazë - variabile	13,003,564	9,084,190	70%
	Kontrata bazë fikse	4,924,740	4,924,740	100%
	Aneks kontrata fikse	1,992,000	1,992,000	100%
Curtis	Kontrata bazë	2,499,900	2,196,677	88%
Curtis	Kontrata bazë fikse+10% aneks	249,000	249,900	100%
Curtis	Kontrata bazë **e re**	1,800,000	500,000	28%
	GJITHSEJ	**24,469,204**	**18,947,507**	**77%**

1. Pagesat ndaj Deloitte

Nga viti 2012 si ofrues i shërbimeve profesionale ka qenë i angazhuar "Deloitte Central Europe Limited" nëpërmjet kontratës bazë 11 korrik 2012 – 9 korrik 2016 dhe aneks kontratës 8 gusht 2016 – 7 gusht 2018. Kontrata bazë ishte EUR 19.9 milion (13+4) dhe aneks kontrata prej EUR 1.9 milion.

Pagesat variabile – janë pagesa të realizuara për secilin vendim të aprovuara/refuzuara të kërkesave të kreditorëve ndaj NSH-ve.

Pagesat fikse janë pagesa ndaj OSHP-së për kryerjen e shërbimeve sipas kushteve të kontraktuara. Pagesat fikse janë aplikuar në tri kontrata: kontratën bazë me "Deloitte" (pagesa çdo TM); aneks kontratën me "Deloitte" (pagesa mujore); dhe kontratës bazë me "Curtis" (pagesa mujore).

2. Pagesat ndaj KConzorciumit Curtis & Grand Thorton

Me përfundimin e kontratës me "Deloitte", është angazhuar kontraktori tjetër "*"Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C"*. Periudha e angazhimit është pesëvjeçare (5), (korrik 2019 - 30 qershor 2024) në vlerën EUR 2,499,000+10% e kontratës bazë EUR 249,000. Po ashtu, konzorciumi ka fituar periudhën e angazhimit për periudhën janar 2025 – 31 dhjetor 2028 në vlerën totale EUR 1,800,000

10.1 Shënim lidhur me pagesat e Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OSHP):

Në bazë të nenit 20 të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115, me ligjin nr. 05/L-080 dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve:

a) *Tarifa fikse e Autoritetit të Likuidimit paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin e caktimit të saktë të kostos fikse proporcionalisht për secilën ndërmarrje shoqërore në likuidim, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria bankare e ndërmarrjes në likuidim;*

b) *Tarifa variabile (për kërkesat e shqyrtuara) e Autoritetit të Likuidimit dhe kostot tjera të paraqitura në kostot 1.1 dhe 1.3 të nenit 40.1 të shtojcës së ligjit nr. 04/L-034 paguhen nga fondet e ndërmarrjes në likuidim. Në rast se ende nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit, atëherë tarifa variabile paguhet përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim.*

10.2. GARANCIONI BANKAR

Agjencia Kosovare e Privatizimit ka pranuar sigurimin e ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës nga Konzorciumi “Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo, Shkup dhe Grant Thornton L.L.C.”; rr. Rexhep Mala 18, Prishtinë për “Angazhimi i Ofruesit të Shërbimeve Profesionale (OShP) për procesin e likuidimit për të gjitha Ndërmarrjet Shoqërore/Asetet nën administrimin e AKP-së” (me numër të prokurimit: 239-24-9626-2-1-1-/C230).

Detajet e garancionit bankar janë si vijon: data e garancionit është 23 Janar 2025, shuma e garancionit 180,000.00, emri i bankës që ka lëshuar garancionin është Raiffeisen BANK, Prishtinë - Kosovë.

11. MALLRA DHE SHËRBIME

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Pagesat ndaj palëve të jashtme	1,675,594	1,838,927	1,723,563
Kompensimi i tarifës administrative	(106,839)	(46,375)	(62,572)
Gjithsej	**1,568,755**	**1,792,552**	**1,660,991**
Krahasimet ndërmjet vitit 2025 me vitet 2024 dhe 2023	ndryshimi	(223,797)	(92,236)
	%	(12.48)%	(5.55)%

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME 2025	SHUMA
Ofruesit e Shërbimeve dhe pagat e punëtorëve (NSH Liria, Metaliku etj.)	1,125,230
Investimet për rregullimin e hapsirave të NSH Tregu	89,269
Shpenzime për aktivitetit e NSH Grand, furnizime për zyre, pije, rregullime, etj.	3,546
Shër. Prof. - Angazhimi i përmbaruesve/përfaqësime ligjore, vlerësime/ekspertizë	23,290
Qiraja e paguar nga NSH Tregu (për hapësirat e përbashkëta)	18,000
Shërbime për furnizim me filma për ABC Genci	1,152
Shator me qera për arkivën e ndërmarrjeve shoqërore	2,550
Huazim i mjeteve për NSH Inex Sharr	153,830
Ngrohje qendrore (Termokos) për NSH Grand Hotel	65,478
Taksa gjyqësore dhe taksë për Komisionin e Minierave dhe Mineraleve	1,838
Ruajtja e aseteve të NSH Tregu nga shërbimet e Policisë së Kosovës	15,360
Dërgesa postare	5,261
Vizualizim të Pronave dhe termat e referencës për data-bazë	27,900
Barje të arkivave, aboni., vizualizim të pronave dhe furnizime për NSH-të	27,918
Trustet Pensionale dhe tatimet për OSh-të nga tarifa për NSh-të përkatëse	65,279
Shërbime komunale - rryma e paguara nga tarifa administrative	12,092
Furnizim me derivate dhe mirëmbajtja për veturën e NSH Tregu	1,145
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit	7,307
Shpenzimet nga paraja e imët për Zyrat Regjionale	28,549
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës	600
GJITHSEJ	**1,675,594**

Në përgjithësi në këtë kategori përfshihen pagesat për: ofruesit e shërbimeve për NSH në Likuidim dhe Pagat e Punëtorëve – NSH në tranzicion; qiraja, shpenzime për reklamim, shërbime profesionale dhe mirëmbajtja dhe ruajtja e aseteve.

Zvogëlimi i shpenzimeve kundrejt vitit 2024 është si rezultat kryesisht i pagesave për investimet që ishin bërë atë vit për rregullimin e hapsirave për NSH Tregu në vlerën prej EUR 449,614.

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shembull në vitin 2025, shuma prej EUR 106,839 paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si shpenzim (plus) në kategorinë e shërbimeve publike, tatimeve etj. Këto pagesa kanë të bëjnë me shpenzime të NSH-ve të caktuara për të cilat, në mungësë të mjeteve bankare, më herët jane paguar nga tarifa administrative e AKP-së. Ndërsa tani këto mjete janë kthyer në tarifën administrative

PAGESAT NDAJ PALË TË JASHTME

Sa i përket pagesave të realizuara nga fondet në mirëbesim ndaj palëve të jashtme, ato janë paraqitur në tabelën e dytë në anën e majtë. Këto pagesa janë realizuar nga llogaritë e NSH-ve në tranzicion, likuidim dhe tarifa administrative e Agjencisë.

11.1. PAGESAT NDAJ OFRUESVE TË SHËRBIMEVE DHE PAGAT E PUNËTORËVE PËR NSH NË TRANZICION

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE TË REALIZUARA

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	2025 vs 2024	2025 vs 2023
Paga të punëtorëve	39,743	42,497	40,663	(6.48)%	(2.26)%
Ofrues të Shërbimeve si roje	413,521	387,057	432,340	6.84%	(4.35)%
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	671,966	634,081	807,600	5.97%	(16.79)%
GJITHSEJ	**1,125,230**	**1,063,635**	**1,280,603**	**5.79%**	**(12.13)%**

PËRMBLEDHJE E NUMRIT TË OSH-ve TË ANGAZHUAR

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	2025 vs 2024	2025 vs 2023
Pagat ndaj Agrokosova	-	-	-	0.00%	0.00%
Paga të punëtorëve	9	11	12	(18.18)%	(25.00)%
Ofrues të Shërbimeve si roje	103	124	147	(16.94)%	(29.93)%
Ofrues të Shërbimeve për shërbime tjera	149	191	212	(21.99)%	(29.72)%
GJITHSEJ	**261**	**326**	**371**	**(19.94)%**	**(29.65)%**

Numri i OSh-ve prej 261 është numri total i personave që janë angazhuar/paguar gjatë vitit 2025.
Ndërsa gjendja aktive e OSH-ve është gjithsej 231 OSh në total: nga paga të punëtorëve gjithsej 9 punëtorë me paga, 94 janë si roje OSH dhe 128 janë si ofrues për shërbime tjera.

Rritja e shpenzimeve kundrejt vitit 2024 është kryesisht si rredhojë e ndryshimit të nivelit të pagesës për OSH-të e angazhuar. Ndryshimi fillimisht ishte bërë konform vendimit të Qeverisë për pagën minimale, por që pastaj edhe me rregulloren e re të Bordit të Drejtorëve duke iu përshtatur kushteve të punës në tregun e punësimit/angazhimit. Pagesa mesatare për OSH gjatë vitit 2024 ishte EUR 377.70, ndërsa në vitin 2025 është EUR 455.80.

Për dallim nga viti 2024, impakt në zvogëlimin e angazhimit të numrit të përgjithshëm të Ofruesve të Shërbimeve dhe punëtorëve ka qenë ndërprerja e angazhimit të **OSH-ve për më shumë ndërmarrje**. Nga gjithsej 95 ofrues të paguar gjatë vitit 2024, ky numër gjatë vitit 2025 ka

qenë në total 59 dhe shpenzimet për pagesën e tyre janë zvogëluar për 5.14% në krahasim me vitin paraprak. E njëtja vlen edhe në krahasim me vitin 2023. Në tabelën e mëposhtme janë detajet.

Angazhimi i ofruesve të shërbimeve bëhet në përputhje me rregulloren për angazhimin e OSH-ve. Përveç rregullores, për rastet e NSH-ve në likuidim, këto shpenzime janë të lejuara sipas kornizës buxhetore të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve. Gjithsesi, vlen të theksohet se përveç kornizës buxhetore të llojeve të shpenzimeve të lejuara, me aprovim të Bordit caktohet edhe kufiri maksimal i shumës së buxhetuar. Sipas procedurës, për të angazhuar Ofrues të Shërbimeve për NSH përkatëse, përparësi kanë ish-punëtorët e atyre Ndërmarrjeve Shoqërore.
Sa i përket OSH-ve të angazhuar si roje në të gjitha NSH-të, nga viti 2016, si pjesë strategjike e Autoritetit të Likuidimit dhe Menaxhmentit të AKP-së është paraparë që ruajtja e aseteve të bëhet nëpërmjet angazhimit të OSH-ve dhe jo nëpërmjet operatorëve ekonomik. Ky veprim ka rezultuar me efekt pozitiv në kursimet e mëdha buxhetore për NSH-të përkatëse krahasuar me periudhat e mëhershme.
Në vijim janë pasqyruar detaje të Ndërmarrjeve shoqërore dhe shënime shpjeguese lidhur me angazhimet e Ofruesve të Shërbimeve.

Lista e NSH-ve me shpenzime të realizuara gjatë vitit 2025 dhe ato të prezantuara në vitin 2024 dhe 2023 për Ofruesit e Shërbimeve dhe Paga

Emri i NSH-së	SHUMA 2025	SHUMA 2024	SHUMA 2023	2025 vs 2024		2025 vs 2023		Numri i OSH-ve		
				Shuma	%	Shuma	%	2025	2024	2023
Mim Golesh	70,629	58,457	61,514	12,172	20.82%	9,115	14.82%	16	16	19
NSH Virxhinia	17,310	14,338	12,379	2,972	20.72%	4,931	39.83%	4	4	5
NSH Metaliku Fabrika e Enëve	16,692	16,080	11,919	612	3.80%	4,773	40.04%	4	4	4
NSh Metaliku	19,665	23,078	25,693	(3,413)	(14.79)%	(6,028)	(23.46)%	4	6	7
Tregu- likuidim	206,874	131,811	142,674	75,063	56.95%	64,200	45.00%	45	53	50
Hotel Grand	297,171	278,226	270,215	18,945	6.81%	26,956	9.98%	62	65	65
ABC Genci	6,211	55,692	58,104	(49,481)	(88.85)%	(51,893)	(89.31)%	2	13	13
Zarije Bujic	7,077	11,732	10,371	(4,655)	(39.68)%	(3,294)	(31.77)%	4	5	7
Lola Shterpce	30,292	25,092	24,183	5,200	20.72%	6,109	25.26%	7	7	7
FAM VITI	-	4,953	14,859	(4,953)	(100.00)%	(14,859)	(100.00)%	0	4	4
Hotel Brezovica	17,310	14,338	14,970	2,972	20.72%	2,340	15.63%	4	4	4
Xim Strezovci	36,014	30,104	28,678	5,910	19.63%	7,336	25.58%	8	8	8
Shpezëtaria	-	3,455	6,909	(3,455)	(100.00)%	(6,909)	(100.00)%	0	2	2
Lavertari Blegtori	12,982	11,618	13,819	1,364	11.75%	(837)	(6.05)%	3	4	4
IGK Ballkan	-	8,422	20,440	(8,422)	(100.00)%	(20,440)	(100.00)%	0	6	7

NSH Unimont	1,307	7,169	7,144	(5,862)	(81.77)%	(5,837)	(81.71)%	2	2	3
Shar Drvoexport	17,310	14,338	13,809	2,972	20.72%	3,501	25.35%	4	4	5
Ina Trgovina	2,180	-	15,986	2,180	100.00%	(13,806)	(86.36)%	2	0	11
RTP	1,302	1,302	0	-	0.00%	1,302	100.00%	1	1	0
Lahor Shterpcë	17,310	13,763	13819	3,547	25.77%	3,491	25.26%	4	4	4
Ereniku Industrija	14,705	14,338	13,819	367	2.55%	886	6.41%	4	4	4
Bouxite Mine Voljak	39,631	41,403	45,726	(1,772)	(4.28)%	(6,095)	(13.33)%	10	13	15
Urata	5,717	-	0	5,717	100.00%	5,717	100.00%	1	0	0
Fabrika e Municionit	17,037	13,032	14,827	4,005	30.74%	2,210	14.91%	4	4	4
Sharr Prodhimi	4,327	3,585	3,454	742	20.72%	873	25.29%	1	1	1
Kosova Vera	3,156	-	0	3,156	100.00%	3,156	100.00%	4	0	0
Dunav	11,943	-	0	11,943	100.00%	11,943	100.00%	2	0	0
***OSH për më shumë NSH**	245,966	259,282	432,241	(13,316)	(5.14)%	(186,275)	(43.10)%	59	95	117
NSH tjera	5,112	8,027	3,051	(2,915)	(36.31)%	2,061	67.56%	2	3	1
						Raste të transferuara ndërmjet NSH-ve		**(2)**	**(6)**	**0**
GJITHSEJ PAGESAT	**1,125,230**	**1,063,635**	**1,280,603**			**Gjithsej numri i OSH-ve të angazhuar**		**261**	**326**	**371**

***Janë gjithsej 59 persona të paguar për shumë ndërmarrje (jo specifike). Ndërsa aktivë janë 46 gjithsej OSH. Detajet janë si më poshtë:**

Angazhuar për	**Persona të paguar**	**Aktivë**
Projekti i arkivës	16	11
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	33	25
Zyra e ZDE – Operativë	1	1
Departamenti i Adminisratës	5	5
Departamentin Ligjor	1	1
Departamentin e Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes	1	1
ZR Mitrovicë	1	1
ZR Prizren	1	1
Gjithsej	**59**	**46**

11.2. SHPENZIMET E PARASË SË IMËT

PËRSHKRIMI	Avanset	Shpenzimet	Mjetet e kthyera
ZR e Gjilan	1,000	490	510
ZR e Mitrovicës	1,000	906	94
ZR e Pejës	1,500	1,397	103
ZR e Prishtinës	2,000	1,785	215
ZR e Prizrenit	1,000	968	32
*Pagesat e taksave Gjyqësore	24,000	23,003	997
**Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit	4,000	2,801	1,199
GJITHSEJ	**34,500**	**31,350**	**3,150**

Paraja e imët e dhënë në avans ka të bëjë me shpenzimet e vogla për NSH-të përkatëse. Avanset tërhiqen nga llogaria e tarifës administrative në fillim të vitit sipas kërkesave shtesë nga ZR-të. Këto shpenzime kryesisht kanë të bëjnë me shpenzime të vogla të tilla si taksa gjyqësore, taksa për certifikata të pronësisë, shpenzime të nevojshme të vogla për mirëmbajtjen e aseteve dhe mbarëvajtjen e aktiviteteve të NSH-ve në likuidim.

***Pagesat e taksave Gjyqësore** - Sipas rregullores nr. 02/2025 për Menaxhimin e Arkës, Shpenzimeve me Para të Gatshme dhe Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit, e aprovuar me datën 28 prill 2025, të gjitha shpenzimet e taksave gjyqësore në vlerën nën EUR 300.00 ekzekutohen nëpërmjet parasë së gatshme. Kjo është bërë me qëllim që të hiqen produrat burokratike të autorizimeve dhe procedurave për transferet bankare.

**** Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit -** Paraja e imët e dhënë në avanset për udhëtime zyrtare kanë të bëjnë me shpenzimet jashtë vendit. Këto shpenzime janë për përfaqësime në Gjykata për mbrojtjen e aseteve që gjendjen jashtë vendit. Llogaritjet e shumës për udhëtime jashtë vendit bëhet konform rregullave të Ministrisë së Financave, Punës dhe Trasnsfereve si dhe procedurës të aprovuar nga AKP për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. **Sipas rregullores nr. 02/2025 për Menaxhimin e Arkës, Shpenzimeve me Para të Gatshme dhe Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit, e aprovuar me datën 28 prill 2025, mjetet në avans të udhëtimit zyrtar bëhen nëpërmjet transferit bankar.**

12. SHPENZIME KOMUNALE

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Pagesat ndaj palëve të jashtme	144,712	105,587	178,674
Kompensimi i tarifës administrative	-	-	-
Gjithsej	**144,712**	**105,587**	**178,674**
Krahasimet ndërmjet vitit 2025 me vitet 2024 dhe 2023	ndryshimi	39,125	(33,962)
	%	37.05%	(19.01)%

Kanë të bëjnë me pagesat e realizuara për shërbimet publike (rrymë, ujë, telefoni dhe shërbimet e telekomunikimit) për Ndërmarrjet Shoqërore në tranzicion dhe në Likuidim që kanë aktivitete të përditshme.

Rritja e shpenzimeve komunale gjatë vitit 2025 kundrejt vitit 2024 është kryesisht si rezultat i rritjes të shpenzimeve (çmimit) të rrymës. Ndërsa në krahasim me vitin 2023 efekt kryesor në zvogëlimin e shpenzimeve janë shpenzimet e pastrimit të mbeturinave, meqenëse tek NSH Tregu ky aktivitet është riorganizuar dhe nuk paguhet më për këto shërbime ndaj "Pastrimi". Këto shpenzime paguhen direkt nga qiramarrësit.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME - KOMUNALITË

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Shpenzime për furnizim me ujë	11,614	12,853	14,958
Rrymë	127,752	80,019	81,981
Pastrimin e mbeturinave	1,472	8,870	67,050
Shërbimet e telekomunikimit	3,874	3,845	14,685
Gjithsej	**144,712**	**105,587**	**178,674**

1. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Shembull nëse kemi shuma që paraqiten si shpenzim (plus) në kategorinë e komunalive, atëhere në anën tjetër është paraqitet si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa kanë të bëjnë me shpenzime të NSH-ve të caktuara për të cilat, në mungësë të mjeteve bankare, më herët jane paguar nga tarifa administrative e AKP-së. Ndërsa tani këto mjete janë kthyer në tarifën administrative

13. TATIMET

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Pagesat ndaj palëve të jashtme	854,379	741,761	746,592
Kompensimi i tarifës administrative	106,839	8,863	18,054
Gjithsej	**961,218**	**750,624**	**764,646**
Krahasimet ndërmjet vitit 2025 me vitet 2024 dhe 2023	ndryshimi	210,594	196,572
	%	28.06%	25.71%

Në krahasim me vitin 2024 niveli i përgjithshëm i shpenzimeve është rritur si rezultat i shpenzimeve të TVSH dhe shpenzimeve të tatimit në pronë. Rritja e shpenzimeve të TVSH është si rezultat i rritjes të inkasimit të qirave. Ndërsa rritja e shpenzimeve të tatimit në pronë është si rezultat i marrëveshjes të NSH Metaliku me Komunën e Gjakovës për pagesën me këste të borxhit. E njëjta vlen edhe në krahasim me vitin 2023.

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Për vitin 2025, shuma prej EUR 106,839 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e tatimeve ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa kanë të bëjnë me shpenzime të NSH-ve të caktuara për të cilat, në mungësë të mjeteve bankare, më herët jane paguar nga tarifa administrative e AKP-së. Ndërsa tani këto mjete janë kthyer në tarifën administrative.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	678,135	612,518	611,204
Tatimi të hyrat e realizuara/qiratë	22,583	31,918	43,768
Kontributet pensionale - Trusti	63,198	56,825	60,495
Tatimi në të ardhurat personale	16,919	23,003	16,191
Tatimi në Pronë – Komunave	73,544	17,497	14,934
Urdhër-vjelja nga ATK	-	-	-
Gjithsej	**854,379**	**741,761**	**746,592**

14. VENDIMET E GJYKATAVE/PËRMBARUESVE

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Pagesat ndaj palëve të jashtme	21,329	55,417	11,000
Kompensimi i tarifës administrative	-	33,611	36,226
Gjithsej	**21,329**	**89,028**	**47,226**
Krahasimet ndërmjet vitit 2025 me vitet 2024 dhe 2023	ndryshimi	(67,699)	(25,897)
	%	(76.04)%	(54.84)%

Në krahasim me vitin 2024 dhe 2023 niveli i përgjithshëm i shpenzimeve është zvogëluar si rezultat sepse në vitin 2025 nuk është bërë kompensimi i tarifës administrative për këtë kategori të shpenzineve. Po ashtu në të njëjtën kohë zvoglimi i shpenzimeve është edhe si rezultat i pagesave direkte nga llogaritë bankare të NSH-ve nëpërmjet transferit bankar. Në rubrikën tjetër është shpalosur në detaje cështja e pagesave të taksave gjyqësore.

KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Gjatë vitit 2024, shuma prej EUR 33,611 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e vendimeve dhe taksave të Gjykatave ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa kanë të bëjnë me shpenzime të NSH-ve të caktuara për të cilat, në mungësë të mjeteve bankare, më herët jane paguar nga tarifa administrative e AKP-së. Ndërsa tani këto mjete janë kthyer në tarifën administrative.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHTME

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
*Taksa Gjyqësore	21,329	55,417	11,000
Ekspertizat për Gjykatë	-	-	-
Depozitë për (kthimet - nga) Gjykata	-	-	-
Gjithsej	**21,329**	**55,417**	**11,000**

***Taksat Gjyqësore** - Sipas rregullores nr. 02/2025 për Menaxhimin e Arkës, Shpenzimeve me Para të Gatshme dhe Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit, e aprovuar me datën 28 prill 2025, të gjitha shpenzimet e taksave gjyqësore në vlerën nën EUR 300.00 ekzekutohen nëpërmjet parasë së gatshme. Kjo është bërë me qëllim që të hiqen produrat burokratike të autorizimeve dhe procedurave për transferet bankare. Këto pagesa nuk ekzekutohen direkt nga llogaria bankare e ndërmarrjes nëpërmjet transferit bankar, por ekzekutohen nga paraja e imët e cila tërhiqet fillimisht nga llogaria e tarifës administrative dhe në vitin vijues llogaria bankare kompensohet.

15. TRANSFERIMI I MJETEVE 5% PËR MBULIMIN E AKTIVITETEVE TË AKP-së

MJETET E TRANSFERUAR NË MINISTRI TË FINANCAVE

PËRSHKRIMI	PËR BUXHETIN	SHUMA
Transferet për buxhetet 2011-2018		44,741,706
Transferet	2019	1,036,241
Transferet	2020	0.00
Transferet	2021	0.00
Transferet	2022	0.00
Transferet	2023	0.00
Transferet	2024	0.00
Transferet	2025	
Gjithsej		**45,777,947**

Tabela në anën e majtë paraqet shumat e transferuara nga llogaria e tarifës administrative të AKP-së prej EUR 43,977,947 si dhe fondit rezervë prej EUR 1,800,000 në Ministri të Financave, Punës dhe Transfereve për buxhetet vjetore të AKP-së. Në total EUR 45,777,947

Mjetet prej EUR 45,777,947 të transferura, gjatë viteve 2011-2018, nga llogaria e tarifës administrative në Ministri të Financave janë 5% të hyrave nga tërë procesi i shitjes dhe qiradhënies së aseteve, si dhe të hyrave vetanake të tilla si tarifa për pjesëmarrje në tender dhe konfiskimet e depozitave.

Për shkak se nuk ka pasur mjete të mjaftueshme, për buxhetin 2020-2025, nuk kemi transferuar mjete dhe se tërë buxheti i AKP-së është financuar nga Granti Qeveritar sipas ligjit për buxhetin e aprovuar nga Kuvendi Kosovës.

Në faqen tjetër është prezantuar vlera e tërësishme e të hyrave të dedikuara, përkatësisht 5% e vlerës të shitjesë të aseteve dhe qiradhënies, mjetet e alokuara nga tarifa për pjesëmarrje në tender si dhe mjetet e alokuara nga konfiskimet e BID depozitave. Të gjitha këto të alokuara llogarinë e tarifës administrative të AKP-së.

RAPORT I TË HYRAVE TË DEDIKUARA PËR VITIN 2025

PËRSHKRIMI	2025	2024	2023
Gjendja më 1 janar	50,928,790	50,249,121	50,249,121
Alokimi i mjete. nga llog. tarifës për pjesë. në tender	50,000	138,000	-
Alokimi i mjete. nga llog. për fondin rezervë	63,800	53,500	-
Alokimi i 5% e vlerës të shitjeve të aseteve	990,752	488,169	-
Alokimi i 5% i të hyrave nga qiraja	-	-	-
Gjithsej ndryshimet në vit	**1,104,552**	**679,669**	**-**
Gjendja më 31 dhjetor	**52,033,342**	**50,928,790**	**50,249,121**

Vlera prej EUR 1,104,552 e inkasuar gjatë vitit 2025 dhe inkasimi i akumuluar nga tërë proecesi prej EUR 52,033,342 janë të gjitha **mjetet e inkasuara** në llogari të tarifës administrative nga tarifa për pjesëmarrje në tender, 5% e shitje të kontratave të nënshkruara si dhe 5% e të hyrave nga qiraja.

Gjatë vitit 2025 është bërë alokimi i meteve, por që është bërë në fillim të vitit 2024.

Për vitin 2025 mjetet e alokuara në llogari të tarifës administrative janë si më poshtë:

- për shitjen përmes tenderit publik për 84 asete të shitura (për periudhën e kontratave të nënshkruar 17 dhjetor 2024 – 7 nëntor 2025) në vlerën totale të aseteve **EUR 17,839,621. Vlera e 5% është 891,981**
- për shitjen e asetit përmes shitjes direkte për 52 asete të shitura (për periudhën e kontratave të nënshkruar 21 janar 2025 – 27 tetor 2025) në vlerën totale të aseteve **EUR 1,975,425. Vlera e 5% është EUR 98,771**
- të hyra nga tarifa për pjesëmarrje në tender në total dhe konfiskimet e Bid depozitave, në tabelën e mësipërme prezantohet vetëm alokimi i mjeteve në llogari të tarifës administrative, ndërsa të hyra reale që janë realizuar janë të prezantuar në shënimin nr. 5.

Gjendja e llogarisë të tarifës administrative pas zbritjes të shpenzimeve është **EUR 1,683,856. Detajet janë prezantuar në kapitullin VIII Pagesat e realizuara nga tarifa administrative.**

16. SHPENZIME TJERA

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Pagesat ndaj palëve të jashtme	3,234	3,196	4,101
Kompensimi i tarifës administrative	-	3,902	8,292
Gjithsej	**3,234**	**7,098**	**12,393**
Krahasimet ndërmjet vitit 2025 me vitet 2024 dhe 2023	ndryshimi	(3,864)	(9,159)
	%	(54.44)%	(73.90%)

Këto shpenzime përfshijnë shpenzime e parave të imëta nga llogaritë e NSH-ve si dhe pagesat e tarifave për transaksionet dalëse nga llogarit bankare të fonde në mirëbesim që i aplikon BQK.

Gjithashtu, ka shpenzime të avanseve për udhëtime zyrtare jashtë vendit janë paraqitur në kategorinë mallra dhe shërbime tek shënimi shpjegues nr. 10, për shkak se ato janë paguar nga llogaria e tarifës administrative. Në momentin kur të kompensohet llogaria, atëherë, do të paraqiten si shpenzime në këtë kategori.

Ulja e shpenzimeve tjera kundrejt vitit 2024 është kryesisht si rezultat i ndryshimit të politikës të pagesave nga paraja e imët për shpenzimet e vogla për NSH-të përkatëse të përcaktuara sipas rregullores nr. 02/2025 për Menaxhimin e Arkës, Shpenzimeve me Para të Gatshme dhe Udhëtimeve Zyrtare Jashtë Vendit, e aprovuar me datën 28 prill 2025.

PËRMBLEDHJE E PAGESAVE NDAJ PALËVE TË JASHME

PËRSHKRIMI	SHUMA
Shp. nga paraja e imët në avans për shpenzime të vogla	-
Shpenzime bankare/tarifa për transaksion	**3,234**
Gjithsej	**3,234**

2. KOMPENSIMI I TARIFËS ADMINISTRATIVE

Ka efektin zero në aspektin e kontabilitetit të fondeve në mirëbesim. Gjatë vitit 2024, shuma prej EUR 3,902 paraqitet si shpenzim (plus) në kategorinë e shpenzimeve tjera ndërsa në anën tjetër është paraqitur si zbritje (minus) në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Këto pagesa kanë të bëjnë me shpenzime të NSH-ve të caktuara për të cilat, në mungësë të mjeteve bankare, më herët jane paguar nga tarifa administrative e AKP-së. Ndërsa tani këto mjete janë kthyer në tarifën administrative.

17. PAGESAT NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSH-ve

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023	GJITHSEJ 2011- 2025
Paga punëtorëve	3,084,029	2,654,378	735,798	29,064,695
ATK	25,883	168,058	700,239	10,403,164
Trustet pensional	178,407	142,374	104,932	4,794,801
Tatimi në pronë	7856	54,860	318,586	3,175,904
Komunalit	60,713	35,808	221,490	4,160,103
Kreditor të tjerë	219,469	1,691,142	1,749,683	18,334,423
Gjithsej	**3,576,357**	**4,746,620**	**3,830,728**	**69,933,090**

SHUMA E RAPORTET E APROVUARA DHE GJENDJA E TYRE E PAGESAVE

VITI	SHUMA	PAGESA	Diferenca
2010-2019	30,526,889	30,392,813	134,076
2020	5,766,047	5,686,030	80,017
2021	8,357,696	8,261,818	95,878
2022	15,077,430	14,834,895	242,535
2023	2,941,587	2,906,255	35,332
2024	5,659,765	5,206,289	453,476
2025	2,751,476	2,644,990	106,486
Për korrigjim v.2024	(809)	-	(809)
Gjithsej	**71,080,081**	**69,933,090**	**1,146,991**

1. RAPORTI I PAGESAVE NDAJ KREDITORËVE TË NSh-ve

Tabela në anën e majtë paraqet bilancin e pagesave për tre vitet e fundit si dhe totalin e realizuar nga viti 2011 deri me 31 dhjetor 2025.

2. SHUMA E RAPORTEVE TË APROVUARA DHE GJENDJA E TYRE E PAGESAVE

Tabela e dytë në anën e majtë paraqet shumën e raporteve për shpërndarje të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve nga viti 2010 deri më 31 dhjetor 2025.

Shumat e papaguara për raportet e viteve 2016-2025 janë kryesisht rezultat i mungesës i të dhënave të sakta për llogarit bankare. Për këto raste deri me tani, Autoriteti i Likuidimit dhe Zyrtarët e Rastit nuk kanë arritur në gjetjen e kontakteve të tyre në mënyrë që të ju mundësohen pagesat.

Gjatë vitit 2025 janë aprovuar gjithsej 8 raporte të shpërndarjes në vlerën e përgjithshme EUR 2,751,476. Mirëpo duhet korrigjuar një raport duke zbritur shumën prej EUR 809 sepse është kërkesë duplikatë.

Lidhur me shumat e papaguara të raporteve të aprovuara nga Bordi i Drejtorëve dhe korrigjimet për NSH-të përkatëse janë prezantuar në janë shpalosur në shënimin nr. 23.2.

Lidhur me diferencën totale të shumës të papaguar prej EUR 1,146,991 - Për secilin pagesë të shumës të aprovuar ndaj kreditorit hiqet shuma e transaksionit bankar prej 0.30 apo 1.30 (mbi EUR 10,000) dhe *gjendja reale e obligimeve në total* është raportuar tek llogaritë e pagueshme meqenëse nga totali i shumës janë ndalur tarifë bankare dhe raste tjera.

INFORMATË

SHUMA	KOMENTE
976	Për arsye të emrit dhe mbiemrit të njëjtë të dy kreditorëve, gjatë realizimit të pagesës në vlerë prej EUR 976.20, një kreditor ka përfituar më shumë për NSH "Trasing". Kreditori është njoftuar që t'i kthej mjetet dhe njëkohësisht janë marrë masat ligjore për rastin në fjalë.
3,194	Në Mars të vitit 2015, BQK-ja ka ekzekutuar urdhrin e përmbaruesit privat në shumën 3,194 për NSH në likuidim "Malishgani Klinë". AKP-ja ka marrë të gjitha hapat ligjor dhe ka kërkuar kthimin e mjeteve. Të gjitha institucionet relevante janë njoftuar për rastin në fjalë.
2,460	Në fund të dhjetorit 2017, të hyrat prej EUR 2,460 për NSH Grand për shfrytëzimin e sallës nga AKP-ja, gjatë ekzekutimit të pagesës janë konfiskuar nga ATK-ja. Kjo si rezultat i marrëveshjes në mes të ATK-së dhe Thesarit, nëpërmjet të cilës, përmes sistemit automatikisht ekzekutohen pagesat në të mirë të ATK-së.
56,580	Gjithashtu, në vitin 2017 jemi njoftuar se, ATK-ja ka konfiskuar mjetet prej EUR 56,680 që është dashur të paguaj institucioni i Kosovës për shfrytëzimin me qira të asetit të NSH Mekanizimi. Mjetet janë konfiskuar në vitin 2016. Mënyra e konfiskimit të mjeteve është ngjashëm si në rastin e sipër shënuar më lartë.
6,598,196	Mjete të bllokuara/rezervuara nga BQK: · për NSH në likuidim "IDGJ Tobacco" EUR 620,866; · për NSH në likuidim "Pasuria Bujqësore Ferizaj" EUR 6,341; · për NSH në likuidim "Jugoterm" EUR 192,357; · për NSH në likuidim "Liria Bardhosh" EUR 35,618; · për NSH në likuidim "Agroprodukti Kamenice" EUR 3,395; · për NSH në likuidim "Agrokultura" EUR 85,337; · për NSH në likuidim "Rilindja Grafike" EUR 620,223 · për NSH në likuidim " Nevvco Llamkos Steel" 5,004,058.18 sipas urdhrit përmbarimor shih shënimin nr. 14 ; dhe

Përveç urdhrit përmbarimor, mjetet e rezervuar në BQK janë si rezultat i vendosjes së barrës tatimore mbi asetet e NSH-ve. AKP ka nënshkruar një "Marrëveshje të Mirëkuptimit" me ATK për trajtimin e barrës tatimore.

18. FONDET TRANSFERUAR BUXHETIT TË KOSOVËS

VITI	Fondet Tepricë	Fondet e mbetura	Fondet e përkohshme	TOTALI
2012	28,934,282	-	-	**28,934,282**
2015	61,310,629	-	-	**61,310,629**
2017	-	325,664	-	**325,664**
2018	-	42,226,452	43,920,006	**86,146,458**
2019	-	2,208,220	147,793,750	**150,001,970**
2020	-	53,738	71,422,445	**71,476,183**
2021	-	38,555	-	**38,555**
2022	-	-	-	**-**
2023	-	-	-	**-**
2024	-	(106,088)	(142,706)	**(248,794)**
2025		21,789	(1,220,319)	**(1,198,530)**
Gjithsej	**90,244,911**	**44,768,330**	**261,773,176**	**396,786,417**

Fondet e transferuara në buxhetin e Kosovës janë:

1. Fondet Tepricë sipas nenit 19.3.3 të Ligjit bazik nr. 04/L-034;
2. Fondet e mbetura sipas nenit 4, paragrafi 3.2.6 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim; dhe
3. Fondet e përkohshme sipas nenit 4, paragrafi 3.2.7 të Ligjit nr. 06/L-023 për plotësim dhe ndryshim të Ligjit 04/L-034 ka hyrë në fuqi në muajin maj 2018.

Nëpërmjet tabelës në anën e majtë, pasqyrohen llojet e fondeve të transferuara Buxhetit të Kosovës nga viti 2012 deri më 31 dhjetor 2025.

Bilancet negative për vitin 2024-2025 janë të gjitha kthime të mjeteve. Kthimi i mjeteve është bërë sipas kërkesës së Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, në përputhje me nenet e Ligjit të AKP-së, të përmendura në tabelën më lart. Vlera totale e kthimit të mjeteve me vendime të Qeverisë përfshin gjithsej 11 ndërmarrje shoqërore në likuidim, me qëllim që të mundësohet shpërndarja e mjeteve kreditore të NSH-ve, pas ankesave të fituara në Gjykatë. Për këto 11 ndërmarrje, vite më parë, Qeverisë i kemi transferuar si fonde të përkohshme, të mbetura dhe fonde tepricë, në shumën totale prej EUR 8,821,926

VI. LLOGARITË E ARKËTUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Ndëshkimet me Spin-Off Speciale	29,318,296	29,318,296	29,318,296
Nga shitja e aseteve	11,717,983	8,171,724	9,357,628
Nga shpronësimi i aseteve të NSH-ve	3,071,250	4,095,000	4,023,099
Të hyra nga qiraja dhe tjera	15,756,634	15,617,250	15,725,837
Gjithsej	**59,864,163**	**57,202,270**	**58,424,860**

TË SHPALOSURA

Ndëshkimet financiare të shpalosura në shënimin shpjegues nr. 19
Llogaritë e arkëtueshme nga shitjet e aseteve në shënimin shpjegues nr. 20
Llogaritë e arkëtueshme nga shpronësimet e aseteve në shënimin shpjegues nr. 21
Llogaritë e arkëtueshme nga të hyrat e qirasë në shënimin shpjegues nr. 22

Gjatë vitit 2025, AKP ka filluar me zhvillimin e data-bazës së për faturimin dhe inkasimin e qirave. Kjo do të mundësoj kontrolle strikte në periudha periodike duke ofruar edhe një pasqyrë më të qartë vitit 2026 do të vazhdoj përpjeket për trajtimin e llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, është themeluar një komision për vlerësim të gjendjes reale të ll/a të qirave. Kjo do të trajtohet edhe në vitin 2026.

Llogaritë e arkëtueshme janë obligimet e papaguara nga palët e treta ndaj Agjencisë për rastet si më poshtë:

- pjesët e papaguara nga valët e privatizimit/ likuidimit dhe shitjeve përmes negocimit direkt;
- ndëshkimet financiare për valët e "spin off-ve special";
- shpronësimi i aseteve; dhe
- qiratë apo të hyra të tjera nga asetet e NSH-ve.

Të gjitha këto të dhëna janë të paraqitura nga Divizioni për Kontroll dhe Mbikëqyrje, Zyrat Regjionale përmes Departamentit të Koordinim të Rajonal dhe Operativës, Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes dhe Divizioni për Shitje Direkte.

Ashtu siç është paraqitur edhe në fillim të shënimeve shpjeguese, sa i përket llogarive të arkëtueshme janë paraqitur vetëm si shpalosje në këto pasqyra, pasi që pasqyrat financiare të Agjencisë Kosovare të Privatizimit janë përgatitur në pajtim me SNKSP (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik) e bazuar në para të gatshme.

19. NDËSHKIMET NDAJ NSH-ve ME SPIN-OFF SPECIAL

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Grand Hotel	8,822,315	8,822,315	8,822,315
Xim Strezovc	7,298,171	7,298,171	7,298,171
MIM Golesh	8,447,812	8,447,812	8,447,812
Agrokosova Holding	3,579,998	3,579,998	3,579,998
Famipa Prizren	1,170,000	1,170,000	1,170,000
Gjithsej	**29,318,296**	**29,318,296**	**29,318,296**

Janë ndëshkimet në vlerë monetare ndaj blerësve për zotimet e dhëna për disa Ndërmarrje të Reja, që përveç çmimit të ofertës, ofertuesit kanë dorëzuar dhe ofertat lidhur me investimet për këto Ndërmarrje.

Shitjet janë realizuar edhe me kushte të tilla si: vazhdimi i operimit të aktivitetit të NSh-ve, me investimet e zotuara dhe numrin e punëtorëve. Këto raste kanë qenë “Shitjet me Kushte të Veçanta” dhe shitjet me “Spin Off Special”. Deri më tani, ndëshkimet financiare të aplikuara për blerësit të cilët nuk i kanë përmbushur zotimet për NSH-të e paraqitur sipas tabelës në anën e majtë.

20. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHITJA E ASETEVE

PËRSHKRIMI	2025	2024	2023
Gjendja më 1 janar	8,171,724	9,357,628	8,692,937
Korrigjim për vitin 2024	(1,000)	(29,313)	-
Pagesat e realizuara të LL/A të viteve paraprake	(1,103,501)	(1,167,385)	(1,423,856)
Anulim/tërheqja nga shitjet të tenderuar LL/A	(330,552)	(1,531,499)	(74,344)
Llogari të arkëtueshme të reja gjatë vitit	4,981,312	1,542,293	2,162,891
Gjithsej ndryshimet në vit	**3,546,259**	**(1,185,904)**	**664,691**
Gjendja më 31 dhjetor	**11,717,983**	**8,171,724**	**9,357,628**

Llogaritë e arkëtueshme përmes valëve të privatizimit dhe shitjes përmes negocimit direkt janë llogari që **potencialisht mund të inkasohen**, meqenëse për këto raste nuk është përfunduar ende procesi i nënshkrimit të kontratave. Ashtu siç është thënë edhe me lartë, llogaritë e arkëtueshme në këtë rast paraqiten vetëm si shpalosje e informacioneve në pasqyrat financiare dhe mundësitë e inkasimit të tyre në të ardhmen.

Përveç rasteve të pezulluara - aprovimin nga Bordi, rastet që nuk realizojnë pagesat ju konfiskohet BiD depoziti. Pjesa e konfiskimit të BiD depozitave është trajtuar në shënimin shpjegues nr. 5.

PËRMBLEDHJE – PËRSHKRIMI I LLOGARIVE TË ARKËTUESHME TË BARTURA NGA VITI 2024 DHE ATO NË VITIN 2025:

Periudha	Shuma	Përshkrimi	Statusi
Vitet paraprake	223,223	Privatizim Vala 43 për Punëtoria Iliria	Masë të përkohshme
	70,777	Likuidimi 29 për NSH Rekreaturs, njësia 34	Masë të përkohshme
	1,800,000	Likuidimi 35 për NSH Gërmia, njësia 43	Masë të përkohshme
	112,456	Likuidimi 35 për NSH Zetatrans, njësia 47	Masë të përkohshme
	478,325	Likuidimi 35 për NSH Lavertari Blegtori, njësia 55	Masë të përkohshme
	19,890	Likuidimi 37 për NSH Agromorava, njësia 7	Masë të përkohshme
	531,550	Likuidimi 45 Njësia nr. 75 - NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Trepetincë 4	Masë të përkohshme
	425,425	Likuidimi 47 Njësia nr. 114 - NSH Lavërtaria-Blegtoria - Tokë bujqësore në Petrovë 1	Masë të përkohshme
	388,888	Likuidimi 49 Njësia nr. 101 - Visoko Commerce Shitorja nr. 2	Masë të përkohshme
	163,000	Likuidimi 51 Njësia nr. 05 - IMK Toka në Shtime (Lot A)	Pezullim
	1,555,778	Likuidimi 51 Njësia nr. 71 - Auto Moto Lipjan	Pezullim
	342,957	Vendimi i arbitrazhit ndërkombëtar për NSH MIM Golesh në favor të AKP-së	Në proces
	231,110	Likuidimi 57 Njësia nr.21: Investbanka Lokali në Mitrovicë	Masë të përkohshme
	132,132	Njësia nr.21: Investbanka Lokali në Mitrovicë	Masë të përkohshme
	120,190	Njësia nr.82: KB Liria Tokë Bujqësore Bardhosh III	Masë të përkohshme
	135,600	Njësia nr.43-Gazela Lokali në Prishtinë Masë e Përkohshme	Masë të përkohshme
	5,370	Shitjet e aseteve përmes shitjeve direkte nga vitet e kaluara	
2025	4,981,312	Raste te vales 70, 73 dhe 74 te shitjeve me tender publik si dhe dy raste te shitjeve direkte	
	11,717,983	**GJITHSEJ**	

21. LLOGARITË E ARKËTUESHME NGA SHPRONËSIMI I ASETEVE

Përshkrim i marrëveshjes	Institucioni	Obligimi 2024	Të reja	PAGESAT 2025	Obligimi
PRZ014 – IGK Ballkan MMFSK për shpronësimin e pronës duhet të paguaj në vlerën total totale të shpronësimit prej EUR 6,942,102.40 Është kërkuar vlera totale e shpronësimit për 20% të punëtorëve, pagesave ndaj kreditoreve dhe kosto të likuidimit. Gjatë vitit 2024 ishte paguar 20% i punëtorëve, ndërsa obligimi i mbetur nga viti 2024 prej EUR 4,095,000 ka qenë për pjesën e kreditorëve ku është paguar kësti i parë prej 25% të kësaj vlere. Tri këste tjera të papapaguar përbëjnë vlerën e mbetur në fund të vitit 2025.	Ministria e Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.	4,095,000	-	1,023,750	3,071,250
		4,095,000	**-**	**1,023,750**	**3,071,250**
SHPALOSJE Sipas vendimit të Qeveris nr.06/153 të datës 26 korrik 2023 si dhe vendimit nr 09/172 të datës 11 gusht 2023, shpronësohen pronat në interes të realizimit të projektit "Ndërtimi i ndërtesës Administrative" për Administratën Tatimore të Kosovës dhe Doganës të Kosovës, ZK Prishtinë – Komuna e Prishtinës. Cmimi i m² sipas vendimit të Qeverisë nr. 23/162 të datës 27 dhjetor 2013 është EUR 335 dhe se me vendimin e Qeverisë nr.06/153 të datës 26 korrik 2023 janë shpronësuar gjithsej 10678 m². Rrjedhimisht vlera totale e shpronësimitë bazuar në këto të dhëna është EUR 3,577,130. Nuk ka marrëveshje në mes të AKP-së dhe Qeverisë se sa duhet të jetë vlera e tërësishme e pagesë vetëm për nevoja të shpërndarjes të 20% të punëtorëve, kërkesave kreditore dhe kosto të likuidimit. Andaj ky shënim marrë parasysh gjendjen e informatave paraqitet vetëm si shpalosje	Administrata Tatimore e Kosovës dhe Dogana e Kosovës	**EUR 978,545**		**EUR 978,545**	**nuk ka marrëveshje**

Llogaritë e arkëtueshme lidhur me shpronësimin e aseteve të Ndërmarrjeve Shoqërore janë paraqitur vetëm për rastet kur AKP dhe institucionet tjera relevante kanë lidhur marrëveshje në të cilën përfshihen afatet kohore dhe shumat për pagesë. Gjithsesi, janë një numër i konsiderueshëm i aseteve që janë shpronësuar, por për shumicën prej tyre ende nuk dihet vlera e vlerësuar e shpronësimit dhe rrjedha e pagesave. Rrjedhimisht, paraqiten vetëm rastet kur ka marrëveshje nëpërmjet të cilave institucionet relevante zotohen që brenda një periudhe afatmesme të paguhen shumat e shpronësimit. Zakonisht, sipas marrëveshjeve, vlerat e paraqitura më poshtë nuk janë vlera totale të shpronësimit, por kostot dhe shumat e përllogaritura, të cilat janë më se të nevojshme në zbatim të ligjit dhe mbyllje të procesit të likuidimit. Çdo shumë shtesë e paparashikuar që mund të rrjedhë në të ardhmen duhet paguar nga institucioni relevant por jo mbi shumën e vlerësuar e shpronësimit.

22. LLOGARITË E ARKËTUESHME PËR QIRATË DHE TJERA

	1	2	3	4=2-3	5=1+4	PADITË			
		2025			TOTALI				
VITI	31 dhjetor 2024	Rritjet në vitin aktual	Zvogëlimet vitet paraprake	Ndryshimi për vitin	31 dhjetor 2025	2025	2024		krahasimi %
ZR Prishtina	**12,491,555**	275,395	(169,011)	106,384	**12,597,939**	11,324,534	10,972,119	↑	3.21%
ZR Pejë	**731,421**	76,005	(26,562)	49,443	**780,864**	687,966	666,541	↑	3.21%
ZR Mitrovicë	**1,163,522**	9,840	(15,593)	(5,753)	**1,157,769**	1,137,391	1,137,656	↓	(0.02)%
ZR Gjilan	**1,046,204**	14,126	(40,950)	(26,824)	**1,019,380**	1,009,253	1,034,066	↓	(2.40)%
ZR Prizren	**78,252**	13607	(9,901)	3,706	**81,958**	26,616	66,800	↓	(60.16)%
Admi. Direkt	**106,296**	12,428	-	12,428	**118,724**	114,564	-	↑	100.00%
Gjithsej	**15,617,250**	**401,401**	**(262,017)**	**139,384**	**15,756,634**	**14,300,325**	**13,877,182**	↑	3.05%

Llogaritë e arkëtueshme janë me zvoglim prej 0.65% krahasuar me vitin 2024. Me këtë vërehet se llogaritë e arkëtueshme këto vitet e fundit nuk kanë tendencë rritje/ulje. Vlen të theksohet janë 6 raste/qiramarrës të mëdhenjë që përbëjnë 72.32% të llogarive të arkëtueshme. Rastet e 6 qiramarrësve të mëdhenj për të cilët janë iniciuar procedurat gjyqësore përbëjnë 79.71% të vlerës totale të padive dhe janë të listuar paraqitur në tabelën në anën e djathtë.

Po ashtu, në faqen tjetër janë përshkruar disa NSH nëpër regjione që kryesisht kanë ndikuar në uljet dhe rritjet e llogarive të arkëtueshme përgjatë vitit 2025.

Pesë qiramarrësitë e mëdhenjë me obligime ndaj NSH-ve

- **8,708,328** - faturimi ndaj Kosova Petrol për asetet e NSH Jugopetrol dhe Ina Trgovina. Faturimi është për periudhën shkurt 2000 - 30 prill 2016 (fatura e parë e lëshuar në vitin 2014) Rasti është në procedurë gjyqësore;
- **702,861** - faturimi "AL Petrol" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të INA Trgovina. Ndaj "AL – Petrol" çështja është në procedurë gjyqësore, në shkallën e parë ka fituar AKP;
- **813,376 -** faturimi ndaj "Industria e Naftës INA D.D. Zagreb" për shfrytëzimin e pompave të benzinës të NSH INA Trgovina;
- **370,776 -** faturimi ndaj NPTSH Sharr Beteilingungs për të cilët është ngritur padi por që ende nuk ka përfunduar procesi gjyqësor;
- **496,400 -** faturimi ndaj Komuna e Mitrovicës, Organizata BAC, Biblioteka nder komunale, Oda Ekonomike e Kosovës, OJQ 7 Arte. Faturimi është sipas llogaritjes nga 1 mars 2011 deri më 31 dhjetor 2021. Rasti është në procedurë gjyqësore.
- **278,628 –** Borxhi me akt-vendimt të gjykatës për NP Geti Com SHPK

Listim i shkurtër i NSH-ve që kanë pasur impakt të lartë të ndryshimeve në nivel të regjioneve

Llogaritë e arkëtueshme						
2025	2024	ndryshimi	% e ndryshimit	Ndërmarrja shoqërore	ZR	Komente
164,092	182,656	(18,564)	(10.16)%	NewCo Grand Hotel Shpk	Prishtinë	Inkasim i borxhit
2,097	3,824	(1,727)	(45.16)%	K.B. Kosova	Prishtinë	Inkasim i borxhit
12,910	36,916	(24,006)	(65.03)%	Perparimi	Prishtinë	Inkasim i borxhit
697	5,463	(4,766)	(87.24)%	Magjistrala	Prishtinë	Inkasim i borxhit
6,049	9,533	(3,484)	(36.55)%	K.B. Bujqesia	Prishtinë	Inkasim i borxhit
32,422	20,742	11,680	56.31%	Shpezëtaria	Prishtinë	Mospagesë brenda afatit kontraktual (borxh i riprogramuar)
21,337	25,467	(4,130)	(16.22)%	Barnatoret e Prishtinës	Prishtinë	Inkasim i borxhit
1,303	2,607	(1,304)	(50.02)%	Ramiz Sadiku	Prishtinë	Inkasim i borxhit
26,400	30,269	(3,869)	(12.78)%	Izolimi	Prishtinë	Inkasim i borxhit
14,135	4,578	9,557	208.76%	RTP	Prishtinë	Mospagesa brenda afatit kontraktual
337,615	93,762	243,853	260.08%	Lidhja Auto - Moto e Kosovës	Prishtinë	Mospagesa brenda afatit kontraktual
67,623	75,556	(7,933)	(10.50)%	N.T.SH Sharr	Gjilan	Inkasim borxhi dhe një rast vendim gjykate në favor të palës.
40,897	46,364	(5,467)	(11.79)%	N.Sh.I.M.B Kualiteti	Gjilan	Gjykata ka refuzuar e ankesën e NSH-së kundër debitorit. Përmbaruesi ka përfunduar lëndën.
72,642	61,719	10,923	17.70%	N.Sh.T. 28 Nentori	Gjilan	Pas pranimit të njoftimit nga Gjykata, është shtuar në LL/A si lëndë e re.

11,459	18,972	(7,513)	(39.60)%	N.B.I Agromorava	Gjilan	Përmbarimi i rastit NSH Agromorava vs Abdylaziz Hajdari, si dhe 2 Aktvendime të Gjykatave në favor të palëve.
3,203	-	3,203	100.00%	KB Zarije Bujic	Gjilan	Është borxh nga qiraja e pa paguar e vitit 2025. Rasti është në përmbarim
1,381	7	1,374	100.00%	Apiko	Pejë	Qiramarrës në vonesë, qira e pa inkasuar
21,234	23,306	(2,072)	(8.89)%	Ereniku - Virgjinia	Pejë	Inkasim i qirave të papaguara
5,990	7,513	(1,523)	(20.27)%	Produkt	Pejë	Realizim I rastit të dërguar në përmbarim
88,368	39,107	49,261	125.96%	Ereniku - Prodhimtaria Primare	Pejë	Jannë dërguar në përmbarim raste të teja të pranuara nga Gjyakata, si dhe rritja e vlerës së qirasë 90 Euro për hektarë gjë që ka rritur edhe lartësinë e qirasë.
14,425	12,295	2,130	17.32%	Deva	Pejë	Qiramarrës në vonesë, qira e pa inkasuar
4,373	3,505	868	24.76%	Enti I Projektimit Ening	Pejë	Qiramarrës në vonesë, qira e pa inkasuar
35,429	14,126	21,303	150.81%	NT Korenik	Pejë	Janë dërguar në përmbarim raste të reja sipas Aktvendimeve të Gjykatës
17,913	19,660	(1,747)	(8.89)%	Agrodukagjini	Pejë	Inkasim i qirave të papaguara
17,056	23,192	(6,136)	(26.46)%	Farmakos	Prizren	Inkasim të borxheve
5,900	1,965	3,935	200.25%	Prizren-Market	Prizren	Ka ndryshim të nr. të qirave dhe inkasimi ka qiramarrës pasiv dhe në përmbarim në vitin 2025.
1,432	-	1,432	100.00%	Sharrprodhimi	Prizren	Ka ndryshim të nr. të qirave dhe inkasimi ka vonesa në fund vit të 2025
1,538	2,577	(1,039)	(40.32)%	D.L.B Lavërtari Blegtori	Prizren	Ka ndryshim të Nr të qirave dhe inkasomi ka vonesa më pak në vitin 2025
5,795	3,213	2,582	80.36%	Prizren Trans	Prizren	Ka inkasim më pak në 2025 sepse qiramarrësi është në përmbarim

2,560	-	2,560	100.00%	Unimont	Prizren	Në vitin 2025 qiramarrësi e ka liruar pronën dhe për mos pagesë e kemi përcjell tek përmbaruesi
9,574	6,082	3,492	57.42%	K.B. Drenica	Mitrovica	Qiramarrës me vonesë në pagesë
18,692	25,386	(6,694)	(26.37)%	Elan	Mitrovica	Inkasim borxhi
-	1,485	(1,485)	-100.00%	BIP Beograd	Mitrovica	Inkasim borxhi
-	2,019	(2,019)	-100.00%	Univerzal	Mitrovica	Inkasim borxhi
-	1,490	(1,490)	-100.00%	Javor	Mitrovica	Inkasim borxhi
-	1,461	(1,461)	-100.00%	NSH Trepca Standard	Mitrovica	Inkasim borxhi
118,724	106,296	12,428	11.69%	Metaliku	Administrimit direkt	Rritja e Borxhit nga mos pagesa e obligimeve nga një qiramarrës dhe i cili është dërguar në përmbarim

VII. LLOGARITË E PAGUESHME DHE DETYRIMET KONTIGJENTE

23. LLOGARITË E PAGUESHME

PËRSHKRIMI	VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Ofruesi i Shërbimeve Profesionale	-	-	-
Obligimet ndaj kërkesave kreditore	1,146,991	2,084,595	1,112,135
Mallra dhe Shërbime	302,903	111,070	138,425
Gjithsej	**1,449,894**	**2,195,665**	**1,250,560**

Obligimet e papaguara janë të paraqitura në tri shtylla:

1. Ofruesi i Shërbimeve Profesionale (Autoriteti i Likuidimit);
2. Mallrat dhe Shërbimet; dhe
3. Obligimet ndaj Kërkesave të Kreditorëve.

23.1. OFRUESI I SHËRBIMEVE PROFESIONALE PËR PROCESIN E LIKUIDIMIT

Obligime ndaj Ofruesit të Shërbimeve Profesionale nuk ka sepse janë ekzekutuar të gjitha kërkesat/faturat e dorëzuara nga Menaxheri i Kontratës për shërbimet e pranuara dhe të aprovuara nga Komiteti Drejtues i Likuidimit. Pagesat përfshijnë periudhën deri me shërbimet e muajit nëntor 2025. Ndërsa sa i përket shërbimeve të muajit dhjetor 2025, sipas procedurës ato njihen apo bëhen të pranueshme pasi që aprovohet raporti nga Komiteti i Likuidimit. Neni 16.1 i Kushteve të Veçanta të Kontratës parasheh që faturat duhet të lëshohen nga OSHP me rastin e dorëzimit të raportit mujor për muajin paraprak. Pagesat mujore bëhen me rekomandim të Menaxherit të Kontratës për aprovim të raportit mujor nga Komiteti Drejtues i Likuidimit brenda 30 ditëve kalendarike duke filluar nga dita kur lëshohet fatura dhe protokollohet në AKP. OSHP ka dorëzuar faturën dhe raportin mujor për dhjetor 2025 më datën 12 janar 2026.

Kontrata në mes të AKP-së dhe OSHP-së (“Curtis, Mallet-Prevost, Colt & Mosle LLP, Grant Thornton Consulting Doo dhe Grant Thornton L.L.C”) është nënshkruar me 30 janar 2025. Periudha e angazhimit është tri vjeçare, nga data 1 shkurt 2025 deri me 31 janar 2028 në vlerën totale të kontratës prej EUR 1,800,000.

Kontraktonit të parë “Deloitte” të gjitha janë përfunduar në vitin 2018. Lidhur me OSHP, referojuni edhe shënimit shpjegues nr. 10.

Tre fatura për periudhën gusht 2019, korrik 2021 dhe gusht 2021 janë refuzuar për pagesë meqenëse nuk kanë përmbushur shërbimet sipas kushteve të kontraktuara. Më në detaje, për këto janë paraqitur si *shënim* tek pjesa e detyrimeve kontigjente, përkatësisht shënimin nr. 24.

23.2. OBLIGIMET NDAJ KREDITORËVE TË NSH-VE

Përshkrimi	Shuma
Obligimet më 1 janar	2,084,595
Korrigjime kontabël pë raportet e shpërndarjes për vitet paraprake	(111,914)
Shuma e paguar gjatë vitit 2025 për vitet paraprake	(990,673)
Shuma e aprovuara të shpërndarjes 2025	2,751,476
Për korrigjim viti 2024	(809)
Pagesat nga shumat e aprovuara të shpërndarjes 2025	(2,585,684)
Obligimi më 31 dhjetor	**1,146,991**

Ashtu siç është përmendur edhe në shënimin shpjegues nr. 17, obligimet e papaguar janë pagesat e parealizuara ndaj kreditorëve të NSH-ve sipas vendimit për shpërndarje të Bordit të Drejtorëve. Kryesisht shumat e papaguara të raporteve të viteve paraprake janë për rastet të cilat ka pasur mungesë të informacioneve të llogarive bankare.

Obligimi i paraqitur në shënimin shpjegues nr. 17 prej EUR 1,146,991 paraqet gjendjen e pagesave nga e cila janë zbritur tarifat bankare në secilin transaksion bankar aty ku aplikohen tarifa bankare nga BQK. Tarifa bankare në planin kontabël kategorizohen në shënimin nr. 16 dhe të cilat gjatë tërë procesit të shpërndarjes janë EUR 9,789.

Po ashtu, gjatë vitit 2024 janë paraqitur disa kërkesa duplitatë për shpërndarje e që kanë nevojë për korrigjim të raporti të shpërndarjes në vitin 2025 në vlerën totale EUR 809

Pagesat për raportet e vitit 2025

Raportet e shpërndarjes janë aprovuar duke filluar nga janari 2025. Janë gjithsej 8 raporte të shpërndarjes të aprovuara:

- PEJ080 Fonderia Emaili, vlera totale e aprovuar EUR 3,458 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- PRN129 “Ingienering”, vlera totale e aprovuar EUR 59,314 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- PRZ014 “IGK Balkan”, vlera totale e aprovuar EUR 1,818,794 dhe është realizuar shpërndarja në 95%;
- PRN092 “Eximkos”, vlera totale e aprovuar EUR 17,544 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- PRN126 “Automoto”, vlera totale e aprovuar EUR 42,773 dhe është realizuar shpërndarja në 100%;
- PRZ071 “KB Malisheva”, vlera totale e aprovuar EUR 88,173 dhe është realizuar shpërndarja në 97%;
- PEJ089 “Zastava – Ramiz Sadiku”, vlera totale e aprovuar EUR 7,940 dhe është realizuar shpërndarja në 100%
- PRN046 “FAN Zahir Pajaziti”, vlera totale e aprovuar EUR 713,477 dhe është realizuar shpërndarja në 99%

23.3. MALLRA DHE SHËRBIME

RRJEDHA E NDRYSHIMEVE NGA VITI PARAPRAK

Përshkrimi	Shuma	Renditja
Obligimet më 1 janar 2024	**111,070**	1
Fshirë nga vitet paraprake	-	2
Pagesat e realizuara gjatë vitit 2025	(111,070)	.4
Obligimet e bartura nga vitet paraprake	-	5
Obligimet gjatë vitit aktual	302,903	6
Gjithsej	**302,903**	

PËRSHKRIMI I DETYRIMEVE

Përshkrimi	Shuma
Kontributet pensional të OSh & punët ë NSH – dhjetor 2025	21,380
Paga dhe Ofrues shërbimesh për muajin dhjetor 2025	3,600
Shërbime komunale (rrymë, ujë dhe mbeturina) për NSh'të	35,428
Shërbime tjera	1,399
Shërbimet postare	889
Shpenzime për ngrohje qendrore të NSH Grandi	10,917
Shpenzime të telekomunikimit	118
Sigurimi fizik i aseteve (Policia e Kosovës)	2,360
Tatimet ne burim (paga) ne te ardhura personale	7,995
Tatimi në fitim	35
Tatimi mbi vlerën e shtuar	95,788
Vendim Gjykate – bartur nga detyrimi kontigjent	122,994
Gjithsej	**302,903**

Kryesisht paraqiten shpenzimet për ofruesit e shërbimeve të cilët angazhohen për NSH-të përkatëse, shërbimet për ruajtjen e aseteve, shpalljet në gazeta për shitjen e aseteve përmes likuidimit, shpalljet lidhur me njoftimet për kërkesat e kreditorëve, qiraja, shërbimet publike dhe të tjera.

Rastet e reja:

Përvec faturimeve të rregullta që kanë mbetur pa u paguar si rezultat i prerjes të vitit fiskal, është përfshirë edhe një rast si lëndë e papaguar e viteve paraprake në vlerën prej EUR 122,994. Ky rast ka qenë i raportuar në pozicionin "detyrime kontigjente" dhe është bartje në pozicionin "llogari e pagueshme" Rasti është shqyrtuar dhe është me vendim të formës të prerë të shkallës të dytë të Gjykatës. Deri në dërgimin e informacioneve bankare, rasti figuron si e papaguar.

24. DETYRIMET KONTIGJENTE

PËRSHKRIMI		VITI 2025	VITI 2024	VITI 2023
Gjendja fillestare me 1 janar		5,319,078	7,433,980	7,462,908
Konteste apo raste të reja		803,640	242,650	68,199
Raste të fituara nga AKP		-	(2338,189)	(85,735)
Raste të përfunduara		-	(2,000)	-
Raste të Korrigjuara		(122,994)	-	(14,228)
Raste të bartura		-		2,836
Raste të larguara		-	(17,363)	-
Gjendja më 31 dhjetor		**5,999,724**	**5,319,078**	**7,433,980**
Mundësia	Ulët	4,757,875	4,757,875	7,227,623
	Mesëm			-
	Lartë	1,241,849	561,203	254,057

NDRYSHIMET KUNDREJT VITIT 2025

1. **Raste të Reja**
   - Kontestë lidhur me faturimet e tatimit në pronë për shkak të evidencës të pagesave dhe pronës në vlerën totale prej EUR 802,640;
   - Kërkesa për pagesë të refuzuar si rezultat i moskompletimit të lëndëve EUR 1,000;

2. **Raste të larguara**
   - Me Aktgjykimin SCC-06-0348 është aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësit dhe detyrohet AKP-ja që ti kompensojë shumën prej 122.994 euro me kamatë ligjore, si dhe të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 1720 euro, ndërsa pjesa tjetër refuzohet si e pabazuar. Me Aktgjykimin AC-I-14-0154 të datës 27.02.2020, e pranuar nga AKP-ja me datë 04.03.2020, Ankesat janë refuzuar si të pabazuara dhe është vërtetuar Aktgjykimi i Kolegjit të Specializuar SCC-06-0348 i datës 15 prill 2014, me datë 19

qershor 2020, avokati paraqet në AKP kërkesë (sipas autorizimit të palës) për pagesën e shpenzimeve të procedurës, por nuk është parashtruar kërkesë për shumën a aprovuar për paditësin prej 122.994. Prandaj, në këtë fazë nuk është bërë pagesë pa u sqaruar çështja e shumës kryesore, marrë për bazë faktin se AKP ka pritur kërkesë nga pala paditëse apo avokati me autorizim, që të bëjë këtë kërkesë për ekzekutim të shumës kryesore, respektivisht të dërgoj të dhënat bankare ku duhet të bëhet pagesa.

LISTA DETAJE E TË GJITHA RASTEVE TË DETYRIMEVE KONTIGJENTE

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
Kontratë	Sipas Urdhrit Përmbarues P. nr. 397/2015, kompensim në shumë prej 2.640 Euro	bartur 2017	e lartë	2,640
Kontratë	Sipas Aktgjykimit SCC-08-0095 - Padia për humbjen e fitimit, kompensimit në shumën prej 14,478,50 si dhe avokatin në shumën prej 365,04 Euro.	bartur 2017	e lartë	14,844
Kompensim	Aktgjykimi Cnr. b190/2007 NSH Auto Prishtina	bartur 2017	e lartë	35,725
Kompensim	Aktgjykimi Cnr. 185/2009. për NSH Ujmiri në likuidim	bartur 2017	e lartë	70,000
Kompensim	aktgjykim AC-II-12-0006 për NSH Agrokultura	bartur 2017	e lartë	2,296
Kompensim	Sipas aktgjykimit C-II-17-0069, AKP-ja është e obliguar t'i paguaj shpenzimet e përfaqësuesit të ankuesit.	bartur 2017	e lartë	655
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-15-1026, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit për shfrytëzimin e lokalit afarist.	2018	E ultë	174,891
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-17-0033, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit për pronën.	2018	E ultë	2,985,945
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-17-0211, pretendon që AKP-ja, në emër të borxhit për mos pagesën e shërbimeve.	2018	E ultë	41,828
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-16-0005, pretendon që AKP-ja, në emër të dëmit material dhe jo-materiale.	2018	E ultë	280,000
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-II-16-0662, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të paguaj të papaguara.	2018	E ultë	2,100
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij SCC-11-0158, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të pronës.	2018	E ultë	975,526
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-III-16-0125, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo-material.	2018	E ultë	150,000

NATYRA	ARSYEJA PËR DETYRIME	PERIUDHA	MUNDËSIA	Vlera
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-I-12-0055, pretendon që AKP-ja, në emër të mospërmbushjes së kontratës.	2018	E ultë	138,126
Kompensim	Paditësi përmes padisë së tij C-II-17-0623, pretendon që AKP-ja, në emër të kompensimit të pagave të papaguara.	2018	E ultë	6,300
Kompensim	Aktgjykimi SCC-05-0010, AKP-ja detyrohet për pagesën e 1,200 EUR.	2018	E lartë	1,200
Fatura	Fatura të gazetës të papaguara që më parë janë ndalur për shkak të tejkalimit të vlerës të kontratës, por që blerësi i ri i kompanisë nuk ka shprehur interesin që të pranojë këto pagesa. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente.	2018	E ultë	323
Fatura	Janë dy fatura në shumën totale prej EUR 2,836 për shërbimet e avokaturës në Republikën e Bosnjës dhe Hercegovinës lidhur me përfaqësimin në procesin gjyqësor për pronën e NSH "Industria e Mishit". Pagesat janë ndalur dhe nuk janë ekzekutuar sepse gjatë vitit 2018 për arsye se shërbimet e kontraktuara me avokatin në fjalë kishin përfunduar	2023	E ultë	2,836
Kompensim	Aktgjykimi I shkalles se pare SCC-11-0245 me te cilin obligohet e paditura AKP per pagesen e kompenzimit monetar ne shume prej 68,199 Euro, me kamate prej 8% , nga dita e nxjerrjes se aktgjykimit.	2023	E Lartë	68,199
Fatura	OSHP kërkon ende që të paguhet një kërkesë/faturë që e kanë dorëzuar për pagesë për muajin gusht 2019. Për këtë periudhë AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. Fatura 19-300-000128 e datës 6 shtator 2019 për periudhën 1-31 gusht 2029 prej EUR 45,436.			
Fatura	OSHP kërkon që të paguhet një faturë të cilën e kanë dorëzuar për pagesë për muajin korrik 2021. AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. Fatura 21-300-000137 e datës 6 gusht 2021 është EUR 30,000.			
Fatura	OSHP kërkon që të paguhet një faturë të cilën e kanë dorëzuar për pagesë për muajin gusht 2021. AKP nuk ka paguar sipas arsyeve që i ka shpalosur në raportet shqyrtuese të raporteve OSHP-së. Fatura 21-300-000148 e datës 7 shtator 2021 është EUR 30,000.			
Fatura	Faturë e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 2011-2012. Këto obligime në pasqyrat financiare 2017 kanë qenë të prezantuara si obligime por që kalojnë në detyrime kontingjente në vlerën prej EUR 17,160			
Kompensim	Aktgjykimi C-III-13-0164- Me këtë aktgjykim është Aprovuar pjesërisht kërkesëpadia e paditësëve dhe detyrohen te padituratKBI"Progres Export"Lavertari dhe Blegtori dhe Agjencia Kosovare e Privatizimit, që në emër të kompensimit për ngastrat nr. 5487-1 dhe 5518-1 në sipërfaqe prej 1472m2 ZK Prizren, paditësve së bashku tu a paguaj shumën 235.520.00 euro, kamatën sipas mjeteve te deponuara në banka pa destinim të caktuar, e të kufizuara deri në 10% të shumës themelore të kërkesës 235.520.00 euro, si	2024	E Lartë	235,520

	dhe shpenzimet të procedurës në shumën prej 608.12 euro, të gjitha sipas nenit 40.1.7 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034.			
Kompensim	Aktgjykimi C-III-12-1847, obligim për shpenzime procedurale	2024	E Lartë	7,130
Fatura	Tatimi në pronë - Tregu me shumicë - Ankesë ndaj faturës së tatimit në pronë	2025	E Lartë	785,852
Fatura	Tatimi në pronë - Tregu I Gjelbër -Ankesë ndaj faturës së tatimit në pronë, pasi që është bërë një pagesë	2025	E Lartë	16,788
Fatura	Raport vlerësimi - kontrata e nënshkruar me datë pas afatit për përfundimit të shërbimit	2025	E Lartë	1,000

VIII. PAGESAT E REALIZUARA NGA TARIFA ADMINISTRATIVE

Sipas vendimit të Bordit të Drejtorëve të vitit 2012, në rast se nuk ka fonde të mjaftueshme në llogarinë bankare të likuidimit dhe NSH-ve tjera, atëherë pagesat realizohen përkohësisht nga llogaria bankare e tarifës administrative të Agjencisë në Bankën Qendrore të Kosovës. Në momentin që do të ketë fonde të mjaftueshme në llogarinë e likuidimit, atëherë llogaria e tarifës administrative të Agjencisë kompensohet nga llogaria e ndërmarrjes në likuidim. Gjithashtu, pagesat nga llogaria e tarifës administrative dhe kompensimi i kësaj llogarie nga NSH-të në likuidim është në pajtueshmëri dhe me nenin 20 të ligjit nr. 06/L -023 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-115 dhe ligjin nr. 05/L-080.

		SHUMA
Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 1 janar 2025		**1,068,593**
Gjithsej mjetet e paguara ndaj OSHP-së sipas kontratës *me OSHP* *[shënimin shpjegues nr. 10]*	-	(541,650)
Bartje të arkivave, abonime dhe furnizime për NSH-të *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(27,376)
Dërgesa postare *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(5,261)
Huazim i mjeteve për NSH Inex Sharr *[shënimin shpjegues nr. 11]* **Duke përfshirë edhe vitet paraprake në tërësi ndërmarrjes Inex Sharr Planina i janë transferuar si huazim EUR 365,746. Mjetet transferohen si huazimie sipas vendimit të Bordit të AKP-së.**	-	(153,830)
Pagesa të OSH-ve *[shënimin shpjegues nr. 11.1]*	-	(476,183)
Paraja e imët *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(31,350)
Provizione për ruajtjen e artikujve në Bankën Qendrore të Kosovës *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(600)
Shator me qera për arkivën e ndërmarrjeve shoqërore *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(2,550)
Shërbime komunale - rryma e paguara nga tarifa administrative *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(12,093)
Shpenzime të udhëtimit zyrtar jashtë vendit *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(4,506)
Taksa gjyqësore dhe taksë për Komisionin e Minierave dhe Mineraleve *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(570)
Trustet Pensionale dhe tatimet për OSh-të nga tarifa për NSh-të përkatëse *[shënimin shpjegues nr. 11]*	-	(65,279)
Provizione bankare *[shënimin shpjegues nr. 16]*	-	(1,010)
Të hyra nga interesi bankar në llogari rrjedhëse të tarifës administrative		3,223
Kompensimi i tarifës administrative nga llogaritë e NSH-ve për të cilat janë bërë pagesa më përpara	+	829,746
Të hyrat për 5% dhe tjera për Agjencinë Kosovare të Privatizimit – *[shënimin shpjegues nr. 15.1]*	+	1,104,552
Gjendja bankare e llogarisë së tarifës administrative më 31 Dhjetor 2025		**1,683,856**

IX. TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM NË BQK DHE GJENDJA NË BANKAT KOMERCIALE

TRANSFERET BRENDA LLOGARIVE BANKARE TË FONDEVE NË MIRËBESIM

Janë transaksione bankare ndërmjet llogarive bankare të fondeve në mirëbesim në BQK. Shkurtimisht janë paraqitur si më poshtë:

1. Bartjen e BID depozitave nga llogaritë e BID depozitave të privatizimit dhe likudimit për në llogaritë përkatëse të NSh-ve në likuidim. *Këto raste trajtohen dhe janë të paraqitur në shënimin nr. 6.* **Gjithsej bilanci i transaksioneve për vitin 2025 është EUR 554,300.**
2. Kompensimi i tarifës tarifës administrative për shpenzimet e ndërmarrjeve shoqërore në vlerën prej EUR 829,746. *Këto raste janë paraqitur dhe janë të paraqitur në shënimet 11 deri 16 si dhe kapitullin VIII – Pagesat e Realizuara nga Tarifa Administrative;*
3. Të hyrat nga 5% e shitjeve dhe konfiskimet e BID depozitave në shumën totale EUR **1,104,552.** *Këto raste janë paraqitur dhe janë të paraqitur në shënimet 11 deri 16 si dhe kapitullin VIII – Pagesat e Realizuara nga Tarifa Administrative;*
4. Transferimin e shumave të pa shpërndara si pjesë e 20% për në llogarinë në mirëbesim për punëtorët e NSH-ve. **Gjatë periudhës raportuese**, gjithsej shuma e transferuar për punëtorët në llogari që mbahet në mirëbesim nga AKP është **EUR 417,054.** Këto mjete do të shpërndahen apo janë shpërndarë pas shqyrtimit të ankesave nga Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme.

LLOGARITË BANKARE TË TJERA NË BANKAT KOMERCIALE

Është vetëm një llogari bankare në të cilën ka mjete bankare që AKP-ja mbanë në Procredit Bank dhe NLB Bankë:

1. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 64,466.50 për licencën sipas rregullores të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës;
2. Garancioni bankar për MIM Golesh në shumën prej EUR 12,450.00 për licencën sipas rregullores të Komisionit për Miniera dhe Minerale të Kosovës.
3. Gjendja e llogarisë bankare të Inex Sharr Planina është EUR 11,524
4. Gjendja e llogarisë bankare të Jatex është EUR 149,110

X. GJENDJA E FONDEVE TË LIKUIDIMIT TË NSH-ve

Gjendja e të hyrave dhe pagesave në llogaritë bankare të NSH-ve në likuidim nga viti 2003 deri më 31 dhjetor 2025 si më poshtë:

Gjithsej të hyrat prej EUR	770,540,490
Gjithsej Shpenzimet/shpërndarja prej EUR	589,292,539
Gjendja e llogarive bankare në likuidim	**181,247,951**

RAPORTI I TË HYRAVE NË LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM

NR.	PËRSHKRIMI I TË HYRAVE	VLERA
1	të hyrat nga shitja e aseteve, banesave dhe shpronësimeve	241,619,135
2	të hyra nga qiraja	51,641,645
3	Interesi i fituar ne llogarine rrjedhese dhe nga afatizimet kohore	9,676,025
4	të ardhura tjera	3,849,841
5	Mjetet e alokuara nga llogaritë tjera të NSh'së	463,753,844
	GJITHSEJ TË HYRAT NË LLOGARITË BANKARE TË NSH-vë NË LIKUIDIM	**770,540,490**

RAPORTI I TË PAGESAVE/SHPËRNDARJESË NGA LLOGARTË BANKARE TË NSH-ve në LIKUIDIM

NR	SIPAS LIGJIT NR. 04/L-034	PËRSHKRIMI I SHPENZIMEVE (plani kontabël detajet e shpenzimeve të kategorizuar sipas renditjes të mëposhtme janë në faqen tjetër)	VLERA
1	Rreg. për punëtoret	Mjetet që u takojnë punëtorëve (20%) nga shitjet me likuidim	55,109,008
2	neni 21 i AKP-së i Ligjit nr. 04/L-034	Tarifa administrative e Agjencisë (5% e shitjeve të likuidimit dhe interesit në llogaritë bankare)	13,423,551
3	40.1.1	Kostot e Shitjes ose Përndryshe Realizimi i pronës ose aseteve si dhe shpenzimet e likuidimit	1,388,628
4	40.1.3.1	Shpenzimet Gjyqësore	2,581,215
4	Ekzekutim nga përmbaruesi nga përmbaruesi privat në kundërshtim me nenin 10 të shtojcës të Ligjit		4,132,322
5	40.1.3.2	Shpenzimet e Administratorit, Autoritetit të Likuidimit dhe Këshilltarëve tjerë	16,924,997
6	40.1.3.3	Shpenzimet për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e pronës dhe aseteve	5,127,989
7	40.1.3.4	Shpenzimet për vazhdimin e operacioneve të Ndërmarrjes	15,060,426
8	40.1.3.4	Shpenzimet të likuidimit: Pagesa e tatimeve (Tatimi i të Ardhurave Personale, Tatimi i Pronës, TVSH etj.)	8,824,896
9	40.1.4	Kreditorët e siguruar për ato raste që janë realizuar nga sigurimi i atyre aseteve	757,496
10	40.1.5	Kreditorët e aseteve specifike duke përfshirë pronën e paluajtshme	189,210
11	40.1.6.1	Kreditorët e pagave për 3 muaj pagat bruto dhe pensioni	3,979,680
12	40.1.6.2	Kreditorët: pagesat për pushim nga puna të papaguara në fillim të Likuidimit	6,107,124
13	40.1.7	Kreditorët e pasiguruar	58,112,613
14	40.1.8	Kreditorët - Pronarët, aksionarët, themeluesit, pjesëmarrësit ose partnerët në NSh	786,967
15	Shih shënimin nr. 18	Fondet Tepricë, Fondet e Mbetura dhe Fondet e përkohshme transferuar Buxhetit të Kosovës	396,786,417
		GJITHSEJ PAGESAT NGA LLOGARITË BANKARE TË NSH-ve NË LIKUIDIM	**589,292,539**

Më poshtë janë detajet e të gjitha kodeve detaje të pagesave të cilat në tabelën më lartë janë përmbledhur sipas numrave rendor

RENDITJA	PËRSHKRIMI	VLERA
1	e2 - Transferim tek punëtorët (BSPK)	44,004,520
	e3 - Transferim tek llogaritë në mirëbesim për punëtorët	11,104,488
2	e4 - Tarifa administrative e agjencisë (5% e shitjeve me likuidim)	13,051,568
	e4a - Tarifa Administrative e Agjencisë (5% e interesit në llogarinë bankare të likuidimit)	371,982
3	e1 - Shpenzimet bankare	42,796
	e6 - Shpenzime për reklamim	803,766
	e7 - Kostoja e shitjes për likuidim të aseteve	107,054
	e8 - Gjëra për zyrë, shpenzime të vogla zyre dhe posta	282,767
	e9 - Magazinim, transportim i dokumenteve të NSh-ve	10,850
	e11 - Shpenzimet e imta të MBYLLURA - Shpenzime aktuale për kosto të vogla likuidimi	141,396
4	e14 - Shpenzime për gjykatë	2,581,215
	e14a - ekzekutimi i pagesave nga përmbaruesi	4,132,322
5	e16 - Ofrues Profesional të Shërbimeve (Autoriteti i Likuidimit)	16,924,997
6	e21 - Shërbime për mirëmbajtje të aseteve	589,546
	e22 - Shërbime për mbrojtje të pronës dhe aseteve	4,538,443
7	e17 - Ofrues të shërbimeve (pagesa bruto)	1,508,805
	e18 - Ofrues të shërbimeve (pagesa neto)	7,644,627
	e25 - Qiraja e paguar (bruto)	353,817
	e26 - Qiraja e paguar (neto pas tatimit mbi qiranë)	35,736
	e20 - Shërbime profesionale	1,134,357
	e27 - Mallra	249,294
	e29 - Shërbime	1,043,504
	e30 - Ujë	232,977
	e31 - Rrymë	1,933,217
	e32 - Mbeturina	773,804
	e33 - Telekomunikacion (Internet, telefon)	74,054
	e24 - Udhëtime zyrtare	76,234
8	e19 - Tatimi në të ardhura personale për OSH	1,427,555
	e34 - Tatimi që mbahet mbi qiranë e paguar	2,995
	e35 - Tatimi i paguar për qiranë e pranuar	88,249
	e36 - Tatimi komunal në pronë	865,464
	e38 - Tatimi i korporatës	581,627
	e39 - TVSH paguar ATK-së	5,809,909
	e39a - Urdhër-vjelje nga ATK nga llogaritë e likuidimit	49,098
9	e41 - Kreditorë të siguruar/e42kërkesat pronësore	946,706
10	e43 - Pagat (neto) kreditorë preferencialë 3 paga	3,499,876
	e44 - Tatimi në ardhurat personale (kreditorë preferencialë 3 paga)	128,441
	e45 - Kontribute për pension (për kreditorë preferencialë 3 paga)	351,362
11	e46 - Pagesa për ndërprerje të punësimit (neto) kreditorë preferencialë	5,452,639
	e47 - Tatimi në të ardhura personale (pagesa për ndërprerje të punës kreditorë preferencialë)	148,434
	e48 - Kontributi për pension (për pagesë të ndërprerjes së punës për kreditorë preferencialë)	506,051
12	e49 - Pagat (neto) kreditorë të pasiguruar	20,302,657
	e50 - Tatimi në të ardhura personale (pagat e kreditorëve të pasiguruar)	1,426,050
	e51 - Kontribute për pension kreditorë të pasiguruar	3,224,591
	e52 - Kreditorët e pasiguruar - Huazimet	562,708
	e53 - Avanset e pranuara në para të gatshme nga NSh-të - kreditorë të pasiguruar	451,239
	e54 - Furnizues vendorë kreditorë të pasiguruar	5,636,016
	e55 - Furnizues ndërkombëtarë kreditorë të pasiguruar	302,110
	e56 - Tatimi në pronë - kreditorë të pasiguruar	2,809,128
	e57 - Tatimi mbi qiranë kreditorë të pasiguruar	127,905
	e58 - Tatimi i korporatës kreditorë të pasiguruar	791,124
	e59 - TVSH kreditorë të pasiguruar	6,177,881
	e60 - Tatimi i paragjykuar kreditorë të pasiguruar	791,584
	e61 - Rryma kreditorë të pasiguruar	1,866,126
	e62 - Ujë kreditorë të pasiguruar	2,147,792
	e63 - Mbeturina kreditorë të pasiguruar	195,701
	e64 - Telekomunikim dhe Internet kreditorë të pasiguruar	124,603
	e65 - Kreditorë tjerë të pasiguruar	11,175,397
13	e66 - Kërkesa të pronarëve, aksionarëve, themeluesve, pjesëmarrësve, partnerëve në NSh	786,967
14	e0 - Fondet Tepricë për Qeverinë e Kosovës - neni 19.3.3 i Ligjit të AKP-së	90,244,911
	Fondet e përkohsme transferuar Buxhetit të Kosovës	261,773,175
	e67 - Fondet e mbetura për Qeverinë e Kosovës	44,768,332

XI. LLOJET E LLOGARIVE BANKARE

1. **LLOGARITË E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për të mbajtur të ardhurat e privatizimit/shitjes sipas nenit 8 deri në nënshkrimin e kontratave të shitjes. Pas nënshkrimit të kontratave të shitjes, bëhen këto veprime: pagesat për 20%-in e punëtorëve; transferimi i tarifës administrative (5% e shitjes) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 75% e çmimit të shitjes transferohen në llogarinë e likuidimit.

2. **LLOGARITË E NSh-ve NË TRANZICION** - Mban paratë e NSh-ve në mirëbesim në rastet kur Agjencia vendos që NSh-ja nuk ka resurse për të mbajtur këto para ose kur rrethanat nuk e lejojnë për të vepruar ndryshe për shkak të specifikave të NSh-ve (rasti i statuseve të pa përcaktuara të NSh-ve e të ngjashme).

3. **LLOGARITË E LIKUIDIMIT** - Përdoren për NSh-të pasi që kanë hyrë në likuidim. Të gjitha llogaritë bankare e NSh-ve mbyllen dhe gjendja e tyre bankare transferohet në këto llogari.

4. **LLOGARITË E KOMERCIALIZIMIT** - Mban shumat e qirave të mbledhura gjatë procesit të komercializimit të NSh-ve, pra të kontratave të nënshkruara para privatizimit të NSh-ve dhe ato kontrata të koncesionit ose dhënies me qira që nënshkruhen pas themelimit të Agjencia Kosovare të Privatizimit. Pas përfundimit të kontratës së komercializimit bëhen këto veprime: transferimi i tarifës administrative (5% e qirave të paguara gjatë komercializimit) në llogarinë e dedikuar të Agjencisë për të ardhurat nga tarifa administrative. Prej kësaj llogarie transferohen tarifat në llogarinë bankare sipas nenit 64 të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë; dhe 95% e të ardhurave nga komercializimi transferohen në llogarinë e likuidimit, nëse nuk parashihet ndryshe.

5. **LLOGARITË E PARAVE NË MIRËBESIM PËR PUNËTORËT** - Mban paratë në mirëbesim në emër të punëtorëve që janë transferuar nga llogaritë e privatizimit dhe likuidimit. Këto para janë pjesa e mbetur e 20%-it që iu takon punëtorëve në rastet kur më parë është bërë shpërndarja e parakohshme e 20% e të ardhurave nga shitjet sipas nenit 8 dhe 20% e të ardhurave nga shitja sipas nenit 9 të ligjit të Agjencisë.

6. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoren për mbajtjen e depozitave të paguara nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit mbi AKP-në. Kjo është një llogari e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitin e ofertës ofertuesit jo fitues (të pasuksesshëm). Depoziti i ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për Ndërmarrjen e Re që shitet.

7. **TARIFAT PËR TENDERËT E PRIVATIZIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 8 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

8. **DEPOZITAT NGA TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për shitjet sipas nenit 9 për mbajtjen e depozitave të paguar nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjen e pasurive të NSh-ve që janë në likuidim. Kjo është një llogari bankare e përkohshme prej ku Agjencia ia kthen depozitën ofertuesit të pasuksesshëm. Depozita e ofertuesit të suksesshëm transferohet në llogarinë e mirëbesimit të hapur në veçanti për NSH në likuidim.

9. **TARIFAT PËR TENDERËT E LIKUIDIMIT** - Përdoret për mbajtjen e tarifës së pakthyeshme për dorëzimin e ofertës nga ofertuesit gjatë procesit të ofertimit për shitjet sipas nenit 9 të ligjit. Këto para llogariten si të ardhura të dedikuara të Agjencisë.

10. **DEPOZITAT E KOMISIONIT TË RISHIKIMIT TË LIKUIDIMIT** - Ka mbajtur depozitat e paguara nga parashtruesit për ankesat në procesin e likuidimit të dorëzuara në ish-Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave. Pas kthimit të depozitave siç parashihet në nenin 24.4 të ligjit të Agjencisë, kjo llogari do të mbyllet.

11. **LLOGARIA E KAPITALIT THEMELTAR** - Mban pagesën në kapital nga Buxheti i Kosovës mbi themelimin e Agjencisë

12. **LLOGARIA E FONDIT REZERVË TË AKP-së** - Para se të hyjë në fuqi ligji i ri për 5% e tarifës administrative është mbajtur për të përdorur të ardhurat vetanake të AKP-së për depozitat e konfiskuara nga shitjet e privatizimit, likuidimit, transferimin e tarifave për shitjet përmes privatizimit dhe likuidimit, interesin e fituar në llogaritë e depozitave dhe tarifave për pjesëmarrjen në tenderët e shitjes përmes privatizimit apo likuidimit.

13. **LLOGARI E DONATORIT** - Mban paratë e donatorëve në rastet kur donatorët kërkojnë që paratë e tyre të kanalizohen përmes llogarive bankare të Agjencisë.

14. **LLOGARIA E TARIFËS ADMINISTRATIVE** - Në këtë llogari transferohet tarifa administrative e Agjencisë. Në periudha të ndryshme, Agjencia transferon gjendjen në këtë llogari bankare në llogarinë e specifikuar nga Ministria e Financave për të mbajtur të ardhurat e dedikuara nga tarifat administrative të Agjencisë.

15. **LLOGARIA E DEPOZITAVE KOHOR** - Janë llogaritë bankare të depozitave kohor në të cilat transferohet mjetet për afatizim për periudha të ndryshme (deri në një vjet). Nëse ka norma të interesit pozitive që oferton BQK-ja, atëherë sipas marrëveshjes AKP afatizon këto mjete në Bankën Qendrore të Kosovës.

16. **LLOGARIA E SHPRONËSIMEVE –** llogari për qëllim të administrimit dhe operimit me pagesa e shpronësimeve nga institucionet relevante. Të gjitha institucionet kanë mundësi që pagesën ta përfundojnë menjëherë pa ndjekur procedurat e Thesarit për regjistrimin si furnitorë të NSh-ve. Mjetet që pranohen në këtë llogari, nga AKP-ja transferohen në llogaritë përkatëse të NSh-ve, prej nga është shpronësuar aseti.

XII. PLANI I VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E REKOMANDIMEVE TË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Raporti është për vitin 2024 për raportin e auditimit për pasqyrat financiare vjetore të vitit 2024 për fondet në mirëbesim.

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
1.	Të hyrat nga Qiratë	**Çështja B1 -** Mos arkëtimi i të hyrave nga qiratë	Bordi i Drejtorëve duhet të shtojë kontrollet tek qiramarrësit në mënyrë që të sigurohet se pagesat janë duke u kryer brenda afateve të parapara kohore, në të kundërtën të marrin masa për ndërprerjen e kontratave përkatëse	Për të adresuar këtë rekomandim, kemi filluar të ndërmarrim veprimeve konkrete për forcimin e kontrolleve lidhur me procesin e inkasimit të hyrave nga qiraja. Për këtë qëllim, më 16 maj 2025 është aprovuar rregullorja e re për qiradhënie, ku janë përforcuar dispozitat që parashohin masa ndaj vonesave në pagesa, detyrimin për aplikimin e garancionit bankar në të gjitha kontratat për periudhën përkatëse sipas marrëveshjes përfshirë edhe shkëputjen e kontratës. Paralelisht, jemi në fazë të azhurnimit të data-bazës për qiratë, e cila do të mundësojë monitorim dhe ndërmarrje të veprimeve në kohë reale ndaj qiramarrësve me vonesa në pagesa, duke forcuar kështu mjedisin e kontrollit të brendshëm. Sa i përket faktorëve të jashtëm, siç janë rastet që janë në procedurë gjyqësore, theksojmë se këto procese janë jashtë ndikimit të drejtpërdrejtë të institucionit	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës; Autoriteti i Likuidimit	Në vazhdimësi

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
				dhe zhvillohen sipas ritmit të gjykatave. Deri në përfundimin e këtyre procedurave dhe marrjen e vendimit përfundimtar, rastet përkatëse vazhdojnë të mbeten si llogari të arkëtueshme. Vlen të theksohet se nga 37 rastet e testuara nga auditori, 30 prej tyre janë tashmë dërguar në procedurë përmbarimore ose gjyqësore dhe ky argument është shpalosur në raport të auditorit.		
2	Shitja e aseteve	**Çështja A1 -** Mos respektimi i afatit kohor për shqyrtimin e kërkesave të shitjeve me negocim direkt	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet që shqyrtimi i kërkesave për shitje direkte të bëhet brenda një afati të caktuar kohor dhe përzgjedhja e tyre për shqyrtim, jashtë rendit kronologjik duhet të bëhet vetëm në raste të dokumentuara qartë, duke siguruar transparencë dhe trajtim të barabartë për të gjitha palët aplikuese.	DSHD do të vazhdoj rritjen graduale të numrit të shqyrtuar të kërkesave për shitje direkte të aseteve (mbi 50 kërkesa në muaj) ne mënyrë që të gjitha kërkesat e pranuara të trajtohen plotësisht brenda një periudhe të arsyeshme kohore. Po ashtu, DSHD do të vazhdoj shqyrtimin e kërkesave (lëndëve) sipas rendit kronologjik, me përjashtim të rasteve të mëposhtme të cilat parashihen (lejohen) me rregullore për shitje direkte: i) rastet kur kërkesat e parashtruara nuk i plotësojnë kriteret e rregullores dhe ato trajtohen menjëherë për te shmangur grumbullimin lëndëve dhe kjo bëhet në përputhje me nenin 7 te rregullores,	Departamenti i Realizimit të Aseteve dhe Shpërndarjes	Në vazhdimësi

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
				ii) rastet kur duhet integruar ndonjë kërkesë brenda një zone banimi, dhe iii) rastet kur lendet nuk janë të kompletuara me dokumentacion relevant dhe DSHD kërkon prej palës (përmes shkresave zyrtare) plotësimin e lendës . Deri në momentin e përgjigjes lënda e tillë pezullohet.		
3	Të hyrat nga Qiratë	**Çështja A2** - Mbivlerësim i llogarive të arkëtueshme nga qiratë	Bordi i Drejtorëve duhet të përmirësoj kontrollet lidhur me regjistrimin e llogarive të arkëtueshme, për të siguruar se ato regjistrohen dhe raportohen saktë në përputhje me dokumentacionin mbështetës, në mënyrë që prezantimi i tyre në PFV të jetë i saktë dhe i plotë.	Rastet e identifikuara janë korrigjuar duke larguar shumat përkatëse nga llogaritë e arkëtueshme dhe duke reflektuar vlerat reale në pasqyrat financiare. Për të parandaluar përsëritjen e rasteve të ngjashme në të ardhmen, aktualisht jemi në fazën e azhurnimit të një databaze të dedikuar, në të cilën do të regjistrohen dhe monitorohen automatikisht të gjitha transaksionet e lidhura me qiratë – përfshirë faturimin, pagesat dhe obligimet përkatëse. Ky sistem do të mundësojë përputhshmëri më të madhe dhe saktësi në raportimin financiar. Gjithashtu, sa i përket llogarive të arkëtueshme – duke përfshirë edhe rastet gjyqësore – do të ndërmerret një proces i përditësimit të rregullt të të dhënave dhe do të vendoset një praktikë e raportimit tremujor. Kjo do të sigurojë që lista e	Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës; Autoriteti i Likuidimit	Në vazhdimësi

Nr.	Komponenta e auditimit (kapitulli)	Gjetja	Rekomandimi	Veprimet e planifikuara për t'u ndërmarrë	Zyrtari/ët përgjegjës	Data e planifikuar e zbatimit të rekomandimit
				qiramarrësve dhe obligimet përkatëse të jenë të monitoruara dhe të reflektuar me saktësi përpara përgatitjes së pasqyrave financiare		
4	Detyrimet kontigjente	**Çështja A3 –** Shpalosje jo e saktë e detyrimeve kontingjente në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare	Bordi i Drejtorëve duhet të sigurohet se regjistri i detyrimeve kontingjente të azhurnohet në kohë, në mënyrë që çdo informacioni i ri të reflektohet saktë dhe në kohë në pasqyrat financiare	Është ndërmarrë masa e klasifikimit të saktë në regjistrimin kontabël nga **Detyrimi kontingjent** në **Detyrim (llogari e pagueshme)**, duke reflektuar statusin aktual juridik dhe financiar të çështjes. Detyrimi do të vazhdojë të qëndrojë i regjistruar si llogari e pagueshme derisa pala përkatëse të paraqitet me kërkesë për ekzekutim. Në rast të mosparaqitjes së kërkesës në afatet ligjore, do të vlerësohet mundësia e parashkrimit të lëndës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, për të rritur transparencën dhe monitorimin e detyrimeve kontingjente, do të përgatitet një format i ri i raportimit, i cili do të përfshijë informacione më të detajuara për secilën çështje. Ky format do të mundësojë ndjekjen sistematike të zhvillimit të rasteve gjyqësore dhe do të siguroj që çdo ndryshim i statusit të tyre të reflektohet menjëherë në regjistrat financiar.	Departamenti Ligjor	Dhjetor 2025

- FUND -